

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

## **SKELET KURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

# **DETARI**

**Niveli I**

**Kodi: J-I-15**

Miratoi:

MINISTRI

.....

**Tiranë, 2015**

## **Përmbajtja:**

### **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I.**

### **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional “ Detari”, niveli I**

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Detari”, niveli I
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Detari”, niveli I
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Detari”, niveli I
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Detari”, niveli I

### **III. Plani mësimor për drejtimin “Detari”, niveli I**

### **IV. Udhëzime për planin mësimor**

### **V. Udhëzime për procesin mësimor**

### **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet**

### **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimimit në drejtimin “Detari”, niveli I**

### **VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale**

### **IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale**

### **X. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të grupuar**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me detarinë, siç janë marina tregtare, shërbimet portuale, peshkimi, rritja artificiale e peshkut, përpunimi i peshkut, mjetet lundruese të agjencive të zbatimit të ligjit etj.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Detari”, niveli I.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Detari” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MMSR përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim arsimit në drejtimin “Detari”, niveli I**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithëshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit në drejtimin “Detari”, niveli I.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari” niveli I, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të notojë në kushte të ndryshme në ujë;
- Të vozisë me mjete të thjeshta lundrimi;
- Të përdorë terminologjinë detare në emërtim, interpretim dhe raportim;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale;
- Të zbatojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në përmbushjen e detyrave profesionale.
- Të zbatojë kriteret e sigurisë personale dhe përgjegjësisë kolektive në anije;
- Të përcaktojë distancat nga anija në bankinë, shpejtësinë dhe kahun e lëvizjes së anijes;
- Të kryejë kontrole pamore për mbajtjen në gatishmëri përdorimi të mjeteve të shpëtimit të jetës, mbrojtjes nga zjarri dhe të higjienës në anije;
- Të zbatojë detyrat individuale dhe në grup lidhur me emergjencat e identifikuar;
- Të vëzhgojë gjatë shërbimit elementë të sigurisë gjatë qëndrimit të anijes në bankinë, bove apo spirancë dhe të raportojë;
- Të përdorë pajimet personale, kolektive dhe teknikat e rekomanduara për mbijetesën në det.
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet për parandalimin dhe luftën kundër zjarrit.
- Të japë ndihmën e parë fillestare.
- Të vëzhgojë gjatë shërbimit sinjalistikën lundimore natën/ditën dhe të raportojë;
- Të kryejë punime të mbrojtjes së anijes nga ndryshku;
- Të kryejë kalafatimin dhe stukimin e mjeteve lundruese prej druri;
- Të realizojë nyjet (lidhjet) detare;
- Të qepë cimat dhe kavot;
- Të përdorë cimat për akostim dhe çakostim nga bankina;
- Të realizojë vendosjen e sigurtë të mjeteve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes elektromekanike në anije;
- Të kryejë punime mirëmbajtjeje dhe riparime të thjeshta të veglave të peshkimit;
- Të përgatisë veglat e peshkimit sipas specifikës së shërbimit;
- Të kryejë gjuetinë e peshkut me vegla të thjeshta peshkimi në bregdet;
- Të marrë informacion për motin nga instrumentat matës dhe informues në anije, si dhe nga tregues të tjerë të motit;
- Të kryejë matje meteorologjike me instrumentat përkatës, në anije;

- Të sistemojë produktin e kapur gjatë peshkimit;
- Të ruajë freskinë e produktit nga momenti i zënies deri në daljen e tij në treg;
- Të kryejë punime ndihmëse në feramat e rritjes së peshkut;
- Të marrë mostra uji në thellësi të ndryshme;
- Të respektojë standardet ndëkombëtare që veprojnë në fushën e peshkimit;
- Të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale;

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjeshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Detari”, niveli I

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional ”Detari”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në mjetet lundruese të marinës tregtare, të peshkimit dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, në shërbimeve portuale, në ekonomitë e rritjes artificiale të peshkut, si dhe në stabilimentet e ruajtjes dhe shpërndarjes së peshkut për treg. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësit ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në një nga profilet mësimore (njëvjeçare) të nivelit II të kualifikimit profesional të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtjeshëm në nivelin III, nxënësit fitojnë ”maturën profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Detari” niveli I

Plani mësimor për drejtimin “Detari”, Niveli I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli I	
			Orët javore/vjetore	
			Klasa 10	Klasa 11
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/17</b> (510/ 578)	<b>11/13</b> (352/ 416)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1
2		Gjuhë e huaj	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	1
7		Fizikë	2	1
8		Kimi	1	2
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Edukim fizik	2	1
11		Edukim për karrierën	-	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>10 (340)</b>	<b>8 (256)</b>
1	L-30-381-15	Lundrimi	2	2
2	L-30-382-15	Njohuri për mjetet e lundrimit	2	2
3	L-30-383-15	Hidrometeorologji	1	1
4	L-30-384-15	Biologji dhe ekologji e ujrave	2	-
5	L-16-385-15	Gjuetia në ujra	1	1
6	L-16-386-15	Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore	2	2

C.		Module të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (204)	12 (384)
1	M-30-162-15	Kryerja e notimit dhe vozitjes	51	-
2	M-16-163-15	Realizimi i nyjeve detare	36	-
3	M-30-165-15	Mbrojtja e anijes nga ndryshku	51	-
4	M-30-173-15	Kallafatimi dhe stukimi i mjeteve lundruese prej druri	33	-
5	M-30-1192-15	Qepja e cimave dhe kavove në anije	33	-
6	M-30-1035-15	Teknikat personale të mbijetesës (IMO 1.19)	-	30
7	M-30-1036-15	Parandalimi dhe lufta kundër zjarrit (IMO 1.20)	-	30
8	M-30-1037-15	Ndihma e parë elementare (IMO 1.13)	-	30
9	M-30-1193-15	Përdorimi i mjeteve dhe i mekanizmave të kuvertës	-	48
10	M-30-167-15	Punimet ndihmëse elektromekanike në anije	-	66
11	M-16-168-15	Trajtimi i pëlhurave dhe veglave të peshkimit	-	33
12	M-16-170-15	Gjuetia në bregdet	-	81
13	M-16-176-15	Punime ndihmëse në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla	-	33
14	M-16-177-15	Punime ndihmëse në fermat e rritjes së peshkut në ujra të kripura	-	33
<b>D.</b>		<b>Praktikë profesionale e grupuar (Gjithsej)</b>	60 (2 javë)	60 (2 javë)
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>31/33</b> (1114/ 1182)	<b>31/33</b> (1052/ 1116)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë praktikë profesionale e grupuar)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 2 javë praktikë profesionale e grupuar + 1 javë provimi i praktikës profesionale + 1 javë provimi i teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 33 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme të këtyre lëndëve janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikës profesionale (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Praktika profesionale e grupuar (programi i përgjithshëm i kësaj praktike është pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Detari”, niveli I.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Detari”, niveli I.

**Praktika profesionale e grupuar** do të kryhet gjatë një periudhe dyjavore (në vijim ose e ndarë në dy blloqe njëjavore) në mjediset reale të punës (në anije, në porte, në impiante të rritjes së peshkut etj.). Nxënësit mund të ndahen në dy ose më shumë grupe dhe të kryejnë praktikën në vende të ndryshme pune, sipas një sistemi *rotacioni*. Programi i detajuar i veprimtarive praktike që do të kryejnë nxënësit gjatë praktikës së grupuar do të hartohet nga vetë shkolla profesionale, në marrëveshje edhe me ndërmarrjet/bizneset ku do të kryhet kjo praktikë. Instruktori/instruktorët e shkollës do të udhëheqin, mbikqyrin dhe vlerësojnë nxënësit gjatë kryerjes së praktikës profesionale të grupuar, duke bashkëpunuar edhe me specialistët e detarisë të ndërmarrjeve/bizneseve ku do të kryhet praktika.

Në përputhje me Ligjin Nr. 10109 datë 10.2.2009 “Për Administratën Detare në Republikën e Shqipërisë”, Shkolla profesionale duhet të bashkërendojë veprimtaritë përkatëse praktike dhe të testimit me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për procesin e kualifikimit të nxënësve të drejtimit mësimor “Detari”, niveli I.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve për lëndët teorike profesionale, modulet e praktikave profesionale dhe praktikën profesionale të grupuar bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) për lëndët teorike, për modulet praktike dhe për praktikën profesionale të grupuar, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Detari”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e detarisë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të praktikës profesionale të grupuar dhe të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli I**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli I, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale (të cilat janë në përputhje me Rregullin A-VI/1 - 1, 2, 3, 4 dhe A-VI/6 – 1 të Ligjit Nr. 8569 datë 20.01.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare” dhe “Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët” STCW 1978 dhe amendamentet e 1995), të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nga IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare).

Sipas modelit të miratuar nga MMSR, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale, modulet profesionale dhe praktikën profesionale të grupuar, për çdo vit shkollor;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I;
- c) Të dhëna të tjera që kërkohen nga Administrata Detare.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Lundrim” (L-30-381-15). Kl. 10 – 68 orë dhe Kl. 11 – 64 orë

#### ▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Lundrim”, kl 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Lundrim”, kl 10, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë historikun e aktivitetit detar për vendin tonë dhe rajonin
- Të përshkruajë portet dhe veprimtaritë që zhvillohen në to
- Të tregojë tipet e anijeve në zona të ndryshme gjatë lundrimit.
- Të rendisë sistemet bazë të anijes.
- Të përshkruajë faktorë që ndikojnë në lëvizjen dhe drejtimin e anijes.
- Të përshkruajë procedurat e emergjencave kryesore në mjetin e lundrimit;
- Të listojë masat që meren për parandalimin dhe reagimin ndaj ndotjes detare;
- Të tregojë rregulat e sigurisë dhe shëndetit në punë në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë ndikimet e komunikimit efikas në mjetin e lundrimit;
- Të listojë parimet bazë të marrëdhënieve sociale në mjetin e lundrimit;
- Të interpretojë veprimet e duhura për shmangien e tejlodhjes;
- Të përshkruajë detyrat gjatë shërbimit në anije dhe emergjencat e mundëshme në të.
- Të tregojë komandat që përdoren gjatë operacioneve të manovrave të anijes.
- Të tregojë legjislacionin në fuqi në lidhje me detin

#### ▪ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës ”Lundrim”, kl.10 - 68 orë

1	Hyrje në detari	4 orë
2	Portet dhe veprimtari në to	6 orë
3	Kategorizimi i mjeteve lunduese	2 orë
4	Vetitë lunduese të anijes	6 orë
5	Sistemi i lëvizjes dhe i drejtimit të anijes	6 orë
6	Jeta në anije (Siguria Personale dhe Përgjegjësia Kolektive-IMO 1.21)	30 orë
7	Terminologjia detare dhe komandat e përdorshme	8 orë
8	Njohuri për legjislacionin kryesor të aplikueshëm për veprimtarinë ujore	6 orë

#### ▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Lundrim”, kl -11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Lundrim”, kl 11, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë rolin e pajisjeve të mbrojtjes nga uji e zjarri në anije si dhe mirëmbajtjen e tyre
- Të përshkruajë rolin e mjeteve individuale të shpëtimit të jetës së njeriut në det.
- Të përshkruajë rolin e mjeteve kolektive të shpëtimit të jetës së njeriut në det.
- Të tregojë rregullat që zbatohen gjatë procesit të rimorkimit
- Të listojë llojet e rimorkimit
- Të përshkruajë efektet mbi anijen gjatë qëndrimit në spirancë.
- Të tregojë mënyrat e hedhjes dhe ngritjes së spirancës.
- Të skicojë lëvizjet e anijes për lidhjen dhe largimin nga bova.
- Të përshkruajë veprimet e anijes për lidhjen allaj (trup i dytë).
- Të përshkruajë veprimet e anijes për zhvendosje përgjatë bankinës.
- Të dallojë format, sinjalet zanore dhe dritëdhënëse për parandalimin e përplasjeve në det.
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes sigurisë detare në mjetin e lundrimit;

- Të dallojë kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë së mjetit të lundrimit;
- Të interpretojë kërkesat dhe metodat për ruajtjen e vigjilencës për sigurinë e mjetit të lundrimit;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lundrim”, kl. 11 – 64 orë**

1	Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri në anije	4 orë
2	Pajisjet e mbrojtjes nga uji në anije	4 orë
3	Mjetet individuale të mbijetesës	4 orë
4	Mjetet kolektive të mbijetesës	6 orë
5	Ndihma e parë mjekësore	4 orë
6	Akostimi i mjetit të lundrimit	2 orë
7	Qëndrimi në spirancë, bovë dhe bankinë	4 orë
8	Rimorkimi	2 orë
9	Rregulla për parandalimin e përplasjeve të anijeve në det	12 orë
10	Njohuri për dokumentacionin	6 orë
11	Ndërgjegjësimi për sigurinë detare - IMO 3.26	16 orë

**2. Lënda “Njohuri për mjetet e lundrimit” (L-30-382-15). Kl. 10 – 68 orë dhe Kl. 11 – 64 orë**

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl 10, nxënësi duhet:

- Të dallojë elementët konstruktivë dhe funksional të një mjeti lundrimi;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për ndërtimin e mjeteve lundruese;
- Të dallojë cimat dhe kavot;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen e cimave dhe kavove.
- Të dallojë veglat dhe pajisjet e takilazhit në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë funksionin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të takilazhit.
- Të përshkruajë funksionin dhe procesin e mirëmbajtjes së mekanizmave dhe pajisjeve të kuvertës.
- Të tregojë rregullat e mirëmbajtjes së anijes që kanë të bëjnë me jetëgjatësinë e saj;
- Të listojë agregatet kryesore të instaluara në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë funksionin dhe procesin e mirëmbajtjes së aggregateve kryesore të instaluara në lokalin e makinerisë.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl.10 - 68 orë**

1	Ndërtimi dhe materialet që përdoren për ndërtimin e anijes	10 orë
2	Cimat, kavot dhe takilazhi në anije	12 orë
3	Agregatet e instaluara në kuvertën e anijes	12 orë
4	Mbrojtja e anijes nga ndryshku	12 orë
5	Agregatet e instaluara në lokalin e makinerisë	12 orë
6	Dokimi i anijes, proceset dhe punimet kryesore që kryhen në të	10 orë

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl. 11, nxënësi duhet:

- Të listojë instrumentat dhe pajisjet kryesore elektronike në mjetin e lundrimit;
- Të përshruajë funksionin e instrumentave dhe pajiseve kryesore elektronike në mjetin e lundrimit;
- Të listojë instrumentat dhe pajisjet kryesore pneumatike dhe hidraulike në mjetin e lundrimit;
- Të përshruajë funksionin e instrumentave dhe pajiseve kryesore pneumatike në mjetin e lundrimit;
- Të listojë instrumentat, pajisjet kryesore elektrike dhe linjat e shpërndarjes në mjetin e lundrimit;
- Të përshruajë funksionin e instrumentave, pajiseve kryesore elektrike dhe linjave të shpërndarjes në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë klasifikimin e motorave me djegje të brendshme.
- Të përshkruajë ndërtimin e motorit me djegie të brendshme.
- Të përshkruajë sistemet dhe funksionin e tyre tek motorat detarë.
- Të shpjegojë llojet dhe vetitë dhe trajtimin e hidrokarbureve në anije.
- Të përshkruajë sistemet e ndryshme të tubacioneve në anije;
- Të interpretojë një skemë të thjeshtë të linjave të tubacioneve;
- Të dallojë markimet dhe simbolet e aplikueshme në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë sistemin e trajtimit të ujrave të zeza në mjetin e lundrimit;
- Të interpretojë një skemë të sistemit të ujrave të zeza;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e lundrimit”, kl. 11 – 64 orë**

1	Instrumentat dhe pajisjet kryesore elektronike në mjetin e lundrimit	6 orë
2	Instrumentat dhe pajisjet kryesore pneumatike dhe hidraulike në mjetin e lundrimit	4 orë
3	Instrumentat dhe pajisjet kryesore elektrike në mjetin e lundrimit	16 orë
4	Njohuri mbi motorat detarë	6 orë
5	Ndërtimi i motorit, pjesët përbërëse të tij	10 orë
6	Sistemet tek motorat detarë	6 orë
7	Tanket dhe sistemet e tubacioneve në anije	4 orë
8	Hidrokarburet dhe trajtimi i tyre	8 orë
9	Ujrat e zeza dhe trajtimi i tyre	4 orë

**3. Lënda “Hidrometeorologji” (L-30-383-15). Kl. 10 – 34 orë dhe Kl. 11 – 32 orë**

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Hidrometeorologji”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Hidrometeorologji”, kl. 10, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë vrojtimin në anije për elementët hidro-meteorologjikë
- Të përshkruajë atmosferën dhe elementët e saj
- Të përshkruajë llojet rrezatimit diellor
- Të shpjegojë parimet e ngrohjes, ndriçimit dhe rrezatimit të tokës.
- Të përshkruajë elementët e nxehtësisë dhe ftohjes së ajrit.
- Të shpjegojë lëvizjet e ajrit dhe shtresat termike.
- Të dallojë shkallët e matjes së temperaturës në njësi të ndryshme.
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e instrumentave matës të temperaturës.
- Të përshkruajë ndryshimet e temperaturës, kriptomërisë dhe dendësisë në dete dhe oqeanë.
- Të përshkruajë formimin e avujve në atmosferë dhe shtypja e tyre.

- Të përshkruajë ndryshimet midis lagështirës relative dhe absolute.
- Të përshkruajë aparatet matëse të lagështirës dhe parimin e punës.
- Të shpjegojë shkaqet e kondensimit.
- Të përshkruajë mjegullat dhe llojet e tyre.
- Të tregojë retë dhe klasifikimin e tyre.
- Të përshkruajë llojet e reshjeve
- Të përshkruajë faktorët që shkaktojnë stuhi dhe dukuri të tjera meteorologjike në det
- Të tregojë parimin e punës, funksionimin dhe leximin e shimatësit.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Hidrometeorologji”, kl. 10 – 34 orë**

1	Objekti dhe detyrat e Hidrometeorologjisë.	2 orë
2	Atmosfera.	3 orë
3	Rrezatimi diellor.	3 orë
4	Temperatura e ajrit dhe matja e saj.	9 orë
5	Avulli i ujit në atmosferë, lagështia dhe matja e saj.	8 orë
6	Kondensimi i avujve të ujit.	9 orë

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Hidrometeorologji”, kl -11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Hidrometeorologji”, klasa 11, nxënësi duhet:

- Të dallojë njësitë matëse dhe ndryshimet atmosferike në lidhje me lartësinë dhe temperaturën
- Të shpjegojë shpërbërjen gjeografike të shtypjes atmosferike, veçanërisht në detet tona
- Të tregojë parimin e punës dhe leximin e barometrave dhe barografit
- Të argumentojë shkaqet e formimit të erës, strukturën dhe elementët e saj
- Të përshkruajë regjimet e erërave në det dhe ndikimi saj në valët e detit
- Të dallojë njësitë matëse të ballëve të erës dhe detit dhe elementët e tyre
- Të përshkruajë parimin e punës dhe leximin e erëmatësit.
- Të përshkruajë rrymat detare, shkaqet dhe elementët e tyre
- Të përshkruajë relievin e detit, veçanërisht të detit Adriatik dhe Jon
- Të shpjegojë formimet barike dhe lëvizjet e masave ajrore
- Të dallojë ciklonet dhe anticiklonet, shenjat paralajmëruese dhe veçoritë e motit gjatë këtyre dukurive.
- Të përshkruajë faktorët që shkaktojnë stuhitë dhe dukuri të tjera meteorologjike në det.
- Të interpretojë ngjarjet atmosferike, shenjat konvencionale dhe një hartë të thjeshtë moti.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Hidrometeorologji”, kl. 11 – 32 orë**

1	Shtypja atmosferike dhe matja e saj.	6 orë
2	Qarkullimi i atmosferës, erërat dhe matja e tyre.	8 orë
3	Rrymat dhe relievi i fundit të detit.	6 orë
4	Masat ajrore dhe frontet atmosferike.	8 orë
5	Parashikimi i motit.	4 orë

#### 4. Lënda “Biologji dhe ekologji e ujrave” (L-30-384-15). Kl. 10 – 68 orë,

##### ▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Biologji dhe ekologji e ujrave”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Biologji dhe ekologji e ujrave”, klasa 10, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë klasifikimin e ujrave natyror dhe treguesit bazë;
- Të listojë lëndët organike të ujrave natyror sipas origjinës;
- Të përshruajë se ç’përfaqson zinxhiri ushqimor
- Të përshkruajë kushtet e kryerjes së veprimtarisë jetësore të mikroorganizmave të ujit;
- Të shpjegojë rëndësinë e ihtiologjisë për ekonominë dhe të peshkut për ushqimin e njeriut.
- Të tregojë ndërtimin anatomik dhe fiziologjik të peshqve të ndryshëm.
- Të përshkruajë veçoritë e riprodhimit të peshkut.
- Të përshkruajë strukturat e popullimit dhe faktorët që ndikojnë në strukturën moshore të popullimit.
- Të shpjegojë fenomenin e migracionit dhe si ndikon ai në shtimin, kullotjen dhe dimrimin e peshkut.
- Të përshkruajë sistematikën e klasës së peshqve
- Të tregojë veprimet për ruajtjen e rezervave të peshkut.
- Të përshkruajë llojet e specieve të familjeve të ndryshme të peshqve të ujrave të ëmbla dhe të kripura si dhe biologjinë e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kapacitetit termik mbi gjallesat ujore;
- Të përshkruajë se ç’është dendësia e ujit;
- Të argumentojë varësinë e dendësisë nga temperatura dhe elementë të tjerë;
- Të përshkruajë parimet e përhapjes së dritës së diellit në ujra
- Të shpjegojë varësinë e ngjyrës e ujit nga baza ushqimore;
- Të dallojë përqëndrimin e bazës ushqimore me anë të kqyrjes (vizuale).
- Të dallojë ndryshimin e ujrave natyrore nga uji kimikisht i pastër;
- Të përshkruajë parimin e përcaktimit të përmbajtjes kimike të ujrave natyrore;
- Të përshkruajë karakteristikat e vlerës së pH të ujrave;
- Të përshkruajë origjinat e ndotjeve të ujrave dhe ndikimi i tyre në jetën e gjallesave ujore
- Të përshkruajë pasojat e padëshirueshme të ndotjes në ujrat siperfaqësore

##### ▪ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Biologji dhe ekologji e ujrave”, kl.10 - 68 orë

	<b>Biologjia</b>	
1	Klasifikimi i mjediseve ujore	8 orë
2	Planktoni. Karakteristikat	8 orë
	<b>Ihtiologjia</b>	
3	Objekti dhe detyrat e ihtiologjisë. Lidhja e saj me shkencat e tjera	4 orë
4	Ndërtimi anatomik dhe fiziologjik i peshkut	4 orë
5	Veçoritë e riprodhimit të peshqve dhe pjelloria e tyre	4 orë
6	Sistematika e klasës së peshqve	4 orë
7	Struktura e popullimit të peshqve	4 orë
8	Migracioni i peshqve	4 orë
9	Parimet e ruajtjes së rezervave të peshkut	4 orë
10	Speciet e familjeve të ndryshme të peshqve të ujrave të ëmbla dhe të kripura	4 orë
	<b>Ekologjia</b>	
11	Vetitë fizike të ujit	8 orë

12	Përmbajtja kimike e ujrave natyrore	8 orë
13	Ndotjet e ujrave natyrore	4 orë

### 5. Lënda “Gjuetia në ujra” (L-16-385-15). Kl. 10 – 34 orë, Kl. 11 – 32 orë

#### ▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Gjuetia në ujra”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gjuetia në ujra”, klasa 10, nxënësi duhet:

- Të tregojë etapat e zhvillimit të teknikës së peshkimit, shtrirjen e aktivitetit në ditët e sotme.
- Të përshkruajë cilësitë, sistemet dhe ndërtimin e lëndëve të fijëzuara sintetike dhe bimore.
- Të përshkruajë llojet e litarëve dhe përdorimin e tyre në veglat e peshkimit.
- Të përshkruajë llojet dhe efektet vepruese të pluskuesve që përdoren në veglat e peshkimit.
- Të përshkruajë llojet dhe efektet vepruese të peshave që përdoren në veglat e peshkimit..
- Të përshkruajë zonën hapësinore të syzës dhe sipërfaqen e efektshme të saj.
- Të përshkruajë përdorimin e rrjetave dhe pëhurave në veglat e peshkimit.

#### ▪ Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gjuetia në ujra”, kl.10 - 34 orë

1	Teknika e gjuetisë në ujrata detare dhe të ëmbla	4 orë
2	Materialet e fijëzuara të veglave të gjuetisë	6 orë
3	Litarët. Përdorimi i tyre në veglat e gjuetisë	6 orë
4	Pluskuesat. Përdorimi i tyre në veglat e gjuetisë	6 orë
5	Peshat. Përdorimi i tyre në veglat e gjuetisë	6 orë
6	Rrjetat dhe pëhurat. Përdorimi i tyre në veglat e gjuetisë	6 orë

#### ▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Gjuetia në ujra”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gjuetia në ujra”, klasa 11, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë shkaqet, pasojat e dëmtimit dhe konsumit të një rrjete;
- Të përshkruajë veglat e punës dhe rregullin për endjen e një rrjete
- Të përshkruajë ciklin e prerjes së rrjetave në forma të ndryshme
- Të shpjegojë qepjet e dy tegelave rrjetorë.
- Të përshkruajë mënyrat dhe drejtimet e qepjes së rrjetës litar
- Të tregojë hapat e punës për shformimin e perimetrit të një sipërfaqe rrjete për t’u mbushur me syza të endura ose me arnë në forma të ndryshme.
- Të argumentojë rëndësinë e përforcimit të një vegle peshkimi
- Të shpjegojë me anë të skicimit, pasojat që vijnë tek një vegël peshkimi kur qepja e rrjetave në litar nuk është bërë në masa barabarta.
- Të përshkruajë shërbimet që i bëhen veglave të peshkimit
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me varg grepash.
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me rrethim pasiv në bregdet.
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me kosha rrethues
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me kutia notuese

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gjuetia në ujra”, kl. 11 – 32 orë**

1	Shkaqet dhe pasojat e dëmtimit dhe konsumit të një rrjete;	2 orë
2	Endja, prerja dhe qepja e rrjetës	6 orë
3	Riparimi dhe përforcimit të rrjetave	6 orë
4	Jetëgjatësia e materialeve dhe veglave të peshkimit	2 orë
5	Teknika e peshkimit me varg grepash peshkimi	4 orë
6	Teknika e peshkimit me rrethim pasiv në bregdet	4 orë
7	Teknika e peshkimit me kosha peshkues	4 orë
8	Teknika e peshkimit me gracka peshkatari	4 orë

**6. Lënda “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore” (L-16-386-15). Kl. 10 – 68 orë, Kl. 11 - 64 orë**

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, kl.10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, kl.10, nxënësi duhet:

- Të argumentojë rëndësinë e zhvillimit të peshikulturës në ndihmë të agroturizmit
- Të përshkruajë format e rritjes së peshkut në ferma peshkimi, në liqene dhe rezervuare
- Të përshkruajë tipet dhe sistemet e fermave për rritjen dhe kultivimin e peshqve
- Të shpjegojë procesin e prodhimit natyral të peshqve
- Të tregojë fazat e riprodhimit në fermat e rritjes së peshqve bar dhe plankton ngrënës
- Të përshkruajë mënyrat e shtimit artificial të peshqve në ujrat e ëmbla dhe të kripura
- Të përshkruajë teknikë e rritjes zhvillimit të rritjes së peshqve me zoo dhe fitoplankton
- Të përshkruajë në përgjithësi teknologjinë e përpunimit të peshkut;
- Të përshkruajë në përgjithësi teknologjinë e përpunimit të invertebrorëve;
- Të përshkruajë vlerat ushqimore të mishit të peshkut për njeriun;
- Të tregojë rregullat e ndërhyrjes për ruajtjen e freskisë së peshkut gjatë transportimit;
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve dhe materialet ndihmëse që përdoren në stabilimentet e përpunimit dhe ruajtjes së peshkut;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, kl. 10 - 68 orë**

	<b><i>Kultivimi</i></b>	
1	Peshikultura, zhvillimi dhe rëndësia e saj në ndihmë të agroturizmit	4 orë
2	Tipet dhe sistemet e fermave për rritjen dhe kultivimin e peshqve	6 orë
3	Rritja e peshqve në ferma peshkimi, në liqene dhe rezervuare	6 orë
4	Prodhimtaria natyrale e peshqve	4 orë
5	Fazat e riprodhimit në fermat e rritjes së peshqve bar dhe plankton ngrënës	2 orë
6	Mënyrat e shtimit artificial të peshqve në ujrat e ëmbla dhe të kripura	16 orë
7	Rritja e peshqve me zooplankton dhe fitoplankton	6 orë
	<b><i>Përpunimi</i></b>	
8	Teknologjia e përpunimit të produkteve nga gjuetia	6 orë
9	Vlerat ushqimore të produkteve ujore	4 orë

<b>10</b>	Transportimi dhe ruajtja e lëndës së parë (produkteve ujore)	6 orë
<b>11</b>	Ambalazhet dhe materialet ndihmëse në stabilimente dhe frigoriferë	8 orë

▪ **Synimet e përgjithshme të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, klasa 11, nxënësi duhet:

- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të peshqve bregdetarë
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të qefujve në ujra të njelmëta
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të kocës dhe lëvrekut në fermat dhe lagunat bregdetare
- Të tregojë masat për një transport të sigurtë të rasateve nga zonat bregdetare deri në fermat e peshkimit.
- Të përshkruajë procesin e rritjes së peshqve bregdetarë me kosha stacionarë
- Të përshkruajë përdorimin e ushqimeve natyrale dhe artificiale për rritjen e peshqve bregdetarë
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të ngjalës në fermat pranë rezervuareve
- Të listojë sëmundjet e peshqve dhe masat për parandalimin e përhapjes së tyre
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të molusqeve në zonat bregdetare
- Të përshkruajë faktorët fiziko-kimik të mjedisit ujor që në mbarëvajtjen e një ferme peshku
- Të përshkruajë format e ruajtjes së freskisë së peshkut në të thatë dhe në të njomë;
- Të tregojë teknologjinë e kriposjes në të thatë dhe në të njomë pas zënies në anijes ashtu dhe në stabilimentet e përpunimit;
- Të përshkruajë lëndët konservuese që përdoren në stabilimentet e përpunimit të peshkut;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kultivimi dhe përpunimi i produkteve ujore”, kl. 11 – 64 orë**

	<b><i>Kultivimi</i></b>	
<b>1</b>	Rritja dhe kultivimi i peshqve bregdetarë	4 orë
<b>2</b>	Rritja dhe kultivimi i qefujve në ujra të njelmëta	4 orë
<b>3</b>	Rritja dhe kultivimi i kocës dhe lëvrekut në fermat dhe lagunat bregdetare	4 orë
<b>4</b>	Transportimi i rasateve nga zonat bregdetare deri në fermat e peshkimit	4 orë
<b>5</b>	Rritja e peshqve bregdetarë me kosha stacionarë	4 orë
<b>6</b>	Përdorimi i ushqimeve natyrale dhe artificiale për rritjen e peshqve bregdetarë	4 orë
<b>7</b>	Rritja dhe kultivimi i ngjalës në fermat pranë rezervuareve vaditës	2 orë
<b>8</b>	Sëmundjet e peshqve dhe masat për parandalimin e përhapjes	4 orë
<b>9</b>	Rritja dhe kultivimi i molusqeve në zonat bregdetare	4 orë
<b>10</b>	Faktorët fiziko-kimik të mjedisit ujor që në mbarëvajtjen e një ferme peshku	10 orë
	<b><i>Përpunimi</i></b>	
<b>11</b>	Pastrimi i peshkut dhe përpunimi paraprak i tij	6 orë
<b>12</b>	Kriposja e peshkut dhe metodat e kriposjes	6 orë
<b>13</b>	Bazat e përgatitjes për konservim	8 orë



## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale

### 1. Moduli “Kryerja e notimit dhe vozitjes“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT	
Titulli dhe kodi	KRYERJA E NOTIMIT DHE VOZITJES M-30-162-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për përgatitjen në notim dhe në vozitjen e mjeteve të lehta lundruese
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi noton</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjedhja e vendit dhe stinës për notim;</li><li>- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet notimi;</li><li>- Përgatitja fizike trupore;</li><li>- Futja graduale në ujë;</li><li>- Përdorimi i mjeteve pluskuese ndihmëse;</li><li>- Lëvizja e gjymtyrëve në ujë;</li><li>- Pluskimi i trupit;</li><li>- Teknika e frymëmarrjes;</li><li>- Qëndrimi në pozicione të ndryshme pluskimi;</li><li>- Notimi;</li><li>- Zhytja në ujë.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë vendin dhe stinën e përshtatshme për notim;</li><li>- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet notimi;</li><li>- të realizojë përgatitjen fizike trupore në tokë;</li><li>- të futet gradualisht në ujë për të përshtatur temperaturën e trupit me atë të ujit;</li><li>- të përdorë si duhet mjetet pluskuese ndihmëse në ujë;</li><li>- të lëvizë gjymtyrët në ujë për të realizuar pluskimin;</li><li>- të realizojë pluskimin;</li><li>- të realizojë teknikën e frymëmarrjes, pa provokuar pirjen e</li></ul>

- 
- ujit;
  - të qëndrojnë në pozicione të ndryshme pluskimi sipas udhëzimeve;
  - të notojë, duke përshkuar distanca të ndryshme;
  - të zhytet në ujë në kohëzgjatje dhe zhvendosje të ndryshme.

## **RM 2 Nxënësi kryen vozitje individuale të mjetit lundrues**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjeteve dhe pajimeve për vozitje;
- Teknika e futjes së varkës në ujë;
- Vendosja e skalmave;
- Vendoja e rremave;
- Teknika e mbajtjes së rremave;
- Pozicionimi i vozitësit ulur;
- Teknika e lëvizjes së rremave për ecjen para;
- Teknika e lëvizjes së rremave për ecjen prapa;
- Teknika e lëvizjes së rremave për kthim;
- Teknika e lëvizjes së rremave për ndalim;
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës;
- Pastrimi i mjetit lundrues;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet e duhura për realizimin e vozitjes;
- të zbatojë teknikat e futjes së mjetit lundrues në ujë, pa e dëmtuar atë;
- të vendosë skalmat në vendet e duhura;
- të vendosë rremat në vendin e duhur;
- të zbatojë teknikën e mbajtjes së rremave në ujë;
- të pozicionojë trupin ulur, për vozitje;
- të lëvizë rremat sipas teknikës së duhur, për zhvendosjen para, prapa, kthim dhe ndalim të mjetit lundrues;
- të mirëmbajë mjetet e punës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 3 Nxënësi realizon mënyra të ndryshme vozitjeje të mjetit lundrues**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit dhe mjeteve të punës për vozitje;
- Përgatitja e mjeteve dhe pajimeve të punës;
- Teknika e vozitjes në këmbë;
- Teknika e vozitjes në çift;
- Teknika e vozitjes në grup;

- Teknika e vozitjes e feneristit;
- Teknika e vozitjes me një rremë (morrazë);
- Teknika e vozitjes me palluqe;
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin dhe mjetet e punës për vozitje;
- të përgatisë mjetet dhe pajimet e punës për vozitje;
- të vozisë në këmbë, duke ruajtur ekuilibrin e trupit në mjetin lundrues;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në këmbë;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në çift;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në grup;
- të zbatojë teknikën e vozitjes së feneristit;
- të zbatojë teknikën e vozitjes me një rremë (morrazë);
- të zbatojë teknikën e vozitjes me palluqe;
- të mirëmbajë mjetet e punës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në det, bregdet, rezervuare e pishina.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të notimit dhe vozitjes.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për notim, për përdorimin e mjeteve të punës për vozitje dhe të pajimeve ndihmëse.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e notimit dhe vozitjes.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- ambiente për notim dhe vozitje;
  - mjete pluskuese (xhaketa dhe rrathë shpëtimi);
  - varkë me mjetet dhe pajimet e nevojshme për vozitje;
-

## 2. Moduli “Realizimi i nyjeve detare“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 10

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	REALIZIMI I NYJEVE DETARE	M-16-163-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për realizimin e nyjeve (lidhjeve) detare kryesore të përdorshme në anije peshkimi	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe vlerësimi	<p><b>RM 1 Nxënësi realizon nyje detare të grupit I</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t'u lidhur;</li><li>- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së thjeshtë;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë dopio;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit njëshe;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit dyshe;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit treshe;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së tetës njëshe;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së tetës dyshe;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së spirancës;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së sanallit;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së kalunit tek;</li><li>- Teknika e realizimit të nyjës së kalunit çift;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimat për t'u lidhur;</li><li>- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;</li><li>- të realizojë saktë nyjen e thjeshtë sipas teknikës së duhur;</li><li>- të realizojë saktë nyjen e mbarë sipas teknikës së duhur;</li><li>- të realizojë saktë nyjen e mbarë dopio;</li></ul>	

- 
- të realizojë saktë nyjen e akostimit njëshe;
  - të realizojë saktë nyjen e akostimit dyshe;
  - të realizojë saktë nyjen e akostimit treshe;
  - të realizojë saktë nyjen e tetës njëshe;
  - të realizojë saktë nyjen e tetës dyshe;
  - të realizojë saktë nyjen e spirancës;
  - të realizojë saktë nyjen e sanallit;
  - të realizojë saktë nyjen e kalunit tek;
  - të realizojë saktë nyjen e kanlunit çift;
  - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi realizon nyje detare të grupit II**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t'u lidhur;
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- Teknika e realizimit të nyjës së kacaskotës;
- Teknika e realizimit të nyjës së flamurit njëshe;
- Teknika e realizimit të nyjës së flamurit dyshe;
- Teknika e realizimit të nyjës margarita I;
- Teknika e realizimit të nyjës margarita II;
- Teknika e realizimit të nyjës margarita III;
- Teknika e realizimit të nyjës gjysëm volla;
- Teknika e realizimit të nyjës volla;
- Teknika e realizimit të nyjës së stopimit;
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit njëshe;
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit dyshe;
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit treshe;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimat për t'u lidhur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë nyjen e kacaskotës sipas teknikës së duhur;
- të realizojë saktë nyjen e flamurit njëshe sipas teknikës së duhur;
- të realizojë saktë nyjen e flamurit dyshe;
- të realizojë saktë nyjen margarita I;
- të realizojë saktë nyjen margarita II;
- të realizojë saktë nyjen margarita III;

- të realizojë saktë nyjen gjysëm volla;
- të realizojë saktë nyjen volla;
- të realizojë saktë nyjen e stopimit;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit njëshe;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit dyshe;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit treshe;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 3 Nxënësi realizon nyje detare të grupit III**

#### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t'u lidhur;
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë me fund;
- Teknika e realizimit të nyjës së grepit;
- Teknika e realizimit të nyjës së pandulit;
- Teknika e realizimit të nyjës së bocës;
- Teknika e realizimit të gacës fikse njëshe;
- Teknika e realizimit të gacës fikse dyshe;
- Teknika e realizimit të gacës së lëvizshme;
- Teknika e realizimit të nyjës këmbë pule;
- Teknika e realizimit të nyjës së diamondit;
- Teknika e realizimit të nyjës së peshkatarit;
- Teknika e realizimit të nyjës së rremit të sanallit;
- Teknika e realizimit të nyjës së shamadurit;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimat për t'u lidhur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë nyjen e mbarë me fund;
- të realizojë saktë nyjen e grepit;
- të realizojë saktë nyjen e pandulit;
- të realizojë saktë nyjen e bocës;
- të realizojë saktë gacën fikse njëshe;
- të realizojë saktë gacën fikse dyshe;
- të realizojë saktë gacën e lëvizshme;
- të realizojë saktë nyjen këmbë pule;
- të realizojë saktë nyjen e diamondit;
- të realizojë saktë nyjen e peshkatarit;
- të realizojë saktë nyjen e rremit të sanallit;

- të realizojë saktë nyjen e shamadurit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat; higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë apo anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për realizimin e nyjeve duke përdorur sfillaca, abica dhe cima të përshtatshme për lidhje.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e nyjeve dhe lidhjeve detare.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune si klasë apo anije.
  - Sfillaca, abica dhe cima të përshtatshme për lidhje.
  - Skema të nyjeve (lidhjeve) të ndryshme detare
-

### 3. Moduli “Mbrojtja e anijes nga ndryshku“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 10

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MBROJTJA E ANIJES NGA NDRYSHKU	M-30-165-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për marjen e masave për mbrojtjen e anijes nga ndryshku	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit mjetet për mbrojtjen e anijes nga ndryshku</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Leximi i etiketës së bojës që do të përdoret për kushtet dhe masat që duhen marrë për përdorimin dhe mbrojtjen e shëndetit gjatë përdorimit;</li><li>- Përzgjedhja e vendit të punës për mirëmbajtje;</li><li>- Përgatitja e uniformës personale të mbrojtjes në punë;</li><li>- Përgatitja e mjeteve për largimin e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit;</li><li>- Përgatitja e skelave për punime në lartësi dhe jashtë bordit;</li><li>- Përgatitja e mjeteve të punës për lyerje;</li><li>- Përgatitja e bojës kundra ndryshkut;</li><li>- Përzgjedhja e holluesit të bojës;</li><li>- Përgatitja e bojës kundra mikro-organizmave;</li><li>- Përgatitja e brezit të sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të lexojë etiketën e bojës që do të përdoret për kushtet dhe masat që duhen marrë për përdorimin dhe mbrojtjen e shëndetit gjatë përdorimit;</li><li>- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për mirëmbajtje nga ndryshku;</li><li>- të përgatisë uniformën personale të mbrojtjes në punë;</li><li>- të përgatisë mjetet për largimin e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit;</li></ul>	



- të përgatisë skelat për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të përgatisë mjetet e punës për lyerje;
- të përgatisë bojën kundra ndryshkut;
- të përzgjedhë holluesin e përshtatshëm të bojës;
- të përgatisë bojën kundra mikro-organizmave duke e përzierë me llojin dhe sasinë e tretësit të rekomanduar;
- të përgatisë brezin e sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi pastron sipërfaqen e metalit (të anijes) nga ndryshku**

### ***Përmbajtja:***

- Veshja e uniformës personale të mbrojtjes në punë;
- Kepja e ndryshkut me çekiç;
- Heqja e ndryshkut me rrashpë;
- Heqja e shtresave të mëdha të ndryshkut;
- Pastrimi i shtresave të imëta të ndryshkut;
- Pastrimi i pluhurave të ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit;
- Mbledhja e mbeturinave të ndryshkut;
- Largimi i mbeturinave të ndryshkut;
- Përdorimi i skelës për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- Përdorimi i brezit të sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën personale të mbrojtjes në punë;
- të kepe shtresën e ndryshkur në sipërfaqen e metalit me çekiç;
- të heqë shtresat e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit me rrashpë;
- të përdorë çekiçin elektrik ose me ajër për heqjen e shtresave të mëdha të ndryshkut nga sipërfaqja e metalit;
- të pastrojë shtresat e imëta të ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit, duke përdorë si furçën e telit të dorës ashtu edhe furçën e telit elektrike;
- të pastrojë pluhurat e ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit me fshesën e dorës;
- të mbledhë me fshesë mbeturinat e ndryshkut pas pastrimit të sipërfaqes së metalit;
- të largojë mbeturinat e ndryshkut pas pastrimit të sipërfaqes së metalit;
- të përdorë skelën për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të përdorë brezin e sigurimit për punime në lartësi dhe

- jashtë bordit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 3 Nxënësi lyen me bojë sipërfaqen e metalit për mbrojtjen e anijes nga ndryshku**

#### ***Përmbajtja:***

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet lyerja;
- Sigurimi që sipërfaqja që do të lyhet të jetë e thatë dhe pa mbetje të tjera apo kristale kripe;
- Lyerja e njollave me bojë kundra ndryshkut;
- Lyerja e njollave me bojë kundra mikro-organizmave;
- Lyerja e krejt sipërfaqes së metalit me bojë kundra mikro-organizmave;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet lyerja;
- të sigurohet që sipërfaqja që do të lyhet të jetë e thatë dhe pa mbetje të tjera apo kristale kripe;
- të lyejë me furçë njollat me bojë kundra ndryshkut, si dorë e parë;
- të lyejë njollat me bojë kundra ndryshkut, si dorë e dytë;
- të lyejë njollat me bojë kundra mikro-organizmave;
- të lyejë krejt sipërfaqen e metalit me bojë kundra mikro-organizmave (dorë e dytë);
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për realizimin e mbrojtjes së anijes nga ndryshku.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për keqjen, pastrimin dhe lyerjen e një sipërfaqeje metali në anije.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
moduli**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- uniformën personale të mbrojtjes në punë si: helmetën mbrojtëse, syze mbrojtëse, kominoshet e punës, dorezat e lëkurës, tapat e mbrojtjes së veshëve, këpucët e sigurta, kufiet e zhurmave, maskën mbrojtëse ndaj avujve të dëmshëm
  - mjedise pune në anije.
  - bojë kundra ndryshkut, bojë antivegetative, diluentë, furçe dhe rrula.
  - mjete pune për realizimin e kepjes, pastrimit dhe lyerjes së një sipërfaqeje metali të ndryshkur në anije.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e kepjes së një sipërfaqeje metali të ndryshkur në anije
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e pastrimit të një sipërfaqeje metali të kepur
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e lyerjes së një sipërfaqeje metali të pastruar
-

#### 4. Moduli “Kallafatimi dhe stukimi i mjeteve lundruese prej druri”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>KALLAFATIMI DHE STUKIMI I MJETEVE LUNDRUESE PREJ DRURI</b>	<b>M-30-173-15</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që aftëson nxënësit për realizimin e kallafatimit dhe stukimit të mjeteve lundruese prej druri.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit mjetet dhe veglat e punës për kallafatim</b> <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve të punës;</li><li>- Veshja e uniformës së punës;</li><li>- Përgatitja e kallafatit;</li><li>- Përgatitja e shtupave të kallafatit;</li><li>- Përgatitja e daltave;</li><li>- Përgatitja e çekiçave prej druri;</li><li>- Përgatitja e stukos;</li><li>- Rregulla e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë mjetet dhe pajisjet e punës;</li><li>- të veshë uniformën e punës, si: dorezat e lëkurës, kominoshet e punës, këpucët e sigurta, helmetën plastike, syzet mbrojtëse, tapat e mbrojtjes së veshëve, maskën mbrojtëse ndaj avujve të dëmshëm;</li><li>- të përgatisë kallafatin për kallafatim;</li><li>- të përgatisë shtupat e kallafatit, sipas përmasës së hapësirës për kallafatim;</li><li>- të përgatisë daltat e duhura për kallafatim;</li><li>- të përgatisë çekiçat prej druri të madhësive të ndryshme;</li><li>- të përgatisë stukon për stukim;</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi kallafaton dhe stukon</b> <b>Përmbajtja:</b></p>	

- Largimi e papastërtive në hapësirat midis dy majereve;
- Pastrimi i pluhurave të mbetura nga largimi i papastërtive;
- Vendosja e shtupës së kallfatit në hapësirën midis dy majereve;
- Ngjeshja e kallfatit në hapësirën midis dy majereve;
- Pastrimi i zonës së kallafatuar;
- Stukimi në vendet e kallafatuara;
- Lyerja e vendeve të stukuara;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Rregullat të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të largojë papastërtitë me letër zmerile në hapësirat midis dy majereve;
- të pastrojë me furçe pluhurat e mbetura nga pastrimi me letër zmerile;
- të vendosë me dorë shtupën e kallfatit, në hapësirën midis dy majereve;
- të ngjeshë kallafatin në hapësirën midis dy majereve, duke përdorur daltën dhe çekiçin;
- të pastrojë zonën e kallafatuar me furçe;
- të stukoje me shpatull në vendet e kallafatuara;
- të lyejë me bojë vendet e stukuara mbas tharjes së stukos;
- të pastrojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sig. teknik e të mbrojtjes së mjedisit.

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një repart pune kallafatimi ose mjet lundrimi prej druri.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e kallafatimit dhe stukimit të skafit të një mjeti lundrues apo të një kuverte prej druri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të kallafatimit dhe stukimit të skafit të një mjeti lundrues apo të një kuverte prej druri.

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- mjedise pune në një repart kallafatimi ose mjet lundrimi prej druri
  - mjete e punës për proceset e kallafatimit dhe stukimit.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e kallafatimit dhe stukimit të një skafi apo kuverte prej druri.
  - stuko, litar kërpi, shtupa kallafati, bojë antivegjetative, furçe, rrula, letër zmerile ose poliatrice.

## 5. Moduli “Qepja e cimave dhe kavove në anije“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 10

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	QEPJA E CIMAVE DHE KAVOVE NË ANIJE	M-30-1192-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për qepjen, trajtimin dhe përdorimin e cimave dhe kavove në anije	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përdor mjetet e punës për qepjen cimave</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vendi i punës për qepje;</li><li>- Materialet dhe veglat për qepjen e cimave;</li><li>- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;</li><li>- Përdorimi i sfillacave;</li><li>- Përdorimi i çakmakut;</li><li>- Përdorimi i skoçit;</li><li>- Përdorimi i kaviles;</li><li>- Përdorimi i fugave;</li><li>- Përdorimi i çekiçit të drurit;</li><li>- Përdorimi i thikës;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për qepje;</li><li>- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e cimave;</li><li>- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;</li><li>- të përdorë sfillacat për kuanimin e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;</li><li>- të përdorë çakmakun për djegjen e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;</li><li>- të përdorë çakmakun për djegjen e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;</li><li>- të përdorë kavilen për distancimin e rrumave të cimës;</li></ul>	

- 
- të përdorë çekiçin për goditjen e kaviles distancuese;
  - të përdorë thikën për prerjen e sfillacës dhe cimave;
  - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi realizon qepjen e cimave**

- Përzgjedhja cimave për t'u qepur;
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- Teknika e qepjes së cimës shkurtas;
- Teknika e qepjes së cimës gjatas;
- Teknika e realizimit të gacës së cimës me ndërthurje;
- Teknika e realizimit të gacës së cimës me qepje dhe kuanim;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë cimat e përshtatshme për qepje;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- të realizojë saktë qepjen e cimës shkurtas;
- të realizojë saktë qepjen e cimës gjatas;
- të realizojë saktë gacën e cimës me ndërthurje;
- të realizojë saktë gacën e cimës me qepje dhe kuanim;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;

## **RM 3 Nxënësi përdor mjetet e punës për qepjen e kavove**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhë vendin e punës për qepje;
- Përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e kavos;
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- Përdorimi i sfillacave;
- Përdorimi i kaviles;
- Përdorimi i morsetave;
- Përdorimi i çekiçit;
- Përdorimi i darëve;
- Përdorimi i bagotës;
- Përdorimi i daltës në kudhrën metalike;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për qepje;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e kavos;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- të përdorë sfillacat për kuanimin e fundeve të kavos;
- të përdorë kavilen për distancimin e rrumave të kavos;
- të përdorë morsetat për shtërngimin dhe fiksimin e kavove;
- të përdorë çekiçin për goditjen e kaviles distancuese;
- të përdorë çekiçin për goditjen e daltës për prerje rrumash të vendosur mbi kudhrën metalike;
- të përdorë darët për tërheqjen e rrumave në ndërthurje;
- të përdorë bagotën për gacat e vogla kaluese;
- të përdorë morsetat për bërjen e gacave;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi realizon qepjen e kavove**

**Përmbajtja:**

- Përzgjedhja e kavove për qepje;
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- Teknika e realizimit të qepjes së kavos shkurtas;
- Teknika e realizimit të qepjes së kavos gjatas;
- Teknika e realizimit të gacave me qepje;
- Teknika e realizimit të gacave me morseta;
- Teknika e realizimit të gacave me bagota dhe morseta;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë kavot e përshtatshme për t'u qepur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë qepjes së kavos shkurtas;
- të realizojë saktë qepjes së kavos gjatas;
- të realizojë saktë gacën me qepje;
- të realizojë saktë gacën me morseta;
- të realizojë saktë gacën me bagota dhe morseta;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;



- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë apo edhe në anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për realizimin e qepjen e cimave dhe kavove si dhe në përgatitjen e mjeteve dhe mekanizmave për kalim cimash dhe kavosh.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për qepjeve të cimave dhe kavove si dhe në përdorimin e mjeteve dhe mekanizmave për kalim cimash dhe kavosh.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- mjedise pune si klasë apo anije.
  - mjete pune për realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove
  - sfillaca, abica, cima dhe kavo të përshtatshme për lidhje dhe qepje.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e nyjeve detare
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kalimin e cimave dhe kavove në mjetet dhe mekanizmat e instaluar në anije
  - parango, makarà, taje, maket pasteke, kacaskote, okio, gameta, bagota, marseta, darë, pinca, etj.
-

## 6. Moduli “Teknikat personale të mbijetesës në det”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TEKNIKAT PERSONALE TË MBIJETESËS NË DET (IMO 1.19)	M-30-1035-15
Qëllimi i modulit	Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit me njohuri e aftësi për të ndërmarrë veprime të menjëhershme kur ndeshen me një situatë emergjente (rreziku) që mund të kërcënojë mbijetesën e tyre personale si: përplasja e anijes, futja e ujit në anije, mbytja dhe braktisja e anijes etj.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW '78, i amenduar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përshkruan parimet e sigurisë e mbijetesës në det</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Udhëzimet mbi sigurinë dhe ekspozimi i tyre</li><li>- Rëndësia e zbatimit të rregullave të sigurisë</li><li>- Parimet e mbijetesës në det (familjarizimi në bord, ushtrimet, trajnimet dhe alarmet sistematike, përgatitja për çdo emergjencë, veprimet që duhet të kryhen, rreziqet kryesore për të mbijetuarit).</li><li>- Mjetet e shpëtimit, barka e shpëtimit, kostumet e zhytjes, xhaketat e shpëtimit, mjetet e lëshimit etj.</li><li>- Manuali i trajnimit specifik SOLAS (Safety of Life at Sea) për çdo anije.</li><li>- Simbolet e sigurisë dhe identifikimi i simboleve të sigurisë që përdoren në anije.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim</li><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të tregojë rëndësinë e ekspozimit të udhëzimeve mbi sigurinë;</li><li>- të argumentojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë;</li><li>- të shpjegojë parimet e mbijetesës në det;</li><li>- të dallojë mjetet e shpëtimit, barka e shpëtimit, kostumet e zhytjes, xhaketat e shpëtimit, mjetet e lëshimit etj.;</li><li>- të shpjegojë se çafre është Manuali i trajnimit specifik</li></ul>	

- SOLAS (Safety of Life at Sea) për çdo anije.
- të dallojë dhe interpretojë simbolet e sigurisë që përdoren në anije.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 2 Nxënësi përshkruan situatat dhe masat në një emergjencë (rrezik).**

***Përmbajtja:***

- Llojet e emergjencave që çojnë në zjarr apo fundosje të anijes (përplasja, rënia në tokë, lëvizja e ngarkesës, ngarkesat e rrezikshme, shpërthimi i sallës së mashinës, skafi etj.).
- Evidentimi i masave që merren kundër këtyre emergjencave
- Përshkrimi i përgjithshëm i mënyrave për të luftuar zjarrin
- Përshkrimi i përgjithshëm i mënyrave për të luftuar ujin
- Efektiviteti i mjeteve të shpëtimit të jetës dhe rëndësia e eksperiencës së ekuipazhit
- Lista e Apelit dhe e sinjaleve të emergjencës, nevoja e tyre dhe e trajnimeve për to.
- Ekuipazhi dhe instruksionet mbi emergjencën.
- Kuptimi i sinjaleve të emergjencës
- Instruksionet e Listës së Apelit dhe detyrat
- Vendodhja dhe përdorimi i pajisjeve të shpëtimit
- Rrugët e shpëtimit dhe pajisjet
- Emergjencat që sjellin mbytjen e anijes
- Mënyrat e mbijetesës.
- Pajisjet shpesh të cilat merren me vete nga anija si mjete të mbijetesës (n.q.s. koha e lejon).
- Problemet që, gjatë braktisjes së anijes, shkaktohen nga mjetet e shpëtimit të palëshura, mungesa e ndriçimit, mungesa e kryerjes së detyrës nga personeli etj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të listojë llojet e emergjencave që çojnë në zjarr apo fundosje të anijes;
- të evidentojë masat që merren kundër këtyre emergjencave;
- të përshkruajë mënyrat për të luftuar zjarrin;
- të përshkruajë mënyrat për të luftuar ujin;
- të tregojë rëndësinë e eksperiencës së ekuipazhit për efektivitetin e mjeteve të shpëtimit të jetës;
- të argumentojë nevojën e Listës së Apelit dhe të sinjaleve të emergjencës, si dhe rëndësinë e trajnimeve për to.
- të argumentojë rëndësinë e instruktimit të ekuipazhit mbi emergjencën;
- të shpjegojë kuptimin e sinjaleve të emergjencës;

- të shpjegojë instruksionet e Listës së Apelit dhe detyrat;
- të tregojë vendodhjen dhe përdorimin e pajisjeve të shpëtimit;
- të tregojë rrugët e shpëtimit dhe pajisjet;
- të listojë emergjencat që sjellin mbytjen e anijes;
- të shpjegojë mënyrat e mbijetesës;
- të tregojë cilat janë pajisjet shtesë të cilat merren me vete nga anija si mjete të mbijetesës (n.q.s. koha e lejon);
- të tregojë cilat janë problemet që shkaktohen gjatë braktisjes së anijes dhe shkaqet e tyre.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 3 Nxënësi përshkruan parimet dhe procedurat e braktisjes së anijes në det**

***Përmbajtja:***

- Braktisja e anijes si zgjidhja e fundit.
- Anija si shansi më i mirë për të mbijetuar.
- Braktisja e anijes vetëm kur të gjitha masat e tjera dështojnë.
- Përgatitja (vetë-përgatitja) personale për braktisjen e anijes
- Domosdoshmëria e shmangjes së panikut
- Detyrat e ekuipazhit ndaj pasagjerëve
- Detyrat e ekuipazhit për lëshimin e pajisjeve të shpëtimit.
- Urdhëri (vetëm) i kapitenit për braktisjen e anijes
- Mënyrat e domosdoshme për mbijetesën pasi anija është braktisur si, qëndrimi mbi ujë, të ngrohtit/ftohtit, konsumi i ujit dhe ushqimeve, mënyra e komunikimit me anijet apo varkat e shpëtimit etj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë pse braktisja e anijes duhet parë si zgjidhja e fundit;
- të argumentojë pse anija është shansi më i mirë për të mbijetuar;
- të tregojë pse braktisja e anijes bëhet vetëm kur të gjitha masat e tjera dështojnë;
- të tregojë veprimet për përgatitjen (vetë-përgatitjen) personale për braktisjen e anijes;
- të argumentojë domosdoshmërinë e shmangjes së panikut;
- të renditë detyrat e ekuipazhit ndaj pasagjerëve;
- të renditë detyrat e ekuipazhit për lëshimin e pajisjeve të shpëtimit;
- të tregojë pse urdhëri për braktisjen e anijes është vetëm i kapitenit;
- të tregojë mënyrat e domosdoshme për mbijetesën pasi anija është braktisur.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 4 Nxënësi përshkruan mjetet kolektive të mbijetesës dhe shpëtimit në anije**

***Përmbajtja:***

- Barkat e mbijetesës, tipet e ndryshme të barkave të mbijetesës si, të hapura, gjysëm të mbyllura, vetëfryrëse gjysëm të mbyllura, totalisht të mbyllura, totalisht të mbyllura me sistem ajrosje të vetën, të mbrojtura nga zjarri
- Në anijet pasagjere kapaciteti i barkave të mbijetesës të jetë i mjaftueshëm për çdo person në bord.
- Në anijet e ngarkesës kapaciteti i barkave të mbijetesës të jetë sa dyfishi i personave në bord.
- Lëshimi i barkave të mbijetesës nga vinçat, me rënie të lirë
- Masat që duhet të merren për të garantuar sigurinë personale gjatë lëshimit të barkave të mbijetesës.
- Mënyra e imbarkimit nga anija në barkën e mbijetesës.
- Trapet e mbijetesës, dy tipet e trapeve të mbijetesës, statik dhe me vetëfryrje.
- Barka e shpëtimit, minimumi i barkave të shpëtimit për anijet pasagjere dhe anijet e ngarkesës.
- Kërkesat të cilat lejojnë një barkë mbijetese të jetë edhe barkë shpëtimi.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë tipet e ndryshme të barkave të mbijetesës;
- të tregojë që në anijet pasagjere kapaciteti i barkave të mbijetesës të jetë i mjaftueshëm për çdo person në bord dhe në anijet e ngarkesës kapaciteti i barkave të mbijetesës të jetë sa dyfishi i personave në bord;
- të shpjegojë si bëhet lëshimi i barkave të mbijetesës nga vinçat ose me rënie të lirë;
- të tregojë masat që duhet të merren për të garantuar sigurinë personale gjatë lëshimit të barkave të mbijetesës;
- të shpjegojë mënyrën e imbarkimit nga anija në barkën e mbijetesës;
- të përshkruajë dy tipet e trapeve të mbijetesës, statik dhe me vetëfryrje;
- të llogaritë numrin minimal të barkave të shpëtimit për anijet pasagjere dhe anijet e ngarkesës;
- të tregojë kërkesat të cilat lejojnë një barkë mbijetese të jetë edhe barkë shpëtimi.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 5 Nxënësi përshkruan mjetet individuale të shpëtimit të jetës në det.**

***Përmbajtja:***

- Rrathët e shpëtimit, shpërndarja e tyre nëpër anije;
  - Pajisjet shtesë që mund të lidhen tek rrathët e shpëtimit.
-

- 
- Xhaketat e shpëtimit, numri i xhaketave të shpëtimit për anijet pasagjere dhe anijet e ngarkesës.
  - Lundrueshmëria e xhaketës së shpëtimit (materiali i lundrueshëm, fryrja).
  - Pajisjet e tjera të xhaketës së shpëtimit si drita fikse apo vezulluese, bilbili i siguar me sfillacë.
  - Kostumet e zhytjes/veshjet anti ekspozim, përshkrimi i kostumit të zhytjes.
  - Detyrimi i veshjes së kostumit të zhytjes/veshjes anti-ekspozim nga personat në barkën e shpëtimit.
  - Detyrimi që në anijet e ngarkesës çdo anëtar i ekuipazhit duhet të ketë kostum zhytje/veshjet anti ekspozim.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rrathët e shpëtimit dhe tregojë shpërndarjen e tyre nëpër anije;
- të tregojë pajisjet shtesë që mund të lidhen tek rrathët e shpëtimit;
- të llogaritë numrin e xhaketave të shpëtimit për anijet pasagjere dhe anijet e ngarkesës;
- të shpjegojë lundrueshmërinë e xhaketës së shpëtimit;
- të përshkruajë pajisjet e tjera të xhaketës së shpëtimit si drita fikse apo vezulluese, bilbili i siguar me sfillacë;
- të përshkruajë kostumet e zhytjes/veshjet anti ekspozim;
- të argumentojë detyrimin e veshjes së kostumit të zhytjes/veshjes anti-ekspozim nga personat në barkën e shpëtimit;
- të argumentojë detyrimin që në anijet e ngarkesës çdo anëtar i ekipazhit duhet të ketë kostum zhytje/veshjet anti ekspozim.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 6 Nxënësi vesh dhe përdor mjetet personale/kolektive të mbijetesës dhe shpëtimit në det**

***Përmbajtja:***

**Rrathët e shpëtimit:**

- Procedurat e marrjes së një rrethi shpëtimi, hedhjes së tij në ujë dhe vëzhgimit të pluskimit, dritave vetë ndezëse, sinjaleve tymuse vetëndezëse dhe cimave pluskuese.

**Xhaketat e shpëtimit pa fryrje:**

- Veshja e një xhakete shpëtimi pa fryrje në mënyrë korrekte.
- Hedhja në ujë nga lartësia me xhaketë shpëtimi të veshur.
- Notimi në një distancë të shkurtër me xhaketë shpëtimi të veshur.
- Testimi i bilbilit të xhaketës së shpëtimit.
- Vënia në punë e dritës së xhaketës së shpëtimit pa fryrje.

**Xhaketat e shpëtimit me fryrje:**

- 
- Veshja e një xhakete shpëtimit me fryrje në mënyrë korrekte.
  - Hedhja në ujë nga lartësia me xhakete shpëtimit të veshur.
  - Notimi në një distancë të shkurtër me xhakete shpëtimit të veshur.
  - Testimi i bilibilit të xhaketës së shpëtimit me fryrje.
  - Testimi i metodave jo automatike të fryrjes.

**Kostumet e zhytjes:**

- Shpaketimi dhe veshja e kostumit të zhytjes.
- Hipja dhe zbritja në shkallë vertikale me kostum dhe xhakete shpëtimit veshur, hedhja në ujë nga lartësia, notimi në një distancë të shkurtër, përmbushja e detyrave të vëna gjatë braktisjes, testimi i bilibilit, vënia në punë e dritës.

**Mbijetesat personale pa xhakete shpëtimit:**

- Teknika e pluskimit në ujë pa xhakete shpëtimit, kostum zhytjeje apo kostum anti-ekspozimi.

**Hipja në mjetin e mbijetesës:**

- Hipja në mjetin e mbijetesës nga anija apo nga uji me xhaketa shpëtimit veshur.
- Ndiqja ndaj të tjerëve.
- Përdorimi i pajisjeve përfshirë këtu dhe spirancën lundruese.
- Drejtimi dhe kthimi i trapit të mbijetesës.
- Procedura e braktisjes së trapit të mbijetesës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

**Në lidhje me rathët e shpëtimit:**

- të marrë një rreth shpëtimit, të bëjë hedhjen e tij në ujë dhe vëzhgimin e pluskimit, dritave vetë ndezëse, sinjaleve tymuse vetëndezëse dhe cimave pluskuese.

**Në lidhje me xhaketat e shpëtimit pa fryrje:**

- të veshë një xhakete shpëtimit pa fryrje në mënyrë korrekte brenda 1 minute, pa asistencë;
- të hidhet në ujë nga lartësia me xhakete shpëtimit të veshur;
- të notojë në një distancë të shkurtër me xhakete shpëtimit të veshur;
- të testojë bilibilitin e xhaketës së shpëtimit;
- të vërë në punë dritën e xhaketës së shpëtimit pa fryrje;

**Në lidhje me xhaketat e shpëtimit me fryrje:**

- të veshë një xhakete shpëtimit me fryrje në mënyrë korrekte brenda 1 minute, pa asistencë;
  - të hidhet në ujë nga lartësia me xhakete shpëtimit të veshur;
  - të notojë në një distancë të shkurtër me xhakete shpëtimit të veshur;
  - të testojë bilibilitin e xhaketës së shpëtimit me fryrje;
-

- 
- të testojë metodat jo automatike të fryrjes;

Në lidhje me kostumet e zhytjes:

- të shpaketojë dhe të veshë kostumin e zhytjes brënda 2 minutave pa asistencë;
- të hipë dhe të zbresë në shkallë vertikale deri në 5 m me kostum dhe xhakëtë shpëtimi veshur, të hidhet në ujë nga lartësi jo më pak se 4.5 m, të notojë në një distancë të shkurtër, të përmbushë detyrat e vëna gjatë braktisjes, të testojë bilbilin, të vërë në punë dritën.

Në lidhje me mbijetesën personale pa xhakëtë shpëtimi:

- të demonstrojë se si mund të pluskohet në ujë pa xhakëtë shpëtimi, kostum zhytje apo kostum anti-ekspozimi.

Në lidhje me hipjen në mjetin e mbijetesës:

- të hipë në mjetin e mbijetesës nga anija apo nga uji me xhakëtë shpëtimi veshur;
- të japë ndihmë ndaj të tjerëve;
- të demonstrojë përdorimin e pajisjeve, përfshirë këtu dhe spirancën lundruese;
- të drejtojë dhe të kthejë trapin e mbijetesës;
- të demonstrojë braktisjen e trapit të mbijetesës;

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 7 Nxënësi përshkruan rregullat dhe mënyrat, si dhe përdor mjetet e mbijetesës në det.**

***Përmbajtja:***

Rreziqet për të mbijetuarit:

- Klasifikimi i rreziqeve për të mbijetuarit si, goditjet e nxehtësisë, goditjet e diellit, ekspozimi ndaj të ftohtit dhe hipotermia, zënia e detit, mungesa e lëngjeve të trupit, pirja e ujit të detit, zjarri apo vaji në ujë, peshkaqenët.

Përdorimi më i mirë i pajisjeve të mbijetesës:

- Largimi nga anija.
- Masat mbrojtëse kundër goditjes së nxehtësisë, goditjes së diellit dhe ekspozimit ndaj hipotermisë.
- Efektet nga zënia e detit.
- Përdorimi i kujdesshëm i ujit të pijshëm dhe ushqimit për të evituar dehidratimin.
- Marrja e masave në rastet e zjarrit apo vajt në det.
- Mënyrat e mbijetesës në ujrat me peshkaqenë.
- Përdorimi i spirancës lundruese.
- Evidentimi i detyrave të vrojtimit.
- Mënyrat e zbulimit nga të tjerët.
- Mënyrat për të mbajtur lart moralin.
- Mënyrat e largimit të peshkaqenëve.
- Mënyrat e mbijetesës në ujë.

Radiot portabël për barkat e mbijetesës:

- Funksionimi i tyre për transmetimin e sinjaleve të alarmit dhe fatkeqësive.

EPIRB-i (Emergency Position Indicating Radio Beacon):

---



- 
- Mënyra e përdorimit të EPIRB.
  - Sasia në bord dhe vendndodhja e tyre.
  - Mënyra e aktivizimit.
  - Përshkrimi i rrezikut për përdorimin aksidental.

SART-i (Save and Rescue Transponder):

- Mënyra e përdorimit të SART.
- Sasia në bord dhe vendndodhja e tyre.
- Mënyra e aktivizimit.
- Përshkrimi i rrezikut për përdorimin aksidental.
- Ndryshimi midis EPIRB-it dhe SART-it.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me rreziqet për të mbijetuarit:

- të bëjë klasifikimin e rreziqeve për të mbijetuarit si, goditjet e nxehtësisë, goditjet e diellit, ekspozimi ndaj të ftohtit dhe hipotermia, zënia e detit, mungesa e lëngjeve të trupit, pirja e ujit të detit, zjarri apo vaji në ujë, peshkaqenët.

Në lidhje me përdorimin më të mirë të pajisjeve të mbijetesës:

- të përshkruajë procedurën e largimit nga anija;
- të përshkruajë masat mbrojtëse kundër goditjes së nxehtësisë, goditjes së diellit dhe ekspozimit ndaj hipotermisë;
- të tregojë efektet nga zënia e detit;
- të përshkruajë përdorimin e kujdesshëm të ujit të pijshëm dhe ushqimit për të evituar dehidratimin;
- të tregojë masat që merren në rastet e zjarrit apo vajit në det;
- të përshkruajë mënyrat e mbijetesës në ujrën me peshkaqenë;
- të tregojë si përdoret spiranca lundruese;
- të përshkruajë detyrat e vrojtimit;
- të përshkruajë dhe zbatojë mënyrat e zbulimit nga të tjerët;
- të përshkruajë mënyrat për të mbajtur lart moralin;
- të përshkruajë mënyrat e largimit të peshkaqenëve;
- të përshkruajë mënyrat e mbijetesës në ujë;

Në lidhje me radiot portabël për barkat e mbijetesës:

- të përshkruajë dhe bëjë funksionimin e tyre për transmetimin e sinjaleve të alarmit dhe fatkeqësive;

Në lidhje me EPIRB-in (Emergency Position Indicating Radio Beacon):

- të përshkruajë mënyrën e përdorimit të EPIRB;
  - të tregojë sasinë dhe vendndodhjen e tyre në bord;
-

- të përshkruajë dhe realizojë e aktivizimin e tyre;
  - të përshkruajë rrezikun për përdorimin aksidental;
- Në lidhje me SART-in (Save and Rescue Transponder):
- të përshkruajë mënyrën e përdorimit të SART;
  - të tregojë sasinë dhe vendndodhjen e tyre në bord;
  - të përshkruajë dhe realizojë e aktivizimin e tyre;
  - të përshkruajë rrezikun për përdorimin aksidental;
  - të tregojë ndryshimin midis EPIRB-it dhe SART-it;

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 8 Nxënësi përshkruan parimet dhe demonstroi veprimet e reagimit në asistencën me helikopter në det**

***Përmbajtja:***

Komunikimi me helikopterin:

- Sinjalet e dorës dhe të krahut.
- Komunikimi me helikopterin me anë të stacionit tokësor, kur janë pajisjet e duhura.

Braktisja nga anija apo barka e mbijetesës, për te helikopteri:

- Kërkesa që në anije të ketë një zonë marrjeje, e lirë nga direkët, kavot etj.
- Metodatat e braktisjes së barkës apo trapit pneumatik të mbijetesës.

Marrja me helikopter:

- Metodatat e marrjes: me pajime, barrelë, rrjetë shpëtimi, kosh etj.
- Përdorimi i sinjaleve të dorës dhe të krahut për ngritje pa dëmtime.
- Mënyra se si një anëtar i ekuipazhit të helikopterit mund të asistojë në ngritje.
- Rëndësia e bindjes ndaj urdhërave të dhëna nga piloti apo ndihmësi i tij.

Përdorimi korrekt i pajimeve të helikopterit:

- Përshkrimi i pajimeve/rripit.
- Vendosja korrekte dhe lidhja/sigurimi i rripit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me komunikimin me helikopterin:

- të përdorë dhe interpretojë sinjalet e dorës dhe të krahut;
- të përshkruajë komunikimin me helikopterin me anë të stacionit tokësor, kur janë pajisjet e duhura;

Në lidhje me braktisjen nga anija apo barka e mbijetesës, për te helikopteri:

- të argumentojë kërkesën që në anije të ketë një zonë marrjeje të lirë nga direkët, kavot etj.;
- të përshkruajë metodatat e braktisjes së barkës apo trapit pneumatik të mbijetesës;

---

Në lidhje me marrjen me helikopter:

- të përshkruajë metodat e marrjes: me pajime, barrelë, rrjetë shpëtimi, kosh etj.;
- të shpjegojë përdorimin e sinjaleve të dorës dhe të krahut për ngritje pa dëmtime;
- të tregojë mënyrën se si një anëtar i ekuipazhit të helikopterit mund të asistojë në ngritje;
- të argumentojë rëndësinë e bindjes ndaj urdhërave të dhëna nga piloti apo ndihmësi i tij;

Në lidhje me përdorimin korrekt të pajimeve të helikopterit:

- të bëjë përshkrimin e pajimeve/rripit;
- të bëjë vendosjen korrekte dhe lidhjen e sigurimin e rripit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, në anije dhe në pishinë.
- Aspektet teorike duhet të trajtohen të lidhura ngushtë me procedurat praktike përkatëse.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të përdorimit të mjeteve individuale dhe kolektive të emergjencës në anije
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përdorimin e mjeteve vetjake dhe kolektive të mbijetesës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në përdorimin e mjeteve vetjake dhe kolektive të mbijetesës.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin e pjesës teorike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:  
Klasë, mjedis anijeje, pishinë.  
Tavolinë për demonstrime me përmasa 3 m me 1 m.  
Materiale audio-vizive apo materiale të shkruara për aspektet teorike si:

- tabelë udhëzuese të hapave të punës për veshjen e xhakëtës së shpëtimit dhe të qëndrimit në ujë me xhaketë veshur
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për veshjen e kostumit termik dhe të qëndrimit në ujë me kostum veshur
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për përdorimin e rrethit të shpëtimit për pluskim dhe qëndrimit me rreth në ujë
- tabelë udhëzuese me hapat e punës për përdorimin mjete kolektive të mbijetesës dhe shpëtimi

Për realizimin e pjesës praktike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pishine, liqen apo det.
- xhaketa shpëtimi për të gjithë nxënësit
- 5 xhaketa shpëtimi me fryrje
- 5 rrathë shpëtimi
- 2 trape të ngurtë
- 2 trape me fryrje për 20 persona për praktikimin në ujë

- 
- 1 SART (Transponder për kërkim Shpëtmin) që punon me frekuencë 9 GHz
  - 12 kostume mbijetese (zhytje)
  - 2 komplete të pajimeve të trapit pneumatik
  - 2 komplete të pajimeve të barkës së mbijetesës
  - 1 EPIRB Sinjalizues Radiofonik që Tregon Vend-ndodhjen e Avarisë që punon me frekuencë 460 MHz
  - Solucion kundra peshkaqenëve
  - 2 komplete me pajimet e sigurisë/ndihmës së parë
-

## 7. Moduli “Parandalimi dhe lufta kundër zjarrit”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR ZJARRIT (IMO 1.20)	M-30-1036-15
Qëllimi i modulit	Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit me njohuri, aftësi dhe besim për t’iu përgjigjur siç duhet emergjencave të zjarrit, si dhe për përdorimin korrekt të pajisjeve dhe kryerjes së procedurave të emergjencës për të garantuar mbijetesën e tyre në një emergjencë zjarri	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW ’78, i amenduar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përshkruan parimet e sigurisë ndaj zjarrit në anije</b></p> <p><b><i>Përmbajtja:</i></b></p> <p><u>Parimet e sigurisë ndaj zjarrit në anije:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Veprimet që kryhen në këto raste:<ul style="list-style-type: none"><li>- kur zbulohet tym apo zjarr ose bie alarmi i zjarrit;</li><li>- për dhënien e alarmit dhe për përdorimin e fiksave portativë;</li><li>- për mbylljen dhe hapjen e dymave zjarrduruese të kuvertës dhe atyre hermetike në anije;</li><li>- për zvogëlimin e rrezikut të zjarrit dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë;</li><li>- për t’iu përgjigjur situatave emergjente në lidhje me zjarrin;</li><li>- për dobësimin dhe fikjen e zjarrit;</li></ul></li></ul> <p><u>Parimet e mbijetesës në lidhje me zjarrin:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Rregullsia e kryerjes së trajnimeve dhe alarmeve;</li><li>- Përgatitja ndaj çdo lloji emergjence zjarri;</li><li>- Veprimet që kryhen pas grumbullimit te stacioni i thirrjes;</li><li>- Rrugëkalimet e largimit</li><li>- Rreziqet e tymit dhe avujve toksikë.</li></ul> <p><b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim</li><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <p><u>Në lidhje me parimet e sigurisë ndaj zjarrit në anije:</u></p>	

- të përshkruajë veprimet që kryhen në këto raste:
  - kur zbulohet tym apo zjarr ose bie alarmi i zjarrit;
  - për dhënien e alarmit dhe për përdorimin e fiksave portativë;
  - për mbylljen dhe hapjen e dymave zjarrduruese të kuvertës dhe atyre hermetike në anije;
  - për zvogëlimin e rrezikut të zjarrit dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë;
  - për t'iu përgjigjur situatave emergjente në lidhje me zjarrin;
  - për dobësimin dhe fikjen e zjarrit;

Në lidhje me parimet e mbijetesës që kanë të bëjnë me zjarrin:

- të argumentojë rëndësinë e rregullsisë së kryerjes së trajnimeve dhe alarmeve;
- të argumentojë rëndësinë e përgatitjes ndaj çdo lloj emergjence zjarri;
- të tregojë veprimet që kryhen pas grumbullimit të stacioni i thirrjes;
- të tregojë rrugëkalimet e largimit;
- të shpjegojë rreziqet e tymit dhe avujve toksikë;

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 2 Nxënësi përshkruan konceptet dhe zbatimin e trekëndëshit të zjarrit dhe shpërthimit**

***Përmbajtja:***

Kushtet e nevojshme për shkaktimin e zjarrit:

- Elementët e zjarrit dhe ndezja e tij (trekëndëshi i zjarrit).
- Tipet, llojet e ndezjes dhe përhapja e zjarrit.
- Rastet kur futet edhe elementi i katërt (reaksioni zinxhir) që të çon në zjarr me djegie të vazhdueshme (piramida e zjarrit).

Materialet e ndezshëm, rreziqet e zjarrit:

- Veçoritë e materialeve të ndezshëm që përcaktohen nga: ndezshmëria, pika e ndezjes, temperatura e djegjes, shpejtësia e djegjes, vlerat termike, kufiri i poshtëm i ndezjes (LFL), kufiri i sipërm i ndezjes (UFL), rrezja ndezshmërisë, pika e flakërimit dhe vetëndezja.
- Shembuj si ndodh ndezja si rrjedhojë e elektricitetit.
- Reaksionet e djegies.
- Burimet e ndezjes.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me kushtet e nevojshme për shkaktimin e zjarrit:

- të përcaktojë elementët e zjarrit për ndezjen e tij (trekëndëshi i zjarrit).
  - të tregojë tipet, llojet e ndezjes dhe mënyrën e përhapjes së zjarrit.
-

- të përshkruajë rastet kur futet edhe elementi i katërt (reaksioni zinxhir) që çon në zjarrin me djegie të vazhdueshme (piramida e zjarrit).

Në lidhje me materialet e ndezshëm, rreziqet e zjarrit:

- të përshkruajë veçoritë e materialeve të ndezshëm: ndezshmëria, pika e ndezjes, temperatura e djegjes, shpejtësia e djegjes, vlerat termike, kufiri i poshtëm i ndezjes (LFL), kufiri i sipërm i ndezjes (UFL), rrezja ndezshmërisë, pika e flakërimit dhe vetëndezja.
- të japë shembuj se si ndodh ndezja si rrjedhojë e elektricitetit.
- të përshkruajë reaksionet e djegies.
- të përcaktojë burimet e ndezjes.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 3 Nxënësi përshkruan tipet dhe burimet e ndezjes**

***Përmbajtja:***

Parimet e parandalimit të zjarrit:

- Parandalimi i përhapjes së zjarrit duke e pakësuar ose duke e bllokuar.
- Ftohja e materialit që digjet.
- Ndërprerja e oksigjenit.
- Ndalimi i shkëndijave ndezëse.
- Argumentimi pse heqja e njërit nga elementët e trekëndëshit mund të parandalojë ose të fikë zjarrin.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me parimet e parandalimit të zjarrit:

- të shpjegojë parandalimin e përhapjes së zjarrit duke e pakësuar ose duke e bllokuar, nëpërmjet ftohjes së materialit që digjet, ndërprerjes së oksigjenit dhe ndalimit të shkëndijave ndezëse.
- të argumentojë pse heqja e njërit nga elementët e trekëndëshit mund të parandalojë ose të fikë zjarrin.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 4 Nxënësi përshkruan materialet e ndezshme më të zakonshme në anije**

***Përmbajtja:***

Përhapja e zjarrit:

- Përhapja e zjarrit si rezultat i barazimit të temperaturës së zjarrit dhe mjedisit përreth me anë të materialeve që digjen, oksigjenit dhe shkëndijës.
- Mënyrat e përhapjes së zjarrit.
- Temperatura në një zjarr normal e në metalet gjatë djegies.
- Katër fazat e zhvillimit të zjarrit: shkëndija ndezëse, zhvillimi, zjarri absolut dhe djegia totale.

Veprimtaria e sigurtë në anije:

- 
- Procedurat e sigurisë duke përfshirë: mos-pirjen e duhanit në vendet e rrezikshme, pastërtinë, higjienën, njohjen e rreziqeve dhe në marrjen e masave për parandalimin e zjarrit.
  - Në lokalin e makinerisë, masat për minimizimin e rreziqeve, duke përfshirë: mirëmbajtjen e izolimeve elektrike dhe termoizolimit, eliminimin e rrjedhjeve vajore, parandalimin e akumulimit të karburanteve, kujdesi gjatë saldimit ose prerjeve me oksigjen, kontrolli për mbylljen e kapakëve të sondave dhe furnizimit të karburanteve, mbajtja e lokalit pastër dhe heqja e leckave të pastrimit mbas përdorimit.
  - Në guzhinë, masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit duke përfshirë: pastrimin e mbajtjen hapur të aspiratorit të nxjerrjes së gazrave nga guzhina, të siguruarit që vajrat e gatimit nuk derdhen mbi sobë apo nuk tejnxehen mbi plitkat elektrike të gatimit dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike;
  - Në hoteleri, masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit duke përfshirë: mos-pirjen e duhanit në shtrat, mos përdorimin e pajisjeve të pa-autorizuara elektrike, mos zbrazen e tavllave të duhanit tek koshat e plehrave pa u bindur që nuk ka mbetur cigare e ndezur.
  - Në lokalet e ngarkesës, masat për minimizimin e zjarrit duke përfshirë: pastrimin me korrektësi të grykave të lokaleve të ngarkesës, stivimin dhe ventilimin e ngarkesës në përputhje me rregullat, ndalimin e pirjes së duhanit gjatë përpunimit të ngarkesës, sigurimin e ngarkesës, bllokimin e ajrosjeve në lokalet e ngarkesës kur kërkohet.
  - Të siguruarit që ndriçimi fiks në lokalin e ngarkesës të jetë i fikur dhe ai i lëvizshëm të shëkëputet nga linja dhe të largohet pas përdorimit dhe para mbylljes së kapakëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me përhapjen e zjarrit:

- të shpjegojë përhapjen e zjarrit si rezultat i barazimit të temperaturës së zjarrit dhe mjedisit përreth.
- të tregojë mënyrat e përhapjes së zjarrit dhe temperaturën në një zjarr normal e në metalet gjatë djegies.
- të shpjegojë katër fazat e zhvillimit të zjarrit: shkëndija ndezëse, zhvillimi, zjarri absolut dhe djegia totale.

Në lidhje me veprimtarinë e sigurtë në anije:

- të përshkruajë procedurat e sigurisë: mos-pirjen e duhanit në vendet e rrezikshme, pastërtinë, higjienën, njohjen e rreziqeve dhe marrjen e masave për parandalimin e zjarrit.
-



- të përshkruajë masat për minimizimin e rreziqeve në lokalin e makinerisë, duke përfshirë: mirëmbajtjen e izolimeve elektrike dhe termoizolimit, eliminimin e rrjedhjeve vajore, parandalimin e akumulimit të karburanteve, kujdesin gjatë saldimit ose prerjeve me oksigjen, kontrollin për mbylljen e kapakëve të sondave dhe furnizimit të karburanteve, mbajtjen e lokalit pastër dhe heqjen e leckave të pastrimit mbas përdorimit.
- të përshkruajë masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit në kuzhinë: pastrimin e mbajtjen hapur të aspiratorit të nxjerjes së gazrave, të siguruarit që vajrat e gatimit nuk derdhen mbi sobë apo nuk tejnëhen mbi plitkat elektrike të gatimit, si dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike;
- të përshkruajë masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit në hoteleri: mos-pirjen e duhanit në shtrat, mos përdorimin e pajisjeve të pa-autorizuara elektrike, mos zbrazen e tavllave të duhanit tek koshat e plehrave pa u bindur që nuk ka mbetur cigare e ndezur.
- të përshkruajë masat për minimizimin e zjarrit në lokalet e ngarkesës: pastrimin me korrektësi të grykave të lokaleve të ngarkesës, stivimin dhe ventilimin e ngarkesës në përputhje me rregullat, ndalimin e pirjes së duhanit gjatë përpunimit të ngarkesës, sigurimin e ngarkesës, bllokimin e ajrosjeve në lokalet e ngarkesës kur kërkohet.
- të tregojë pse ndriçimi fiks në lokalin e ngarkesës të jetë i fikur dhe ai i lëvizshëm të shkëputet nga linja.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 5 Nxënësi përshkruan parimet e nevojës për vigjilencë të vazhdueshme në anije**

***Përmbajtja:***

- Parandalimi i zjarrit, si mënyra më e mirë për t'a luftuar nëpërmjet: vigjilencës së vazhdueshme; përgatitjes; kontrolleve; mbajtjen nën mbikqyrje; mirëmbajtjen e pajisjeve.
- Nevoja që në anijet ku ka më shumë se 36 persona të mbahet një sistem patrullimi.
- Detyrat e patrullës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë pse parandalimi i zjarrit është mënyra më e mirë për t'a luftuar nëpërmjet: vigjilencës; përgatitjes; kontrolleve; mbikqyrjen; mirëmbajtjen e pajisjeve.
- të argumentojë nevojën që në anijet ku ka më shumë se 36 persona, të mbahet një sistem patrullimi.
- të tregojë detyrat e patrullës.

---

**Rezultatet e të  
mësuarit (RM),  
përmbajtja dhe  
procedurat e  
vlerësimit**

**RM 6 Nxënësi përshkruan rreziqet e zjarrit në anije**

***Përmbajtja:***

- Rreziqet e zjarrit në lokalitë e makinerisë, përfshirë: lëngjet e djegshme, rrjedhjet e karburanteve, izolacionet e lagura me naftë, sipërfaqet e nxehta, p.sh. tubot e shkarikos, pjesët e motorrit që nxehen, difektet në termoizolime, saldimet, prerja me oksigjen dhe llampë acitileni, vetëndezja e e karburanteve që bien mbi sipërfaqe të nxehta.
- Rreziqet në guzhinë, përfshirë: lëngjet e djegshëm, p.sh. vaji gatimit, yndyrnat e nxehta, sipërfaqet e nxehta (furrat, fteret, aspiratorët), lidhjet e elektrike difektoze.
- Rreziqet në hoteleri, përfshirë: materialet e djegshme (parapetet, mobilimi, sendet personale), shkrepset dhe cigaret e ndezura, lidhjet elektrike difektoze.
- Rreziqet në lokalet e ngarkesës, përfshirë: ngarkesat me vetëngrohje që japin zjarre spontane, oksidimi i ngarkesës dhe peroksidet organike, gazrat e djegshëm nën presion, ngarkesat e rrezikshme, eksplozivët.
- Rreziqet nga duhanpirësit dhe cigaret, përfshirë: temperaturën e djegjes së cigares (rreth 500°C), pakujdesia me cigaret dhe shkrepset, koshat e plehrave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rreziqet e zjarrit në lokalitë e makinerisë, përfshirë: lëngjet e djegshme, rrjedhjet e karburanteve, izolacionet e lagura me naftë dhe sipërfaqet e nxehta.
- të përshkruajë rreziqet në kuzhinë, përfshirë: lëngjet e djegshëm, sipërfaqet e nxehta, lidhjet elektrike difektoze.
- të përshkruajë rreziqet në hoteleri, përfshirë: materialet e djegshme, shkrepset dhe cigaret e ndezura, lidhjet elektrike difektoze.
- të përshkruajë rreziqet në lokalet e ngarkesës, përfshirë: ngarkesat me vetëngrohje që japin zjarre spontane, oksidimi i ngarkesës dhe peroksidet organike, gazrat e djegshëm nën presion, ngarkesat e rrezikshme, eksplozivët.
- të tregojë rreziqet nga duhanpirësit dhe cigaret, përfshirë: temperaturën e djegjes së cigares (rreth 500°C), pakujdesia me cigaret dhe shkrepset, koshat e plehrave.

---

**Rezultatet e të  
mësuarit (RM),  
përmbajtja dhe  
procedurat e  
vlerësimit**

**RM 7 Nxënësi përshkruan dhe kryen veprime për organizimin e luftës kundër zjarrit në anije**

***Përmbajtja:***

**Alarmi i emergjencës përgjithshme:**

- Përbërja e alarmit të emergjencës (shtatë ose më shumë

- 
- fishkëllima të ndjekura nga një tingull i gjatë i sirenës së anijes dhe zile apo çanga apo tinguj të njëjtë kudo në anije);
- Alarme të veçanta të operueshme nga ura e komandës, për të mbledhur ekuipazhin tek stacionet zjarrfikëse;
  - Alarme të tjerë të mundshëm si CO<sub>2</sub>, salla e pompave, operimi me dorë, sistemi i zbulimit të zjarrit në anijet me UMS (Unattended Machinery Space).

Planet e kontrollit të zjarrit dhe Listat e apelit:

- Planet e kontrollit të zjarrit dhe vend-ndodhja e tyre;
- Lista e apelit;
- Detyrat individuale për çdo antar të ekuipazhit

Komunikimet:

- Mënyrat e komunikimit që përdoren gjatë një emergjence si: korierët, telefonat, radiot e dorës, Radiot VHF, P.A.-të (Public Address).

Procedurat e sigurisë së personelit:

- Përbërja e skuadrës zjarrfikëse dhe personi përgjegjës;
- Fakti që në zonën e zjarrit nuk mund të futet njeri pa urdhër nga personi përgjegjës;
- Zona e zjarrit dhe e rrugëve të largimit;
- Rëndësia e të qenurit i pajisur si duhet për t'u futur në zonën e zjarrit, veçanarisht kur nuk ka ndriçim dhe ka tym.
- Veshja kundra zjarrit
- Pajisjet e duhura, përfshirë aparatën e frymëmarrjes, ndriçuesin e dorës, sopatën, levën, litarin e amjantit dhe pajimet e tjera;
- Mënyra e përdorimit të litarit të amjantit për komunikime me sinjalizime;
- Nevoja e të qenurit fleksibël në plotësimin e vendeve bosh me personel kyç në zonat e zjarrit.

Alarmet periodike në anije:

- Qëllimi i alarmeve në anije;
- Ushtrimet tipike që përdoren gjatë alarmeve të zjarrit: fikja në një zonë me vajra, hyrja në zona të mbyllura ku ka rënë zjarr, fikja e zjarrit në kuvertë;
- Shpëtimi i personit pa ndjenja në hapësirat e mbushura me tym.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me alarmin e emergjencës përgjithshme:

- të tregojë përbërjen e alarmit të emergjencës së përgjithshme;
- të tregojë alarme të veçanta të operueshme nga ura e komandës, për të mbledhur ekuipazhin tek stacionet zjarrfikëse;

- të tregojë alarme të tjerë të mundshëm si CO<sub>2</sub>, salla e pompave, operimi me dorë, sistemi i zbulimit të zjarrit në anijet me UMS (Unattended Machinery Space).

Në lidhje me planet e kontrollit të zjarrit dhe Listat e apelit:

- të përshkruajë planet e kontrollit të zjarrit dhe vendndodhjen e tyre;
- të përshkruajë Listën e apelit;
- të tregojë detyrat individuale për çdo antar të ekuipazhit;

Në lidhje me komunikimet:

- të përshkruajë mënyrat e komunikimit që përdoren gjatë një emergjence si: korierët, telefonat, radiot e dorës, radiot VHF, P.A.-të (Public Address).

Në lidhje me procedurat e sigurisë së personelit:

- të përshkruajë përbërjen e skuadrës zjarrfikëse dhe personin përgjegjës;
- të theksojë faktin që në zonën e zjarrit nuk mund të futet njeri pa urdhër nga personi përgjegjës;
- të përshkruajë zonën e zjarrit dhe rrugët e largimit;
- të argumentojë rëndësinë e të qenurit i pajisur si duhet për t'u futur në zonën e zjarrit, veçanarisht kur nuk ka ndriçim dhe ka tym;
- të demonstrojë veshjen e veshjes kundra zjarrit;
- të demonstrojë përdorimin e pajisjeve të duhura, përfshirë aparatën e frymëmarrjes, ndriçuesin e dorës, sopatën, levën, litarin e amjantit dhe pajimet e tjera;
- të demonstrojë përdorimin e litarit të amjantit për komunikime me sinjalizime;
- të argumentojë nevoja e të qenurit fleksibël në plotësimin e vendeve bosh me personel kyç në zonat e zjarrit.

Në lidhje me alarmet periodike në anije:

- të tregojë qëllimin e alarmeve periodike në anije;
- të përshkruajë rastet tipike që përdoren gjatë alarmeve të zjarrit: fikja në një zonë me vajra, hyrja në zona të mbyllura ku ka rënë zjarr, fikja e zjarrit në kuvertë;
- të simulojë shpëtimin e personit pa ndjenja në hapësirat e mbushura me tym.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 8 Nxënësi përshkruan vend-ndodhjen e pajisjeve zjarrfikëse e rrugëkalimet e largimit të emergjencës në anije**

***Përmbajtja:***

- Parimet bazë, vend-ndodhja rrugëkalimeve të emergjencës dhe si mbrohen këto rrugëkalime;
- Parapetjet ndarëse të klasës A, B dhe C/F;
- Mënyrat e pastrimit të tankeve nga gazrat;
- Qëllimi dhe mënyrat e mbylljes së hapësirave të ngarkesës;
- Masat parandaluese ndaj zjarreve në hapësirat e ngarkesës;
- Pompa zjarrfikëse e emergjencës (në anijet e ngarkesës);
- Kërkesat për numrin e saraçineskave të ujit, që pompa

- 
- zjarrfikëse e emergjencës duhet të furnizojë;
- Pozicioni i pompës zjarrfikëse;
  - Rrethanat kur duhet të përdoret pompa zjarrfikëse e emergjencës;
  - Përdorimi i kimikateve pluhur;
  - Aparati me pluhur stacionar tipik me kontenitor që mban 250 kg pluhur;
  - Mënyrat e përdorimit për të marrë rezultatet më të mira;
  - Rrugëkalimet e largimit në rast emergjence;
  - Rrugëkalimet e emergjencës nga lokali mashinës për në hotel, kuvertën kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
  - Rrugëkalimet e emergjencës nga hoteli për tek sanajtë e mbijetesës;
  - Rrugëkalimet e emergjencës nga salla e pompave për tek kuverta kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
  - Rrugëkalimet e emergjencës nga hapësirat e ngarkesës për në kuvertën kryesore dhe për tek sanajtë e mbijetesës;
  - Markimet dhe simbolet e rrugëkalimeve të emergjencës;
  - Sistemi i ndriçimit të rrugëkalimeve të emergjencës;
  - Mënyrat e përdorimit të rrugëkalimeve të emergjencës edhe në sensin e kundërt me qëllim për të mbërritur në vendin ku ka rënë zjarr.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë parimet bazë, vend-ndodhjen e rrugëkalimeve të emergjencës dhe si mbrohen këto rrugëkalime;
  - të përshkruajë parapetet ndarëse të klasës A, B dhe C/F;
  - të përshkruajë mënyrat e pastrimit të tankeve nga gazrat;
  - të tregojë qëllimin dhe mënyrat e mbylljes së hapësirave të ngarkesës;
  - të përshkruajë masat parandaluese ndaj zjarreve në hapësirat e ngarkesës;
  - të përshkruajë pompat zjarrfikëse e emergjencës (në anijet e ngarkesës);
  - të tregojë numrin e saraçineskave të ujit, që pompa zjarrfikëse e emergjencës duhet të furnizojë;
  - të tregojë pozicionin e pompës zjarrfikëse;
  - të shpjegojë rrethanat kur duhet të përdoret pompa zjarrfikëse e emergjencës;
  - të tregojë përdorimin e kimikateve pluhur;
  - të përshkruajë aparatën me pluhur stacionar tipik me kontenitor, që mban 250 kg pluhur;
  - të përshkruajë mënyrat e përdorimit për të marrë rezultatet
-

- 
- më të mira;
  - të tregojë rrugëkalimet e largimit në rast emergjence;
  - të tregojë rrugëkalimet e emergjencës nga lokali mashinës për në hotel, kuvertën kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
  - të tregojë rrugëkalimet e emergjencës nga hoteli për tek sanajtë e mbijetesës;
  - të tregojë rrugëkalimet e emergjencës nga salla e pompave për tek kuverta kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
  - të tregojë rrugëkalimet e emergjencës nga hapësirat e ngarkesës për në kuvertën kryesore dhe për tek sanajtë e mbijetesës;
  - të interpretojë markimet dhe simbolet e rrugëkalimeve të emergjencës;
  - të përshkruajë sistemin e ndriçimit të rrugëkalimeve të emergjencës;
  - të përshkruajë mënyrat e përdorimit të rrugëkalimeve të emergjencës edhe në sensin e kundërt, me qëllim për të mbërritur në vendin ku ka rënë zjarr.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 9 Nxënësi përshkruan dhe zbaton detyrat dhe veprimet e skuadrës e fikjes së zjarrit në pozicione të ndryshme në anije**

***Përmbajtja:***

- Nevoja që zjarri që bie në lokalin e mashinës ose në lokalin e pompave të ngarkesës duhet të mbahet po aty, për t'u përpjekur që të mos kalojë në hotel, pasi ky i fundit është ndarë nga lokali mashinës me parapete me mbrojtje termike;
- Nevoja që të gjitha dyert e tipit A-60 që ndajnë lokalin e mashinës nga lokali pompave të ngarkesës duhet të mbyllen në rast zjarri në hapësirat respektive;
- Nevoja që të gjitha farfallat e shijunëve të ventilimit, duhet të mbyllen në rast të rënies së zjarrit në lokalin e mashinës dhe të ngarkesës;
- Nevoja që zjarri që bie në hotel duhet të mbahet po aty duke u përpjekur që të mos kalojë në lokalin e mashinës dhe në lokalin e pompave të ngarkesës pasi këto të fundit janë të ndarë nga njëri tjetri me parapete me mbrojtje termike;
- Nevoja që zjarri që bie në guzhinë, lavanteri, depon e leckave për pastrim, hapësirat publike dhe kabina duhet të mbahet po aty, duke u përpjekur që të mos kalojë në pjesë të tjera të hotelit duke përdorur parapete me mbrojtje termike, farfallat e shijunëve të ventilimit/ndalimet e emergjencës;
- Nevoja që zjarri që bie në hapësirat e ngarkesës, duhet të mbahet po aty, duke u përpjekur që të mbyllen kapakët e Mc.Gregorëve, farfallat e shijunëve të ventilimit dhe duke ftohur parapetet rrethues;
- Nevoja që zjarri që bie në hapësira të izoluar si timoneri,

---

dhoma e radios, dhoma e hartave, zona e forpikut, d.m.th. lokali i bojrave etj., si dhe salla e timonit të emergjencës duhet të mbahet po aty, duke u përpjekur që të mos e kalojë lokalin, duke mbyllur farfallat e shijunëve të ajrosjes, si dhe duke përdorur sistemet stacionare të fikjes së zjarrit e pajisje të tjera në dispozicion për fikjen e zjarrit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të theksojë nevojën që zjarri që bie në lokalin e mashinës ose në lokalin e pompave të ngarkesës duhet të mbahet po aty, për t'u përpjekur që të mos kalojë në hotel;
- të theksojë nevojën që të gjitha dyert e tipit A-60 që ndajnë lokalin e mashinës nga lokali pompave të ngarkesës duhet të mbyllën në rast zjarri në hapësirat respektive;
- të theksojë nevojën që të gjitha farfallat e shijunëve të ventilimit, duhet të mbyllën në rast të rënies së zjarrit në lokalin e mashinës dhe të ngarkesës;
- të theksojë nevojën që zjarri që bie në hotel duhet të mbahet po aty duke u përpjekur që të mos kalojë në lokalin e mashinës dhe në lokalin e pompave të ngarkesës;
- të theksojë nevojën që zjarri që bie në guzhinë, lavanteri, depon e leckave për pastrim, hapësirat publike dhe kabina duhet të mbahet po aty, duke u përpjekur që të mos kalojë në pjesë të tjera të hotelit;
- të theksojë nevojën që zjarri që bie në hapësirat e ngarkesës, duhet të mbahet po aty, duke u përpjekur që të mbyllën kapakët e Mc.Gregorëve, farfallat e shijunëve të ventilimit dhe duke ftohur parapetet rrethues;
- të theksojë nevojën që zjarri që bie në hapësira të izoluar si timoneri, dhoma e radios, dhoma e hartave, zona e forpikut, d.m.th. lokali i bojrave etj., si dhe salla e timonit të emergjencës duhet të mbahet po aty;

---

**Rezultatet e të  
mësuarit (RM),  
përmbajtja dhe  
procedurat e  
vlerësimit**

**RM 10 Nxënësi përshkruan masat e zbulimit të tymit dhe zjarrit me sistemet e alarmit automatik në anije.**

***Përmbajtja:***

Sistemet e zbulimit të tymit dhe zjarrit në anije:

- Ndërtimi i sistemit automatik të zbulimit të zjarrit;
- Llojet kryesore të sistemeve automatike të zbulimit të zjarrit;
- Alarmet ose veprimet që mund të aktivizohen nga detektori;
- Anët pozitive të sistemit automatik me sprinkler (sprucim) në lidhje me zbulimin e zjarrit në kabinat e pasagjerëve dhe të ekuipazhit.

Alarmi automatik i zjarrit në anije:

---

- 
- Operimi i alarmit automatik të zjarrit;
  - Sistemi me zona të mundshme zjarri dhe ku mund të instalohet ky sistem në anije.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë ndërtimin e sistemit automatik të zbulimit të zjarrit;
- të përshkruajë llojet kryesore të sistemeve automatike të zbulimit të zjarrit;
- të përshkruajë alarmet ose veprimet që mund të aktivizohen nga detektori;
- të përshkruajë anët pozitive të sistemit automatik me sprinkler (sprucim) në lidhje me zbulimin e zjarrit në kabinat e pasagjerëve dhe të ekuipazhit.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 11 Nxënësi përshkruan klasifikimin e zjarreve dhe agjentët fikës të zbatueshëm në anije.**

***Përmbajtja:***

Klasifikimi i zjarreve:

- Zjarri i klasës A, me origjinë nga materiale inerte të karbonizueshme me natyrë organike, p.sh. lënda drusore, rrobat, letra, dërrasa etj;
- Zjarri i klasës B, me origjinë nga lëngjet e ndezshme apo inerte të lëngëzueshme, p.sh. vajrat, graso, rrëshirë, bojra etj;
- Zjarri i klasës C, me origjinë nga gazrat, p.sh. gazi i gatimit apo i saldimit;
- Zjarri i klasës D, me origjinë nga metalet e ndezshme, p.sh. magnezium, sodium dhe potasium;

Agjentët fikës të klasave të ndryshme të zjarrit:

- Klasa A: Me ujë me sprucim, me presion, përmbytje, CO<sub>2</sub>;
- Klasa B: Me shkumë, CO<sub>2</sub>, pluhur i thatë;
- Klasa C: Pluhur i thatë, CO<sub>2</sub>;
- Klasa D: Pluhur i thatë i veçantë;
- Për zjarrin me origjinë nga shkëndijat elektrike, që futet në një nga këto klasa d.m.th. A, B, C ose D, me shkëputjen e elektricitetit rekomandohen edhe fikësat me kimikate të thatë ose CO<sub>2</sub>.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me klasifikimin e zjarreve:

- të përshkruajë zjarrin e klasës A, me origjinë nga materiale inerte të karbonizueshme me natyrë organike, p.sh. lënda



- 
- drusore, rrobat, letra, dërrasa etj;
  - të përshkruajë zjarrin e klasës B, me origjinë nga lëngjet e ndezshme apo inerte të lëngëzueshme, p.sh. vajrat, graso, rrëshirë, bojra etj;
  - të përshkruajë zjarrin e klasës C, me origjinë nga gazrat, p.sh. gazi i gatimit apo i saldimit;
  - të përshkruajë zjarrin e klasës D, me origjinë nga metalet e ndezshme, p.sh. magnezium, sodium dhe potasium;

Në lidhje me agjentët fikës të klasave të ndryshme të zjarrit:

- të përshkruajë Klasën A: Me ujë me sprucim, me presion, përmbytje, CO<sub>2</sub>;
- të përshkruajë Klasën B: Me shkumë, CO<sub>2</sub>, pluhur i thatë;
- të përshkruajë Klasën C: Pluhur i thatë, CO<sub>2</sub>;
- të përshkruajë Klasën D: Pluhur i thatë i veçantë;
- të përshkruajë zjarrin me origjinë nga shkëndijat elektrike, që futet në një nga këto klasa d.m.th. A, B, C ose D, ku me shkëputjen e elektricitetit rekomandohen edhe fikësat me kimikate të thatë ose CO<sub>2</sub>.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 12 Nxënësi përdor mjetet dhe pajisjet për fikjen e zjarrit**

***Përmbajtja:***

Shllangat dhe pipthat për fikjen e zjarrit:

- Rregullat që kanë të bëjnë me shllangat dhe pipthat e fikjes së zjarrit;
- Mënyrat e bashkimit të shllangave dhe lidhja e tyre me saraçinskat;
- Mënyra e përdorimit të pipthit, duke nxjerrë ujë me presion, spruco apo të përzier, dhe për ç'qëllim përdoret seicili nga to;
- Mënyra e mirëmbajtjes dhe e ruajtjes së shllangave dhe pipthave;

Aparati i lëvizshëm për fikje zjarri:

- Llojet e aparateve të lëvizshëm për fikje zjarri, përfshirë bombolat me dioksid karboni, kontenitorët me gaz pluhur, pajisjen e prodhimit të shkumës;
- Zonat ku ato shkarkohen më zakonisht;

Fikset e zjarrit portabël:

- Llojet e fikseve portabël të zjarrit si: ujë, shkumë, pluhur, CO<sub>2</sub>, AFFF;
- Parimet e përdorimit të seicilit nga këto fikse zjarri portabël;
- Të dhëna për klasat e zjarrit dhe cila nga llojet e fikseve është më i përshtatshëm;
- Kapacitetet normale të seicilit nga fikset portabël të zjarrit;
- Proçedurat për mbushjen e fikseve të zbrazura;
- Aplikatori portabël i shkumës, mënyra lidhjes me linjën e sistemit zjarrfikës;

Kostumi i zjarrfikësit:

- Përbërësit e kostumit zjarrfikës: pajimet personale, aparati i frymëmarrjes, cima zjarrduruese e shpëtimit me levën dhe brezin e sigurimit;

- 
- Dy llojet e aparateve frymëmarrëse që përdoren, avantazhet dhe dizavantazhet e tyre;
  - Kërkesat për cimën zjarrduruese të shpëtimit;
  - Përbërësit e pajimeve personale zjarrduruese si: kostumi, dorezat dhe çizmet, helmata, elektriku i dorës dhe sopata zjarrfikse.

Batania zjarrduruese:

- Karakteristikat e batanijes zjarrduruese;
- Përdorimi i batanijes zjarrduruese;
- Vend-ndodhja e batanijes zjarrduruese;

Masat e ruajtjes nga zjarri:

- Vendodhja dhe përdorimi e alarmeve të zjarrit, vendodhja dhe përdorimi kontrollit të emergjencës;
- Rëndësia e njohjes së funksionimit të pajisjeve zjarrfikëse;
- Rëndësia e të qenurit i vetëdijshëm për rreziqet potenciale që paraqet zjarri;

Alarmi i zjarrit dhe veprimet paraprake:

- Veprimet për zbulimin e zjarrit, aktivizimin e alarmit, njoftimin e stacionit të kontrollit, përpjekjet për kufizimin dhe për fikjen e zjarrit.

Lufta kundër zjarrit:

- Mbikqytja e burimeve të mundshme të zjarrit;
- Faktorët që duhen marrë parasysh në vendim-marrjen se me ç’lloj mënyre duhet luftuar zjarri: mundësinë e hyrjes në vend-zjarr, personeli prezent në vendin e zjarrit, reaksionet me materiale të ndezshme, pajisjet dhe agjentët zjarrfikës të përshtatshëm

Mënyrat dhe procedurat e fikjes së zjarrit në anije:

- Llojet e agjentëve apo mënyrave të fikjes së zjarrit si: ujë me presion, me sprucim, “tymosje” apo përmytje, shkumë, CO<sub>2</sub>, avull, pluhura të thatë kimikate;
- Momenti i dhënies së alarmit të zjarrit, procedurat e fikjes dhe procedurat e emergjencës që zbatohen në vend: mbledhja e ekuipazhit në vend grumbullimet e përcaktuara në listën e apelit, grupet e fikjes së zjarrit dhe dhënia e porosive në sallën e komandës, ndezja e pompave dhe furnizimi i linjave me ujë në zonën e zjarrit, vendimi i kapitenit për mënyrën më të përshtatshme për fikje;
- Autoriteti dhe roli i kapitenit në komandimin e operacioneve për fikjen e zjarrit nga ura e komandës;
- Procedurat pas fikjes së zjarrit si p.sh. lënia e rojes në atë zonë;
- Veprimet hetuese të kapitenit për të evituar përsëritjen e ngjarjes;
- Rasti i rënies së zjarrit në anije kur kjo e fundit ndodhet në port, si dhe njoftimi i menjëhershëm që i bëhet autoriteteve portuale;

Zjarret e vegjël në anije:

- Veprimet me shllangën zjarrfikëse me ujë me presion dhe

---

sprucim me anën e pipthit dhe me aplikatorin e shkumës.

- Veprimet për përdorim korrekt të fiksave të zjarrit portabël të përshtatshëm sipas materialit që digjet p.sh. dru, karburant, yndyrna, plastike, gaz propan, elektrike;

Zjarret e mëdha në anije:

- Veprimet për fikjen e zjarreve të mëdha të llojeve të ndryshme, përfshirë zjarrin në karburante, duke përdorur sipas rastit: ujë (me presion, sprucim dhe “tymosje”), shkumën përfshirë AFFF (me bazë ujore), pluhur i thatë apo i njomë, CO<sub>2</sub>.
- Përdorimi i cimës së shpëtimit por pa aparat frymëmarrës dhe veprimet për të hyrë dhe kaluar në një lokal ku është lëshuar shkumë me shumicë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me shllangat dhe pipthat për fikjen e zjarrit:

- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat që kanë të bëjnë me shllangat dhe pipthat e fikjes së zjarrit;
- të bëjë bashkimin e shllangave dhe lidhjen e tyre me saraçinskat;
- të përdorë pipthin, duke nxjerrë ujë me presion, spruco apo të përzier;
- të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes dhe të ruajtjes së shllangave dhe pipthave;

Në lidhje me aparatën e lëvizshëm për fikjen e zjarrit:

- të përdorë aparatet e lëvizshëm për fikje zjarri, përfshirë bombolat me dioksid karboni, kontenitorët me gaz pluhur, pajisjen e prodhimit të shkumës;
- të tregojë zonat ku ato shkarkohen më zakonisht;

Në lidhje me fikset e zjarrit portabël:

- të përdorë fikset portabël të zjarrit si: ujë, shkumë, pluhur, CO<sub>2</sub>, AFFF;
- të përshkruajë parimet e përdorimit të secilit nga këto fikse zjarri portabël;
- të përzgjedhë fikset është më të përshtatshme sipas klasave të zjarrit;
- të tregojë kapacitetet normale të secilit nga fikset portabël të zjarrit;
- të përshkruajë procedurat për mbushjen e fikseve të zbrazura;
- të përdorë aplikatorin portabël të shkumës dhe ta lidhë me linjën e sistemit zjarrfikës;

Në lidhje me kostumin e zjarrfikësit:

- të përdorë kostumin zjarrfikës: pajimet personale, aparatën e frymëmarrjes, cimën zjarrduruese të shpëtimit me levën dhe

---

brezin e sigurimit;

- të përdorë aparatet frymëmarrëse;
- të përshkruajë kërkesat për cimën zjarrduruese të shpëtimit;
- të përdorë pajimet personale zjarrduruese si: kostumi, dorezat dhe çizmet, helmata, elektriku i dorës dhe sopata zjarrfikse.

Në lidhje me batanien zjarrduruese:

- të përshkruajë karakteristikat e batanijes zjarrduruese;
- të përdorë batanijen zjarrduruese;
- të tregojë vend-ndodhjen e batanijes zjarrduruese;

Në lidhje me masat e ruajtjes nga zjarri:

- të përdorë alarmet e zjarrit dhe kontrollin e emergjencës;
- të përshkruajë funksionimin e pajisjeve zjarrfikëse;
- të tregojë rëndësinë e të qenit i vetëdijshëm për rreziqet potenciale që paraqet zjarri;

Në lidhje me alarmin e zjarrit dhe veprimet paraprake:

- të kryejë veprimet për zbulimin e zjarrit, aktivizimin e alarmit, njoftimin e stacionit të kontrollit, kufizimin dhe fikjen e zjarrit.

Në lidhje me luftën kundër zjarrit:

- të mbikqyrë burimet e mundshme të zjarrit;
- të analizojë faktorët që duhen marrë parasysh në vendim-marrjen se me ç’lloj mënyre duhet luftuar zjarri: mundësinë e hyrjes në vend-zjarr, personeli prezent në vendin e zjarrit, reaksionet me materiale të ndezshme, pajisjet dhe agjentët zjarrfikës të përshtatshëm

Në lidhje me mënyrat dhe procedurat e fikjes së zjarrit në anije:

- të përshkruajë agjentët apo mënyrat të fikjes së zjarrit si: ujë me presion, me sprucim, “tymosje” apo përmbytje, shkumë, CO<sub>2</sub>, avull, pluhura të thatë kimikate;
- të zbatojë procedurat e fikjes dhe procedurat e emergjencës që zbatohen në vend pas dhënies së alarmit të zjarrit;
- të përshkruajë ndikimin e autoritetit dhe rolit të kapitenit në komandimin e operacioneve për fikjen e zjarrit nga ura e komandës;
- të përshkruajë procedurat pas fikjes së zjarrit si p.sh. lënia e rojes në atë zonë;
- të përshkruajë veprimet hetuese të kapitenit për të evituar përsëritjen e ngjarjes;
- të përshkruajë rastin e rënies së zjarrit në anije kur kjo e fundit ndodhet në port, si dhe njoftimin e menjëhershëm që i bëhet autoriteteve portuale;

Në lidhje me zjarret e vegjël në anije:

- të kryejë veprimet me shllangën zjarrfikëse me ujë me presion dhe sprucim me anën e pipthit dhe me aplikatorin e shkumës.
- të përdorë fiksat e zjarrit portabël të përshtatshëm sipas materialit që digjet;

---

Në lidhje me zjarret e mëdha në anije:

- të kryejë veprimet për fikjen e zjarreve të mëdha të llojeve të ndryshme, përfshirë zjarrin në karburante, duke përdorur sipas rastit: ujë (me presion, sprucim dhe “tymosje”), shkumën përfshirë AFFF (me bazë ujore), pluhur i thatë apo i njomë, CO<sub>2</sub>.
- të përdorë cimën e shpëtimit por pa aparat frymëmarrës dhe të kryejë veprimet për të hyrë dhe kaluar në një lokal ku është lëshuar shkumë me shumicë;

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 13 Nxënësi përshkruan dhe zbaton masat mbrojtëse me përdorimin e sistemeve stacionare për fikjen e zjarrit**

***Përmbajtja:***

Sistemet stacionare zjarrfikëse:

- Kërkesat e përgjithshme të një sistemi stacionar zjarrfikës përfshirë: materialet që përdoren për të mos prodhuar gazra toksikë, sasia e substancave duhet të jetë e mjaftueshme për hapësirat që mbulon, sistemi tubacioneve duhet të ketë valvola kontrolluese, lëshimi i substancave të gazta nuk duhet të jetë automatike, urdhëri për lëshimin e substancave duhet të jepet nga kapiteni ose nga oficer më i ulët në gradë;
- Sistemet stacionare si: CO<sub>2</sub>, sprinkler (sprucues i lagësht ose i thatë), shkumë (me presion të ulët), shkumë (me presion të lartë), linja e tubacioneve kryesore me ujë të sistemit zjarrfikës, gjeneratorët e emergjencës, pompat zjarrfikëse dhe të sentinave, uji me presion në hapësirat e kategorisë së veçantë, pluhur kimik.

Sistemet me efekte mbytëse: CO<sub>2</sub> dhe shkuma:

- Efektet izoluese fikëse të zjarrit nga CO<sub>2</sub>;
- Avantazhet dhe rreziqet e CO<sub>2</sub>;
- Veprimet që kryhen kur jepet alarmi i CO<sub>2</sub>;
- Hapësirat ku përdoret zakonisht CO<sub>2</sub>;
- Efektet e shkumës në një rast zjarri;
- Veprimet para se të lëshohet CO<sub>2</sub> ose shkuma në një lokal ku ka rënë zjarr;
- Llojet e ndryshme të shkumërave;

Sistemet me efekte kufizuese:

- Llojet e pluhurave që përdoren për fikjen e zjarrit;

Sistemet me efekt ftohës:

- Sprinkleri, si funksionon një sistem me sprinkler;
- Hapësirat ku përdoret sistemi sprinkler;
- Përcaktimi i kategorive të veçanta të hapësirave ku përdoret normalisht sistemi me presion me ujë i aktivizuar mekanikisht;
- Arsyet pse në çdo kuti shllange, duhet të ketë një saraçineskë.
- Arsyet e pajisjes me saraçineska dhe valvola mbyllëse të sistemit.
- Flanxha ndërkombëtare e lidhjes me bregun, qëllimi, përmasa
- Mënyra e lidhjes nga bregu me flanxhën ndërkombëtare në

---

anije;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me sistemet stacionare zjarrfikëse:

- të përshkruajë kërkesat e përgjithshme të një sistemi stacionar zjarrfikës;
- të përshkruajë sistemet stacionare si: CO<sub>2</sub>, sprinkler (srpucues i lagësht ose i thatë), shkumë (me presion të ulët), shkumë (me presion të lartë), linja e tubacioneve kryesore me ujë të sistemit zjarrfikës, gjeneratorët e emergjencës, pompat zjarrfikëse dhe të sentinave, uji me presion në hapësirat e kategorisë së veçantë, pluhur kimik.

Në lidhje me sistemet me efekte mbytëse: CO<sub>2</sub> dhe shkuma:

- të përshkruajë efektet izoluese fikëse të zjarrit nga CO<sub>2</sub>;
- të përshkruajë avantazhet dhe rreziqet e CO<sub>2</sub>;
- të kryejë veprimet që kryhen kur jepet alarmi i CO<sub>2</sub>;
- të tregojë hapësirat ku përdoret zakonisht CO<sub>2</sub>;
- të përshkruajë efektet e shkumës në një rast zjarri;
- të kryejë veprimet para se të lëshohet CO<sub>2</sub> ose shkuma në një lokal ku ka rënë zjarr;
- të përshkruajë llojet e ndryshme të shkumërave;

Në lidhje me sistemet me efekte kufizuese:

- të përshkruajë llojet e pluhurave që përdoren për fikjen e zjarrit;

Në lidhje me sistemet me efekt ftohës:

- të përshkruajë si funksionon një sistem me sprinkler;
- të tregojë hapësirat ku përdoret sistemi sprinkler;
- të tregojë cilat janë kategoritë e veçanta të hapësirave ku përdoret normalisht sistemi me presion me ujë i aktivizuar mekanikisht;
- të tregojë arsyet pse në çdo kuti shllange, duhet të ketë një saraçineskë.
- të tregojë arsyet e pajisjes me saraçineska dhe valvola mbyllëse të sistemit.
- të përshkruajë flanxhën ndërkombëtare të lidhjes me bregun, qëllimi, përmasat;
- të kryejë lidhjen nga bregu me flanxhën ndërkombëtare në anije.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 14 Nxënësi përdor aparatën frymëmarrës për fikjen e zjarrit dhe të shpëtimit të jetës në anije:**

***Përmbajtja:***

Aparati frymëmarrës

- Përshkrimi i aparatit të frymëmarrjes;
- Veshja dhe verifikimi i hermeticitetit të maskës;

- 
- Kontrollat verifikuese që bëhen pas veshjes në trup;
  - Teknikat korrekte të frymëmarrjes me presion të ulët ndërkohë që bën sforcime të mëdha;
  - Largimi nga hapësirat me ajër të intoksikuar pas mbarimit të ajrit në bombolat e aparatit;
  - Kontrollat e herëpashershme të manometrit të ajrit tek bombolat, gjatë përdorimit të aparatit frymëmarrës dhe veprimet pas sinjalit që tregon se ajri në bombola është në përfundim;
  - Pjesët përbërëse të aparatit të frymëmarrjes, përfshirë helmetën zjarrduruese, pompën, tubot e ajrit dhe pajimet shoqëruese;

Përdorimi i aparatit frymëmarrës në hapësira të mbushura me tym:

- Mënyrat e kontrollit dhe përdorimit të aparatit frymëmarrës si vijon: helmata e tipit zjarrdurues, pompa dhe tubot e ajrit, aparati frymëmarrës me ajër të komprimuar;
- Hyrja duke përdorur aparatit frymëmarrës në një lokal të mbushur me tym (artificial, jo toksik);
- Përdorimi i cimës së shpëtimit si komunikim me sinjale në një lokal të mbushur me tym ku kemi hyrë me aparat frymëmarrje të veshur;
- Pjesëmarrja në grup duke kryer komunikime me pjesën tjetër të grupit, ndërkohë që ke veshur aparatit frymëmarrës;
- Përdorimi i fikseve të llojeve të ndryshme në një lokal me zjarr dhe të mbushur me tym, ndërkohë që ke veshur aparatit frymëmarrës;
- Procedura e fikjes së zjarrit masiv me aparat frymëmarrës veshur, në lokale të mbyllura të mbushur me tym, përfshirë hoteleri apo stimulin të lokalit të makinerisë, dhe duke përdorur sipas rastit: ujë me presion, sprucim apo “tymosje”, shkumë, pluhur.

Përdorimi i aparatit frymëmarrës për shpëtimin e jetës:

- Kërkimi i personave në një hapësirë të mbushur me tym (duke mbajtur edhe barrelë) ndërkohë që është veshur aparati i frymëmarrjes;
- Përdorimi aparatit frymëmarrës për shpëtimin e njerëzve të dëmtuar: demonstrimi praktik i veshjes së aparatit frymëmarrës, në grup prej dy personash, që hyjnë në një lokal prove, duke kërkuar për të asfiksuar
- Kryerja e ushtrimit të njëjtë në lokal të errësuar;
- Kryerja e ushtrimit të njëjtë në lokal të mbushur me tym;
- Kryerja e ushtrimit të njëjtë në lokal të errësuar, të mbushur me tym dhe me temperaturë të lartë;
- Kryerja e ushtrimit të njëjtë duke mbajtur aparat frymëmarrje rezervë për t'u përdorur gjatë operacioneve të shpëtimit.
- Transporti i barrelës mbajtëse, dhe më pas nxjerrja e të dëmtuarit në një vend të sigurtë në kuvertën e hapur për

---

dhënien e ndihmës së parë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Në lidhje me aparatën frymëmarrëse

- të përshkruajë aparatën e frymëmarrjes;
- të bëjë veshjen e maskës dhe verifikimin e hermeticitetit të saj;
- të kryejë kontrollet verifikuese pas veshjes në trup;
- të zbatojë teknikat korrekte të frymëmarrjes me presion të ulët ndërkohë që bën sforcime të mëdha;
- të tregojë si bëhet largimi nga hapësirat me ajër të intoksikuar pas mbarimit të ajrit në bombolat e aparatit;
- të kryejë kontrollet e herëpashershme të manometrit të ajrit tek bombolat dhe veprimet pas sinjalit që tregon se ajri në bombola është në përfundim;
- të përdorë pjesët e aparatit të frymëmarrjes, përfshirë helmetën zjarrduruese, pompën, tubot e ajrit dhe pajimet shoqëruese;

Në lidhje me përdorimin e aparatit frymëmarrës në hapësira të mbushura me tym:

- të bëjë kontrollin dhe përdorimin e aparatit frymëmarrës në hapësira me tym
- të tregojë si bëhet hyrja, duke përdorur aparatën frymëmarrës, në një lokal me tym (artificial, jo toksik);
- të përdorë cimën e shpëtimit si komunikim me sinjale, në një lokal të mbushur me tym, ku ka hyrë me aparat frymëmarrje të veshur;
- të kryjë komunikime me pjesën tjetër të grupit, ndërkohë që ka veshur aparatën frymëmarrës;
- të përdorië fikse të llojeve të ndryshme në një lokal me zjarr dhe të mbushur me tym, ndërkohë që ka veshur aparatën frymëmarrës;
- të zbatojë procedurat e fikjes së zjarrit masiv me aparat frymëmarrës veshur, në lokale të mbyllura të mbushur me tym;

Në lidhje me përdorimin e aparatit frymëmarrës për shpëtimin e jetës:

- të bëjë kërkimin e personave në një hapësirë të mbushur me tym (duke mbajtur edhe barrelë) ndërkohë që ka veshur aparatën e frymëmarrjes;
- të demonstrojë veshjen e aparatit frymëmarrës, në grup prej dy personash, që hyjnë në një lokal prove, duke kërkuar për të asfiksuar, në rastet e lokaleve me dritë, të errësuar, të mbushura me tym, me temperaturë të lartë;
- të kryejë ushtrimet e mësipërme duke mbajtur aparat



	<p>frymëmarrje rezervë për t'u përdorur gjatë operacioneve të shpëtimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të bëjë transportin e barrelës mbajtëse, dhe më pas nxjerrjen e të dëmtuarit në një vend të sigurtë në kuvertën e hapur, për dhënien e ndihmës së parë</li> </ul>
<b>Udhëzime për zbatimin e modulit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, në anije dhe mjedise të simuluara, të përshtatshme për praktikën, siç mund të jenë dy konteinerë të vendosur sipër njëri tjetrit apo në repart PMNZH.</li> <li>- Shpjegimet teorike duhet të shoqërohen me shembuj dhe ilustrime të procedurave të mbrojtjes nga zjarri.</li> <li>- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të përdorimit të mjeteve zjarrfikëse të përdorshme në anije</li> <li>- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për parandalimin dhe fikjen e zjarrit në mënyrë individuale dhe në grup, përfshirë veprimet për shpëtimin e personave të dëmtuar në një ambient me tym;</li> <li>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në përdorimin e mjeteve zjarrfikëse të përdorshme në anije.</li> </ul>
<b>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</b>	<p>Për realizimin e pjesës teorike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Klasë dhe mjedis anijeje.</li> <li>- Tavolinë për demonstrim me përmasa 3 x 1 m.</li> <li>- Materiale audio-vizive apo me slaidera si:</li> <li>- tabelë udhëzuese të hapave të punës për mbrojtjen dhe luftën kundra zjarrit;</li> <li>- tabelë udhëzuese të hapave të punës për veshjen e zjarrfikësit;</li> <li>- tabelë udhëzuese të hapave të punës për përdorimin e mjeteve zjarrfikëse;</li> <li>- tabelë udhëzuese me hapat e punës për shpëtimin e personave të dëmtuar nga një zonë me tym në anije.</li> <li>- materiale të shkruara në mbështetje të njohurive teorike të trajtuara</li> </ul> <p>Për realizimin e pjesës praktike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Repart PMNZSH ose dy konteinerë të përshtatur, sipër njëri tjetrit.</li> <li>- Mundësi rimbushje të bombolave zjarrfikëse portabël;</li> <li>- Dhomë për inspektim dhe mirëmbajtje të apartit të frymëmarrjes</li> <li>- 2 tabaka metalike (afërsisht 1 m x 1 m x 0.3 m)</li> <li>- 2 tubo zjarrfikëse me dy dalje dhe një pompë zjarrfikëse</li> <li>- Material lënde djegëse (dru, naftë, vajra etj.) për tabakatë metalike</li> </ul>

- 
- 6 manikinë për procedurat e kërkim shpëtimit
  - 6 shllanga zjarrfikëse (65 mm diameter)
  - 3 shllanga zjarrfikëse (38 mm diameter)
  - 2 piptha (hedhësa) zjarrfikësa (1 standard, 1 hedhës të pulverizuar)
  - Mbajtës mekanik të shpërndarjes së shkumës
  - 1 prodhues me shtrirje të lartë dhe depozitë shkume
  - 2 fikës zjarri me ujë (9 litra)
  - 6 fikse zjarri me shkumë (9 litra)
  - 6 fikëse zjarri me dioksid karboni (5 kilogram)
  - 10 fikëse zjarri me pluhur (10 kilogram)
  - Rimbushje për fikset e zjarrit
  - 25 komplete veshjesh mbrotëse, kominoshe, doreza, çizme zjarrduruese, helmëta dhe mushama
  - 25 komplete aparate frymëmarje, me bombola rezervë dhe vegla mirëmbajtje
  - 30 copë EEBD (pajisje frymëmarrëse për largim emergjence)
  - Kompresor ajri për funizim me oksigjen të bombolave të përdorura
  - 2 litarë zjarrdurues sigurie me nyjet (36 m të gjatë)
  - Prodhues tymi artificial
  - Helmëta për tym me pompë ajri
  - Një dush në vendin e praktikës
  - 1 barrelë
  - 1 komplet të ndihmës së parë
  - 1 komplet rigjallërimi me njësinë e thithjes së oksigjenit
  - 2 veshje zjarr-mbrojtëse
  - 2 helmëta me mbrojtje të fytyrës dhe qafës
  - 2 sopata të luftës kundra zjarrit
  - Lloje të ndryshme detektorësh zjarri që përdoren në anije
  - Tregues për rrugëkalimet e largimit në mjedisin e praktikës
  - Materiale të shkruara në mbështetje të veprimtarive praktike që kryhen.
-

## 8. Moduli “Ndhimja e parë elementare në anije”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDIHMJA E PARË ELEMENTARE NË ANIJE (IMO 1.13)	M-30-1037-15
Qëllimi i modulit	Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit/detarët me njohuri dhe aftësi për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të dhënë ndihmën e parë të dëmtuarve, me t'u paraqitur një aksident apo emergjencë tjetër mjekësore në bordin anijes.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW '78, i amenduar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përshkruan parimet e përgjithshme për dhënien e ndihmës së parë elementare në anije.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Parime të përgjithshme për ndihmën e parë</li><li>- Mënyrat e dhënies së alarmit.</li><li>- Parimi që në emergjenca, parësore është siguria vetjake.</li><li>- Masat e menjëhershme që duhet të merren në rastet e emergjencave.</li><li>- Përmbajtja e listëkontrollit të emergjencave si:<ul style="list-style-type: none"><li>- vlerësimi i situatës së aksidentit;</li><li>- vlerësimi i rreziqeve për veten;</li><li>- mungesa e vetëdijes;</li><li>- ndalimi i frymëmarrjes;</li><li>- gjakosja e rëndë;</li><li>- shpëtimi i rastësishëm dhe raportimi i emergjencës;</li></ul></li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë parimet e përgjithshme për ndihmën e parë</li><li>- të tregojë mënyrat e dhënies së alarmit.</li><li>- të analizojë parimin që në emergjenca, parësore është siguria vetjake.</li><li>- të tregojë masat e menjëhershme që duhet të merren në rastet e emergjencave.</li><li>- të shpjegojë përmbajtjen e listëkontrollit të emergjencave si: vlerësimin e situatës së aksidentit; vlerësimin e rreziqeve</li></ul>	

për veten; mungesën e vetëdijes; ndalimin e frymëmarrjes; gjakosjen e rëndë; shpëtimin e rastësishëm dhe raportimin e emergjencës;

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 2 Nxënësi përshkruan strukturën e trupit të njeriut dhe funksionet e pjesëve të tij.**

***Përmbajtja***

- Skema e përgjithshme e ndërtimit të trupit të njeriut.
- Skeleti, ndërtimi, funksioni;
- Nyjet, ndërtimi, funksioni;
- Muskujt, ndërtimi, funksioni;
- Tendinat, ndërtimi, funksioni;
- Organet madhore (truri, zemra, mushkëritë etj.), ndërtimi, funksionet;
- Sistemet e qarkullimit (të gjakut, të ajrit etj.), ndërtimi, funksionet;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë skemën e përgjithshme e ndërtimit të trupit të njeriut.
- të përshkruajë skeletin, ndërtimin dhe funksionimin e tij;
- të përshkruajë nyjet, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
- të përshkruajë muskujt, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
- të përshkruajë tendinat, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
- të përshkruajë organet madhore (trurin, zemrën, mushkëritë etj.), ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
- të përshkruajë sistemet e qarkullimit (të gjakut, të ajrit etj.), ndërtimin dhe funksionimin e tyre;

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 3 Nxënësi përshkruan dhe demonstroi pozicionimin e duhur të personit të dëmtuar.**

***Përmbajtja:***

- Pozicionet e duhura të personave të dëmtuar në rastet e emergjencës:
  - pozicioni i gjetjes;
  - pozicioni i ringjalljes;
- Procedurat për pozicionimin e duhur të personit të dëmtuar në rastet e emergjencës

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë pozicionet e duhura të personave të dëmtuar në rastet e emergjencës, të tilla si: pozicioni i gjetjes; pozicioni i ringjalljes.

- 
- të zbatojë procedurat e duhura për pozicionimin e përshtatshëm të personit të dëmtuar në rastet e emergjencës.
- 

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 4 Nxënësi vepron me të dëmtuarin e pavetëdijshëm.**

***Përmbajtja:***

- Shenjat për të dalluar të dëmtuarin e pavetëdijshëm.
- Rreziqet nga pavetëdijshmëria e të dëmtuarit.
- Masat që merren për të ndihmuar të dëmtuarin e pavetëdijshëm.
- Mbajtja e lirë e rrugëve të ajrimit.
- Pozicionimi i duhur i të dëmtuarit të pavetëdijshëm.
- Veprimet në rastet e ndalimit të frymëmarrjes apo rrahjeve të zemrës.
- Mos-dhënia e ushqimeve, lëngjeve apo substancave të tjera nga goja e të dëmtuarit të pavetëdijshëm.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë shenjat për të përcaktuar nëse i dëmtuari është i pavetëdijshëm.
- të përshkruajë rreziqet nga pavetëdijshmëria e të dëmtuarit.
- të përshkruajë masat që merren për të ndihmuar të dëmtuarin e pavetëdijshëm.
- të veprojë për të mbajtur të lira rrugët e ajrimit.
- të bëjë pozicionimin e duhur të të dëmtuarit të pavetëdijshëm.
- të kryejë veprimet e duhura në rastet e ndalimit të frymëmarrjes apo rrahjeve të zemrës.
- të tregojë arsyet e mos-dhënies së ushqimeve, lëngjeve apo substancave të tjera nga goja e të dëmtuarit të pavetëdijshëm.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 5 Nxënësi përshkruan dhe realizon veprimet për ringjalljen e të dëmtuarit.**

***Përmbajtja:***

- Domosdoshmëria për një ringjallje sa më të shpejtë të të dëmtuarit në raste të ndryshme të emergjencës.
  - Zbatimi i procedurave të ringjalljes vetëm, ose me ndihmën e një njeriu tjetër, për një kohë minimale prej dhjetë minutash nëpërmjet:
    - kontrollit të frymëmarrjes;
    - lëvizjes dhe shtrirjes prapa të kokës;
    - frymëmarrjes gojë me gojë;
    - frymëmarrjes gojë me hundë;
  - Metodatat dhe faktorët që zbatohen në rastet e ndalimit të zemrës:
    - masazhi kardiak;
-

- 
- ringjallja kardiopulmonare (CPR).

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë domosdoshmërinë për një ringjallje sa më të shpejtë të të dëmtuarit në raste të ndryshme të emergjencës.
- të kryejë procedurat e ringjalljes vetëm, ose me ndihmën e një njeriu tjetër, për një kohë minimale prej dhjetë minutash nëpërmjet: kontrollit të frymëmarrjes; lëvizjes dhe shtrirjes prapa të kokës; frymëmarrjes gojë me gojë; frymëmarrjes gojë me hundë.
- të kryejë masazh kardiak dhe ringjallje kardiopulmonare (CPR) në rastet e ndalimit të zemrës së të dëmtuarit.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 6 Nxënësi përshkruan dhe përdor masat e duhura për reagimin në rastet e gjakosjeve (hemoragjive).**

**Përmbajtja:**

- Rreziqet për shkak të gjakosjes së të dëmtuarit.
- Masat e duhura fillestare për të minimizuar gjakosjen në mënyrë të veçantë në rastet e:
  - gjakosjes së brendshme;
  - gjakosjes së jashtme;
- Gjëndja e shokut nga gjakosja.
- Aplikimi i shtypjes së jashtme për të minimizuar gjakosjen.
- Pozicionimi i të dëmtuarit për të minimizuar gjakosjen.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rreziqet për shkak të gjakosjes së të dëmtuarit.
- të marrë masat e duhura fillestare për të minimizuar gjakosjen në mënyrë të veçantë në rastet e gjakosjes së brendshme dhe gjakosjes së jashtme.
- të marrë masat për të shmangur gjëndjen e shokut nga gjakosja.
- të aplikojë shtypjen e jashtme për të minimizuar gjakosjen.
- të bëjë pozicionimin e duhur të të dëmtuarit për të minimizuar gjakosjen.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 7 Nxënësi përshkruan dhe përdor masat për menaxhimin e gjendjes së shokut të dëmtuarit.**

**Përmbajtja:**

- Faktorët kryesorë që shkaktojnë gjëndjen e shokut.
- Shenjat e shokut si ngjyra e fytyrës, ritmi dhe karakteri i pulsit.

- 
- Metodatat thelbësore për menaxhimin e gjëndjes së shokut:
    - ndalimi i gjakosjes, mbrojtja nga të ftohtit;
    - konsumimi menjëhere dhe i bollshëm i lëngjeve n.q.s. pacienti është i vetëdijshëm;
    - pozicionimi i pacientit;
  - Faktorët përkeqësues të shokut: duhani, alkooli, lëvizjet.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë faktorët kryesorë që shkaktojnë gjëndjen e shokut.
- të interpretojë shenjat e shokut si ngjyra e fytyrës, ritmi dhe karakteri i pulsit.
- të zbatojë mënyrat kryesore për menaxhimin e gjëndjes së shokut: ndalimi i gjakosjes, mbrojtja nga të ftohtit; konsumimi menjëhere dhe i bollshëm i lëngjeve n.q.s. pacienti është i vetëdijshëm; pozicionimi i duhur i pacientit.
- të analizojë faktorët përkeqësues të shokut: duhani, alkooli, lëvizjet.

---

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 8 Nxënësi përshkruan dhe zbaton masat për reagim ndaj djegieve, përvëlimeve dhe aksidenteve të shkaktuara nga rryma elektrike.**

***Përmbajtja:***

- Shenjat e djegies, përvëlimeve dhe aksidenteve të shkaktuara nga rryma elektrike.
- Zbatimi i masave të duhura për djegjet dhe përvëlimet.
- Ftohja e zonës së djegur sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Aplikimi i masave të duhura për djegjet (dëmtimet) nga kimikatet.
- Heqja e rrobave dhe shpëlarja me ujë të bollshëm.
- Aplikimi i masave të duhura për djegjet e syve nga kimikatet.
- Shpëlarja e syve me ujë të bollshëm.
- Aplikimi i masave të duhura në aksidentet e shkaktuara nga rryma elektrike.
- Shmangia e rreziqeve për vetë shpëtuesit dhe izolimi i të dëmtuarit nga rryma elektrike.
- Mbrojtja nga shoku, kontrolli i funksioneve jetësore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë shenjat e djegies, përvëlimeve dhe aksidenteve të shkaktuara nga rryma elektrike.
  - Të zbatojë masat e duhura për djegjet dhe përvëlimet.
-

- Të bëjë ftohjen e zonës së djegur sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Të zbatojë masat e duhura për djegiet (dëmtimet) nga kimikatet.
- Të bëjë heqjen e rrobave të të dëmtuarit dhe shpëlarjen e tyre me ujë të bollshëm.
- Të zbatojë masat e duhura për djegjet e syve nga kimikatet.
- Të bëjë shpëlarjen e syve me ujë të bollshëm.
- Të zbatojë masat e duhura në aksidentet e shkaktuara nga rryma elektrike.
- Të bëjë shmangien e rreziqeve për vetë shpëtuesit dhe izolimin e të dëmtuarit nga rryma elektrike.
- Të bëjë mbrojtjen nga shoku dhe kontrollin e funksioneve jetësore të të dëmtuarit.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 9 Nxënësi përshkruan veprimet dhe realizon shpëtimin dhe transportin e të dëmtuarit**

***Përmbajtja:***

- Aplikimi i transportit të duhur të të dëmtuarit, vetëm ose me ndihmën e një personi tjetër, duke marrë parasysh zonat e mbyllura dhe lartësitë e ndryshme në bordin e anijes.
- Veçoritë e realizimit të:
  - transportit me mjete rrethore;
  - transportit me barrelë;
  - transportit me karrige;
  - transportit me copë trekëndeshe;
  - transportit të ilustruar në IMGS.
- Rreziqet e transportimit të personit me dëmtime të pelvisit dhe/ose shtyllës kurrizore.
- Procedurat e duhura të transportimit të personit me dëmtime të pelvisit dhe/ose shtyllës kurrizore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë transportin e duhur të të dëmtuarit, vetëm ose me ndihmën e një personi tjetër, duke marrë parasysh zonat e mbyllura dhe lartësitë e ndryshme në bordin e anijes.
- të kryejë transportin e të dëmtuarit: me mjete rrethore; me barrelë; me karrige; copë trekëndeshe; me imgs.
- të përshkruajë rreziqet e transportimit të personit me dëmtime të pelvisit dhe/ose shtyllës kurrizore.
- të kryejë transportimin e personit me dëmtime të pelvisit dhe/ose shtyllës kurrizore.

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe**

**RM 10 Nxënësi përshkruan dhe zbaton veprimet në lidhje me ndihmën e parë dhe shëndetin në anije**

***Përmbajtja:***



---

**procedurat e vlerësimit**

- Improvizimi i fashimit me mjete rrethanore.
- Përdorimi i materialeve fashuese në pajimet e emergjencës.
- Teknika e përdorimit korrekt të fashave.
- Rreziqet gjatë hyrjes në zonat e mbyllura.
- Rreziku që hapësirat e mbyllura të mund të përmbajnë gazra të rrezikshëm ose mungesë O<sub>2</sub>.
- Marrja e masave të duhura paraprake para hyrjes në këto zona.
- Rreziqet nga gjaku apo sekrecionet nga persona që vuajnë nga sëmundjet infektive, në mënyrë të veçantë hepatitet dhe të sëmurët me virusin HIV.
- Marrja e masave mbrojtëse vetjake kur ke të bësh me këta persona.
- Proçedurat e duhura për mos infektimin nëpërmjet gjakut dhe sekrecioneve, në raste të tilla.
- Zbatimi i rregullave të thjeshta për mirëmbajtjen e shëndetit dhe pastërtisë vetjake.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të bëjnë improvizimin e fashimit me mjete rrethanore.
- Të përdorë materialet fashuese në pajimet e emergjencës.
- Të bëjë përdorimin korrekt të fashave.
- Të përshkruajë rreziqet gjatë hyrjes në zonat e mbyllura.
- Të dallojë rastet kur hapësirat e mbyllura të mund të përmbajnë gazra të rrezikshëm ose mungesë O<sub>2</sub>.
- Të marrë masat e duhura paraprake para hyrjes në këto zona.
- Të analizojë rreziqet nga gjaku apo sekrecionet nga persona që vuajnë nga sëmundjet infektive, në mënyrë të veçantë hepatitet dhe të sëmurët me virusin HIV.
- Të marrë masat mbrojtëse vetjake kur të ketë të bëjë me këta persona.
- Të zbatojë proçedurat e duhura për mos infektimin nëpërmjet gjakut dhe sekrecioneve, në raste të tilla.
- Të zbatojë rregulla të thjeshta për mirëmbajtjen e shëndetit dhe higjienës vetjake.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë ose në anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të masave për dhënien e ndihmës së parë elementare në anije.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për dhënien e ndihmës së parë elementare.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me çështjet e trajtuara.
- Metodatat e lojës me role dhe të simulimit të situatave emergjente duhet të të përdoren nga instruktori për të mundësuar

- 
- përvetësimin e kompetencave që përmban moduli.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në dhënien e ndihmës së parë elementare.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin e pjesës teorike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë ose mjedis anijeje.
- Tavolinë për demonstrim me përmasa 3 x 1 m.
- Materiale të shkruara dhe audio-vizive apo me slaidera si:
  - tabela udhëzuese të hapave të punës për dhënien e ndihmës së parë elementare

Për realizimin e pjesës praktike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Dhoma mësimore për instruktimin praktik, demonstrimin dhe aplikacionet.
  - Pajimet e mëposhtme duhet të jenë të disponueshme:
    - kutia e ndihmës mjekësore të anijes me përmbajtjen;
    - fasha për krahun, duart, këmbët e dëmtuara, etj.;
    - veshje, fasha;
    - një manikin me përmasa njeriu për trajnimin e frymëdhënies praktike;
    - barrelë;
-

## 9. Moduli “Përdorimi i mjeteve dhe i mekanizmave të kuvertës“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>PËRDORIMI I MJETEVE DHE I MEKANIZMAVE TË KUVERTËS</b>	<b>M-30-1193-15</b>
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer disa nga operacionet më kryesore në sektorin e kuvertës në anije tradicionale të tilla si: përdorimi i mjeteve dhe i mekanizmave për kalim cimash dhe kavosh, përdorimi i mjeteve për akotim/ç’akostim, përdorimi i mjeteve e i mekanizmave për uljen/ngritjen e shkallës së imbarkimit, asistencë për eprorët në matjen e tankeve të lëngjeve, përgaritja e mjeteve dhe pajisjeve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit, kryerja e matjeve meteorologjike në anije etj.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW ’78, i amenduar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi përdor mjetet e mekanizmat për kalimin e cimave e kavove në anije.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.</li><li>- Përzgjedhja e mjeteve dhe mekanizmave të nevojshëm.</li><li>- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet.</li><li>- Kalimi i cimës në makarâ.</li><li>- Kalimi i cimës në parango.</li><li>- Kalimi kavove në tajat metalike.</li><li>- Përdorimi i ganxhave për kalim cime dhe kavo.</li><li>- Përdorimi i pastekës për kalimin e cimës.</li><li>- Përdorimi i okjos për kalim cimash dhe kavosh.</li><li>- Përdorimi bocës për stopim cimash dhe kavosh .</li><li>- Përdorimi i gametës për kalim cimash dhe kavosh.</li><li>- Përdorimi i kalunëve për nxjerjen e cimës.</li><li>- Përdorimi i kacaskotave për nxjerjen e cimës.</li><li>- Përdorimi i tamburove të vinxhave të instaluar në anije për kalim cimash dhe kavosh.</li><li>- Përdorimi i rrulave për kalim cimash dhe kavosh.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul>	

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim;
- të përzgjedhë mjetet dhe mekanizmat për kalimin e cimave dhe kavove;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen operacionet e kalimit të cimave dhe kavove;
- të kalojë saktë cimën në makarë;
- të kalojë saktë cimën në parango;
- të kalojë saktë kavot në taja metalike;
- të përdorë saktë ganxhat për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë pastekën për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë okjon për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë bocën për stopimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë gametën për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë kalunët për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë kacaskotat për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë tamburot e vinxhave të instaluar në anije për kalimin e cimave dhe kavove;
- të përdorë saktë rrulat për kalimin e cimave dhe kavove;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmat për kalimin e cimave e kavove në anije.

**RM 2 Nxënësi përdor mjetet e mekanizmat për akostimin e anijes*****Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve për akostimin e anijes.
- Përgatitja e pandulit për hedhje.
- Përgatitja e cimave që do të përdoren për akostim.
- Raportimi i gatishmërisë dhe distancës nga vendi i akostimit.
- Hedhja e pandulit drejt vendit ku do të akostohet anija.
- Sigurimi që panduli është kapur nga personat të tjerë nga krahu ku do të akostohet anija.
- Kalimi drejt i fijes së pandulit nëpër okio sipas rastit për t'a lidhur me cimën e akostimit.
- Lidhja e fijes së pandulit me cimën e akostimit.
- Lirimi i cimës së akostimit për t'a nxjerë jashtë bordit.
- Ndjekja e kapjes së cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija.
- Raportimi për kapjen dhe sigurimin e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija.
- Përdorimi i pastekave për kalimin e cimave.
- Vendosja e krahut të cimës që ndodhet në bord në barabanin e mekanizmit të akostimit.

- Përdorimi i bocës për mbajtjen e cimës para fiksimit në anije
- Lidhja e cimave në kalunë.
- Vendosja e gomave përgjatë skafit në bordin e akostimit.
- Marrja e pandulave në bord.
- Vendosja e mjeteve në vendet e duhura.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet për akostimin e anijes;
- të përgatisë pandulin për hedhje;
- të përgatisë cimën që do të përdoren për akostim sipas udhëzimit;
- të raportojë gatishmërinë dhe distancën nga vendi i akostimit eprorit;
- të hedhë pandulin drejt vendit ku do të akostohet anija;
- të sigurohet që panduli është kapur nga personat të tjerë nga krahu ku do të akostohet anija;
- të kalojë drejt fijen e pandulit nëpër okio sipas rastit për t'a lidhur me cimën e akostimit sipas udhëzimit;
- të lidhë fijen e pandulit me cimën e akostimit;
- të lirojë cimën e akostimit për t'a nxjerë jashtë bordit sipas udhëzimit;
- të ndjekë kapjen e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija;
- të raportojë për kapjen dhe sigurimin e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija;
- të përdorë si duhet pastekat për kalimin e cimave;
- të vendosë krahun e cimës që ndodhet në bord në barabanin e mekanizmit të akostimit me volla saktë;
- të përdorë bocat për mbajtjen e cimës para fiksimit në anije;
- të lidhë drejt dhe në mënyrë të sigurtë cimën në kalunë;
- të vendosë gomën përgjatë skafit në bordin e akostimit sipas udhëzimit;
- të marrë pandulat në bord;
- të vendosë mjetet dhe veglat në vendet e duhura;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për akostimin e anijes.

### **RM 3 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për ç'akostimin e anijes**

#### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve për ç'akostimin e anijes.
- Raportimi i gatishmërisë për ç'akostim.
- Lirimi i cimës.
- Sigurimi që cima është e lirë edhe nga vendi i ç'akostimit.
- Stivimi i cimës neto në vendin e caktuar.
- Raportimi për marjen e cimave në bord.
- Heqja e gomave përgjatë skafit në bordin e akostimit.
- Vendosja e mjeteve në vendet e duhura.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet për ç'akostimin e anijes;
- të raportojë gatishmërinë për ç'akostim eprorit;
- të lirojë cimën sipas udhëzimit;
- të sigurohet që cima është e lirë edhe nga vendi i ç'akostimit;
- të stivojë cimën neto në vendin e caktuar;
- të raportojë për marjen e cimave në bord;
- të heqë gomat përgjatë skafit në bordin e akostimit sipas udhëzimit;
- të vendosë mjetet në vendet e duhura;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për ç'akostimin e anijes.

### **RM 4 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për uljen e shkallës së imbarkimit.**

#### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve për uljen e shkallës së imbarkimit.
- Lirimi i bllokueses së shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes.
- Shpalosja e bashkërenduar e shkallës nga pozicioni ngjitur me bandën në pozicionin horizontal.
- Vendosja e belaustrave (pamakëve) portative në vendet e tyre përgjatë shkallës.
- Lidhja/fiksimi i belaustrave njëra me tjetrën për secilin krah të shkallës.
- Vendosja e rretës mbrojtëse përgjatë shkallës.
- Vendosja e rrethit të shpëtimit pranë çarkut të shkallës.
- Raportimi eprorit për gatishmërinë e shkallës së imbarkimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së

mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet për uljen e shkallës së imbarkimit;
- të lirojë bllokuesit e shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes;
- të shpalosë me bashkërendim shkallën nga pozicioni ngjitur me bandën në pozicionin horizontal duke përdorur tajat me cima, apo mjete të tjera sipas specifikës së anijes;
- të vendosë belaustrat (pamakët) portative në vendet e tyre përgjatë shkallës;
- të lidhë/fiksojë belaustrat njëra me tjetrën për secilin krah të shkallës;
- të vendosë rrjetën mbrotëse përgjatë shkallës;
- të vendosë rrethin e shpëtimit pranë çarkut të shkallës;
- të raportojë eprorit për gatishmërinë e shkallës së imbarkimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për uljen e shkallës së imbarkimit.

**RM 5 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për ngritjen e shkallës së imbarkimit.**

**Përmbajtja:**

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve për ngritjen e shkallës së imbarkimit.
- Heqja e rrethit të shpëtimit pranë çarkut të shkallës.
- Heqja e rrjetës mbrotëse përgjatë shkallës.
- Heqja/zgjidhja e belaustrave njëra me tjetrën nga secili krah i shkallës.
- Heqja e belaustrave (pamakëve) portative nga vendet e tyre përgjatë shkallës.
- Palosja e bashkërenduar e shkallës nga pozicioni horizontal me bandën në pozicionin ngjitur
- Vendosja e bllokuese të shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes.
- Raportimi për marjen në bord të shkallës së imbarkimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet për ngritjen e shkallës së imbarkimit;

- të heqë rrethin e shpëtimit pranë çarkut të shkallës;
- të heqë rrjetën mbrotëse përgjatë shkallës;
- të heqë/zgjidhë belaustrat njëra nga tjetra nga secili krah i shkallës;
- të heqë belaustrat (parmakët) portative nga vendet e tyre përgjatë shkallës;
- të palosë me bashkërendim shkallën nga pozicioni horizontal me bandën në pozicionin ngjitur duke përdorur tajat me cima, apo mjete të tjera sipas specifikës së anijes;
- të vendosë bllokueset e shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes;
- të raportojë eprorit për marjen në bord të shkallës së imbarkimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për ngritjen e shkallës së imbarkimit.

## **RM 6 Nxënësi vendos mjetet dhe veglat për pritjen e pilotit.**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e veglave e mjeteve të punës për pritjen e pilotit.
- Vendosja e shkallës së brendshme të bandës.
- Vendosja e shufrave mbajtëse.
- Kontrolli i shkallës së pilotit para lëshimit jashtë bordit.
- Lidhja paraprake e fundeve të shkallës tek kacaskotat e caktuara.
- Lëshimi jashtë bordit i shkallës.
- Rregullimi i lartësisë nga vija e ujit.
- Fiksimi përfundimtar i lidhjeve të shkallës.
- Vendosja e rrethit të shpëtimit pranë shufrave mbajtëse.
- Raportimi për gatishmërinë e pritjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për pritjen e pilotit;
- të vendosë shkallën e brendshme të bandës në vendin dhe bordin e caktuar nga oficeri;
- të vendosë shufrat mbajtëse tek vendet e duhura në filin e bandës;
- të kontrollojë shkallën e pilotit para lëshimit jashtë bordit;
- të bëjë lidhje paraprake të fundeve të shkallës tek kacaskotat e caktuara;
- të lëshojë jashtë bordit shkallën;
- të rregullojë lartësinë nga vija e ujit sipas udhëzimit të oficerit;
- të realizojë fiksimin përfundimtar të lidhjeve të shkallës;



- të vendosë rrethin e shpëtimit pranë shufrave mbajtëse;
- të raportojë për gatishmërinë e pritjes së pilotit eprorit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vendosjes së mjeteve e veglave për pritjen e pilotit.

#### **RM 7 Nxënësi largon mjetet dhe veglat pas përcjelljes së pilotit**

##### ***Përmbajtja:***

- Veshja e pajimeve të mbrojtjes vetjake në punë.
- Shkuarja në vendin ku janë vendosur veglat dhe mjetet për pritjen e pilotit.
- Transferimi i shkallës së brendshme të bandës në vendin e caktuar për të.
- Heqja e shufrave mbajtëse nga vendet në filin e bandës.
- Ngritja në bord e shkallës së pilotit.
- Zgjidhja e fundeve të shkallës nga kacaskotat/vendet ku janë lidhur.
- Mbledhja e shkallës në formën e rotativit.
- Heqja e rrethit të shpëtimit nga vendi.
- Vendosja e shkallës, veglave dhe mjeteve të tjera në vendet e caktuara.
- Raportimi për përfundimin e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë pajimet e mbrojtjes vetjake në punë;
- të shkojë në vendin ku janë vendosur veglat dhe mjetet për pritjen e pilotit;
- të transferojë shkallën e brendshme të bandës në vendin e caktuar për të;
- të heqë shufrat mbajtëse nga vendet në filin e bandës;
- të ngrejë në bord shkallën e pilotit;
- të zgjidhë fundet e shkallës nga kacaskotat/vendet ku janë lidhur;
- të mbledhë shkallën në formën e rotativit;
- të heqë rrethin e shpëtimit nga vendi;
- të vendosë shkallën, veglat dhe mjetet e tjera në vendet e caktuara;
- të raportojë për përfundimin e punës oficerit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë largimit të mjeteve e veglave pas përcjelljes së pilotit.

#### **RM 8 Nxënësi asiston nostromon për matjen e lëngjeve në tanke.**

##### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjeteve për matjen e tankeve.
- Hapja e kapakut të matjes.

- Lyerja e sondës me pastën lagështi-treguese.
- Ulja e sondës në tubin e matjes.
- Ngritja e sondës.
- Kqyrja e shenjës së lagies së sondës nga uji i tankut.
- Raportimi i gjatësisë së lagur i sondës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet matja;
- të hapë kapakun për matje sipas udhëzimit të oficerit;
- të lyejë sondën me pastën lagështi-treguese në zonën ku orienton nostromo;
- të ulë sondën në tubin e matjes me ngadalë deri sa të prekë fundin e tankut;
- të ngrejë sondën duke mbledhur neto fijen lidhëse;
- të kqyrë me kujdes shenjën e lagies së sondës nga uji i tankut në zonën e ngjyer me pastë;
- të raportojë gjatësinë e lagur të sondës eprorit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë asistimit të nostromos për matjen e tankeve (depove) të ujit në anije.

**RM 9 Nxënësi kryen dhe interpreton matjet meteorologjike në anije.**

***Përmbajtja:***

Matja me fluger:

- Marrja e kutisë së flugerit nga vendi i ruajtjes.
- Hapja e kutisë dhe nxjerrja e flugerit nga kutia.
- Kontrolli pamor për gjendjen teknike të flugerit.
- Zgjedhja e vendit ku do të kryejë matjen.
- Mbatja e flugerit në pozicion matjeje.
- Interpretimi i të dhënave në ekranin e flugerit.

Matja e temperaturës dhe lagështisë:

- Marrja e kutisë së termometrave psihrometrikë nga vendi i ruajtjes.
- Hapja e kutisë dhe nxjerrja e termometrave nga kutia.
- Kontrolli pamor për gjendjen teknike të termometrave.
- Dallimi i termometrit të thatë nga ai i lagët.
- Lagia me ujë e pambukut të termometrit të lagështisë.
- Zgjedhja e vendit ku do të kryhen matjet.
- Mbatja e termometrave në pozicion matjeje.
- Leximi i temperaturës së matur nga të dy termometrat.
- Përcaktimi i lagështirës relative dhe absolute të ajrit.

#### Matja e shtypjes atmosferike:

- Mbajtja hapur e dritareve të ambientit ku ndodhet barometri.
- Godetja e lehtë me gisht në xhamin e aparatit të barometrit.
- Interpretimi i të dhënave të shigjetës treguese të shtypjes.
- Vendosja e shigjetës së besimit tek shigjeta treguese e shtypjes

#### Leximi i busullës:

- Shikimi i gradëve që tregon vija e besimit e busullës.
- Korrigjimi i leximit të busullës.
- Raportimi i drejtimit të bashit.
- Vendosja e pelengatorit mbi busull.
- Marrja e drejtimit (pelengun) të objektit që i kërkohet nga eprori.
- Raportimi i pelengut.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë kryerjes së matjeve meteorologjike në anije.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje me gojë.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

#### Në lidhje me matjen me fluger:

- të marrë rutinë e flugerit pa e dëmtuar atë;
- të hapë në mënyrë korrekte rutinë e flugerit;
- të verifikojë gjëndjen teknike të flugerit;
- të përzgjedhë një vend të hapur dhe pa pengesa për kryerjen e matjes;
- të mbajë si duhet flugerin në pozicion matjeje;
- të interpretojë saktë të dhënat e flugerit: shpejtësinë dhe drejtimin e erës;

#### Në lidhje me matjen e temperaturës dhe lagështisë:

- të marrë rutinë e termometrave pa e dëmtuar atë;
- të hapë saktë rutinë e termometrave;
- të verifikojë gjëndjen teknike të termometrave;
- të dallojë termometrën e thatë nga ai i lagët ;
- të përzgjedhë një vend ku ka hije dhe ku nuk ka ndonjë burim tjetër nxehtësie për kryerjen e matjes;
- të mbajë termometrat në pozicion matjeje.
- të lexojë saktë të dhënat e temperaturës në të dy termometrat: të thatë dhe të lagur;

#### Në lidhje me matjen e shtypjes atmosferike:

- të mbajë hapur për 20 minuta, dritaret e ambientit ku ndodhet barometri për matjen e shtypjes atmosferik;
- të godasë lehtë me gisht në xhamin e aparatit të barometrit.
- të interpretojë të dhënat e shigjetës treguese të shtypjes.
- të vendosë shigjetën e besimit tek shigjeta treguese e shtypjes.

- të përcaktojë saktë lagështinë relative dhe absolute me anë të tabelës psihometrike;
- të kryejë si duhet procedurat për leximin e shtypjes
- të lexojë saktë të dhënat mbi shtypjen atmosferike.

Në lidhje me leximin e busullës:

- të shikojë vazhdimisht gradët që tregon vija e besimit e busullës;
- të bëjë korigjimin e leximit të busullës sipas tabelës;
- të raportojë me interpretim te eprori për drejtimin e bashit;
- të vendosë si duhet pelengatorin mbi busull;
- të marrë drejtimin (pelengun) e objektit që i kërkohet nga eprori;
- të raportojë me interpretim, pelengun te eprori;
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së matjeve meteorologjike.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije dhe në laborator.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të përdorimit të mjeteve e mekanizmave për kalimin e cimave e kavove, asistimin e punës së mekanizmit të spirancës për hedhje e marrje, akostimin e ç'akostimin, uljen e ngritjen e shkallës së imbarkimit, vendosjen dhe largimin e mjeteve e veglave për pritjen e përcelljen e pilotit, kryerjen e matjeve meteorologjike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përdorimin e mjeteve dhe mekanizmave për kalimin e cimave dhe kavove, asistimin në punën e mekanizmit të spirancës për hedhje e marrje në anije, akostimin e ç'akostimin, uljen e ngritjen e shkallës së imbarkimit, vendosjen dhe largimin e mjeteve e veglave për pritjen e përcelljen e pilotit, kryerjen e matjeve meteorologjike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise anije dhe laborator.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe mekanizmave të nevojshme për punën në kuvertë dhe kryerjen e matjeve meteorologjike.
  - Mjete të ndryshme lundrimi.
  - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 10. Moduli “Punime ndihmëse elektromekanike në anije”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE ELEKTROMEKANIKE NË ANIJE	M-30-167-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për kryerjen e punimeve ndihmëse elektromekanike në anije, si mirëmbajtje të filtrave, zëvendësime të ndriçuesve, punime ndihmëse në lokalin e makinerisë etj.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW '78, i amenduar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbytja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen punime mirëmbajtjeje të filtrave</b> <b>Përmbytja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet shërbimi;</li><li>- Përcaktimi i mjeteve të punës për kryerjen e punimeve;</li><li>- Çmontimi i filtrit të ajrit;</li><li>- Pastrimi i filtrit të ajrit me kompresor;</li><li>- Montimi i filtrit të ajrit;</li><li>- Çmontimi i filtrit të naftës;</li><li>- Pastrimi i filtrit të naftës me naftë;</li><li>- Montimi i filtrit të naftës;</li><li>- Çmontimi i filtrit të vajit;</li><li>- Pastrimi i filtrit të vajit me naftë;</li><li>- Montimi i filtrit të vajit;</li><li>- Mbyllja e volantit të saraçineskës së ujit të detit të prezodimares;</li><li>- Lirimi i dadove të kapakut të filtrit të ujit;</li><li>- Nxjerrja jashtë e filtrit të ujit të detit nga prezodimarja;</li><li>- Pastrimi i filtrit të ujit të prezodimares;</li><li>- Lyerja me bojë e filtrit të ujit;</li><li>- Vendosja e filtrit të ujit të detit në prezodimare;</li><li>- Vendosja e kapakut;</li><li>- Shtërngimi i kapakut;</li><li>- Hapja e volantit të saraçineskës së ujit të detit të prezodimares;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul>	

---

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet shërbimi;
- të përcaktojë mjetet e punës për kryerjen e punimeve;
- të çmontojë si duhet filtrin e ajrit;
- të pastrojë si duhet filtrin e ajrit me kompresor;
- të montojë filtrin e ajrit;
- të çmontojë filtrin e naftës;
- të pastrojë si duhet filtrin e naftës me naftë duke e fshirë më pas me leckë;
- të montojë si duhet filtrin e naftës;
- të çmontojë filtrin e vajit;
- të pastrojë si duhet filtrin e vajit me naftë duke e fshirë atë;
- të montojë si duhet filtrin e vajit;
- të mbyllë mirë volantën e saraçineskës së ujit të detit të prezodimares;
- të lirojë dadot e kapakut të filtrit me çelësa;
- të nxjerrë jashtë filtrin e ujit nga prezodimarja;
- të pastrojë filtrin e ujit të prezodimares me furçë teli ose rrashpë;
- të lyejë me bojë filtrin e ujit;
- të vendosë filtrin e ujit në prezodimare, mbas tharjes së bojës;
- të vendosë mirë kapakun;
- të shtërngojë kapakun me çelësa;
- të hapë normalisht volantën e saraçineskës së ujit të detit të prezodimares;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 2 Nxënësi ndërron llampat e ndriçimit në anije**

***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i vendit dhe mjeteve të punës për kryerjen e shërbimit;
- Përzgjedhja e materialeve të punës;
- Stakimi i çelësit të tensionit të linjës;
- Çmontimi i mbulesës plafoniere;
- Çmontimi i llampës së djegur;
- Vendosja e llampës së re;
- Prova për funksionimin e llampës;
- Shtërngimi i mbulesës plafoniere;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i masave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e shërbimit;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të stakojë çelësin e tensionit të linjës;
- të çmontojë mbulesën plafoniere;
- të çmontojë llampën e djegur;
- të vendosë llampën e re sipas tensionit që ka linja;
- të provojë funksionimin e llampës me tension;
- të shtërngojë mbulesën plafoniere;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve.

**RM 3 Nxënësi kryen punime ndihmëse në lokalin e makinerisë**

***Përmbajtja:***

- Ndezja / fikja e pompës së vajit, ujit dhe naftës të motorrit kryesor dhe të moto-gjeneratorëve;
- Ndezja / fikja e pompës së cekimit të sentinave;
- Hapja / mbyllja e saraçineskave të sistemeve të tubacioneve;
- Izolimi i tubacioneve të shkarikos me litar e beze amianti.
- Eliminimi i rrjedhjeve të ujit tek bashkimet e flanxhave të tubacioneve;
- Takimi / stakimi i çelësit të linjës për dhënie energjie tek mekanizmat e ndryshëm si vinxh spirance, vinxh trate, etj.
- Takimi / stakimi i çelësit të linjës për dhënie energjie për ndriçim në sektorë të anijes;
- Përgatitja e guarnicioneve të ndryshme të tubacioneve;
- Vendosje e guarnicioneve në montim;
- Zmontim dhe montim të bulonave të kapakëve të një depo lëngu;
- Kryerja e markimeve të ndryshme me bojë të sistemeve, tubacioneve dhe kuadro elektrike;
- Kryerja e punimeve të pastrimit në lokalin e makinerisë;
- Ndihma që i jep motorristit në punime të ndryshme mirëmbajtjeje;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndezë / fikë pompën e vajit, ujit dhe naftës të motorrit kryesor dhe të moto-gjeneratorëve sipas udhëzimeve;
- të ndezë/fikë pompën e cekimit të sentinave sipas

- udhëzimeve;
- të hapë / mbyllë saraçineskat e sistemeve të tubacioneve përkatëse sipas urdhëzimit;
  - të izolojë tubacionet e shkarikos me litar dhe beze amianti sipas udhëzimeve;
  - të eliminojë rrjedhje uji tek bashkimet e flanxhave të tubacioneve duke vendosur guarnicione sipas udhëzimeve;
  - të takojë / stakojë çelësin e linjës për dhënie energjie tek mekanizmat e ndryshëm si vinxh spirance, vinxh trate, etj. sipas udhëzimeve;
  - të takojë / stakojë çelësin e linjës për dhënie energjie për ndriçim në sektorë të anijes sipas udhëzimeve;
  - të përgatisë guarnicione të ndryshme të tubacioneve;
  - të vendosë guarnicione në montim;
  - të zmontojë dhe montojë bulona të kapakëve të një depo lëngu;
  - të kryejë markime të ndryshme me bojë të sistemeve, tubacioneve dhe kuadro elektrike;
  - të kryejë punime pastrimi në lokalin e makinerisë sipas udhëzimeve;
  - të ndihmojë motorristin në punime të ndryshme mirëmbajtjeje, sipas udhëzimeve që i jepen;
  - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të punimeve ndihmëse elektromekanike në anije.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve ndihmëse elektromekanike në anije.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në përdorimin e mjeteve, agregateve dhe pajisjeve në lokalin e makinerisë dhe kuvertë

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:
- ambiente pune në lokalin e makinerisë një anije ose repart riparim mirëmbajtje të agregateve të ndryshme të anijeve.
  - Mjete dhe materiale për punimet elektromekanike në anije.
  - veshjet vetjake të sigurisë në punë si: helmetën mbrojtëse, syze mbrojtëse, kominoshet e punës, dorezat e lëkurës, tapat e mbrojtjes së veshëve, këpucët e sigurta, kufiet e zhurmave, maskën mbrojtëse ndaj avujve të dëmshëm.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e punimeve të ndryshme ndihmëse në lokalin e makinerisë dhe kuvertë.
-



## 11. Moduli “Trajtimi i pëlhurave dhe veglave të peshkimit”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I PËLHURAVE DHE VEGLAVE TË PESHKIMIT	M-16-168-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer riparime të thjeshta të pëlhurave, rrjetave dhe veglave të peshkimit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen riparime të thjeshta në rrjetën e dëmtuar</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjedhja e vendit dhe mjeteve të punës për riparim;</li><li>- Marja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të punohet;</li><li>- Përgatitja e mjeteve të punës;</li><li>- Prerja e rrjetës me thikë në zonën e dëmtuar;</li><li>- Mbushja e drugës me pe;</li><li>- Mbushja e zonës së prerë me endje me syza;</li><li>- Përgatitja e arnës së rrjetës;</li><li>- Mbushja e zonës së prerë me arnim;</li><li>- Përforcime të zonave të dobësuara të rrjetës;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë riparimit të rrjetës;</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë vendin dhe mjetet e punës për riparim;</li><li>- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të punojë;</li><li>- të përgatisë mjetet e punës për riparim;</li><li>- të presë rrjetën me thikë në zonën e dëmtuar sipas një cikli të caktuar;</li><li>- të mbushë drugën me fijen e duhur të perit;</li><li>- të mbushë në mënyrë uniforme, me endje me syza, zonën e prerë të rrjetës;</li><li>- të përgatisë arnën e rrjetës me përmasat dhe ciklin e përshtatshëm me prerjen;</li><li>- të mbushë zonën e prerë me arnim sipas ciklit të prerjes;</li><li>- të përforcojë zonat e dobësuara të rrjetës sipas udhëzimit;</li></ul>	

- 
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë riparimit të rrjetës.

## **RM 2 Nxënësi qep rrjeta**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit të punës për qepjen e rrjetave;
- Përgatitja e mjeteve të punës;
- Mbushja e drugës me pe;
- Qepja e dy tegelave rrjetorë me njëri tjetrin;
- Qepja e rrjetës në litar;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë qepjes së rrjetës;

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejtë vendin e punës për qepjen e rrjetave;
- të përgatisë mjetet e punës për qepje;
- të mbushë drugën me fijen e duhur të perit për qepje;
- të qepë dy tegela rrjetorë me njëri tjetrin sipas koeficientit të përcaktuar;
- të qepë rrjetën në litar sipas koeficientit të remzhimit të përcaktuar;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë qepjes së rrjetës.

## **RM 3 Nxënësi kryen shërbime ndihmëse për jetëgjatësinë e veglave të peshkimit**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e vendit të punës për kryerjen e shërbimeve;
- Përgatitja e mjeteve të punës;
- Pastrimi i veglave të peshkimit;
- Kontrolli i veglave të peshkimit;
- Sistemimi i veglave të peshkimit në vendin e caktuar;
- Shpëlarja e veglave të peshkimit;
- Mbulimi i veglave të peshkimit;
- Fiksimi i mushamasë;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për kryerjen e shërbimeve;

- të përgatisë mjetet e duhura të punës;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë e mbledhura nga gjuetia;
- të kontrollojë me kujdes veglat e peshkimit për dëmtime të mundshme;
- të sistemojë veglat e peshkimit në vendin e caktuar, të lira nga pengesa të ndryshme;
- të shpëlajë veglat e peshkimit me ujë të ëmbël bollshëm të pastër;
- të mbulojë mirë veglën e peshkimit me mushama të gomuar;
- të fiksojë mushamanë me abica (kur është në anije);
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repart riparimi rrjetash, anije, bregdet ose fermë peshku.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për endjen, prerjen dhe qepjen e rrjetave si dhe në shërbimet ndihmëse për jetëgjatësinë e veglave të peshkimit;
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në kryerjen e endjes, prerjes dhe qepjes së rrjetave si dhe të shërbimeve ndihmëse për jetëgjatësinë e veglave të peshkimit;

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:
- ambiente pune në repart riparimi rrjetash, anije, bregdet ose fermë peshku.
  - mjete pune si: druga, penj, thika, panele rrjete me madhësi syzash të ndryshme, fuga, vizore, litarë, pluskues, pesha, etj.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për endjen e një rrjete në forma të ndryshme;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për prerjen e një rrjete në forma të ndryshme;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për qepjen e dy tegelave rrjetor me madhësi syzash të njejtë dhe të ndryshme;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për qepjen e panelit rrjetor në litar me koeficientë rremzhimi të ndryshëm;
-

## 12. Moduli “Gjuetia në bregdet“

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	GJUETIA NË BREGDET	M-16-170-15
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të bërë gjuetinë e peshkut me vegla të thjeshta peshkimi në bregdet	
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat evlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi hedh vargun me parangalla për peshkim</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjedhja e mjedisit ku do të kryhet peshkimi;</li><li>- Përgatitja e mjeteve të punës;</li><li>- Vendosja e arkës me parangalla në sanall;</li><li>- Vendosja e arkës me karrema në sanall;</li><li>- Vendosja e mjeteve vetjake të shpëtimit në sanall;</li><li>- Vendosja e peshave në sanall;</li><li>- Vendosja e pluskueseve me shenjë ose dritë në sanall;</li><li>- Veshja e kostumit prej mushamaje;</li><li>- Veshja e xhakëtës së shpëtimit;</li><li>- Vozitja e sanallit për në vendin e hedhjes së parangallave;</li><li>- Lidhja e peshës me fundin e vargut të parangallave;</li><li>- Hedhja e peshës në ujë;</li><li>- Vendosja e karremit për parangallin e radhës nga arka;</li><li>- Hedhja e parangallëve të kuar me karrema njëri pas tjetrit në ujë;</li><li>- Lidhja e pluskueses me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i vargut të parangallave;</li><li>- Vazhdimi i vozitjes;</li><li>- Vozitja për të shkuar në breg;</li><li>- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë mjedisin ku do të kryhet peshkimi;</li></ul>	

- 
- të përgatisë mjetet e punës;
  - të përgatisë sanallin për vozitje;
  - të vendosë arkën me parangalla në sanall, në ndarjen përkatëse të kiçit;
  - të vendosë arkën e karremave në sanall, pranë arkës së parangallave;
  - të vendosë mjetet vetjake përkatëse të shpëtimit në sanall;
  - të vendosë peshat në sanall, pranë arkës së parangallave;
  - të vendosë pluskueset me shenjë ose dritë në sanall, pranë arkës së parangallave;
  - të veshë kostumin prej mushamaje;
  - të veshë si duhet xhaketën e shpëtimit;
  - të vozisë sanallin për në vendin e hedhjes së parangallave;
  - të lidhë saktë peshën me fundin e vargut të parangallave;
  - të hedhë me kujdes peshën në ujë, derisa të prekë tabanin;
  - të vendosë si duhet karremin për parangallin e radhës nga arka;
  - të hedhë me kujdes parangallat e kuar me karrema njëri pas tjetrit në ujë, ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
  - të lidhë saktë pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundi i vargut të parangallave;
  - të vazhdohet vozitja, ndërkohë që hidhen parangallat nga person tjetër;
  - të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
  - të vendosë pa i dëmtuar mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
  - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare.
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi mbledh vargun me parangalla**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjedisit ku do të kryhet peshkimi;
- Përgatitja e mjeteve të punës;
- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Vendosja e arkës së parangallave në sanall;
- Vendosja e arkës për mbledhjes së peshkut të në sanall;
- Vendosja e mjeteve vetjake të shpëtimit në sanall;
- Veshja e kostumit prej mushamaje;
- Veshja e xhaketës së shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku janë hedhur parangallat;
- Kapja e pluskueses me shenjë ose dritë;
- Vendos pluskuesen në sanall;
- Zgjidhja e pluskueses;
- Mbledhja e parangallëve në sanall;
- Heqja e peshkut të rënë në parangall;
- Vendosja e peshkut të zënë në arkë;
- Pastrimi i parangallëve nga karremat e pakonsumuar;

- Vendorsja e parangallëve në arkën e parangallave;
- Marja e peshës së lidhur në fundin e vargut të parangallave;
- Vendorsja e peshës në sanall;
- Zgjidhja e peshës;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Vendorsja e mjeteve dhe pajimeve që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- Dërgimi i peshkut të zënë në ambjentin për seleksionim dhe përpunim;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të vendosë arkën e parangallave në sanall në ndarjen përkatëse të kështjës;
- të vendosë mjetet përkatëse vetjake të shpëtimit në sanall;
- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhakëtën e shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku janë hedhur parangallat;
- të kapë me kujdes pluskuesen me shenjë ose dritë, ndërkohë që sanalli vozitet nga dikush tjetër;
- të vendosë pluskuesen në sanall
- të zgjidh pluskuesen nga fundi i vargut të parangallave;
- të mbledhë parangallat ngadalë, një e nga një në sanall;
- të heqë me kujdes peshkun e rënë në seicilin parangall;
- të vendosë peshkun e zënë, tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të pastrojë mirë parangallët nga karremat e pakonsumuar;
- të vendosë parangallat sipas radhës në arkën e parangallave;
- të marrë me kujdes peshën e lidhur në fundin e vargut të parangallave;
- të vendosë peshën në vendin e duhur në sanall;
- të zgjidhë peshën nga fundi i vargut të parangallave;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të vendosë, pa i dëmtuar, mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të dërgojë peshkun e zënë në ambjentin për seleksionim dhe përpunim;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 3 Nxënësi peshkon me rrethim pasiv në bregdet**

#### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjedisit ku do të kryhet peshkimi;
- Përgatitja e mjeteve të punës;
- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Vendosja e mbrezhdës (ngjitëses) në sanall;
- Vendosja e mjeteve vetjake të shpëtimit në sanall;
- Vendosja e peshave në sanall;
- Vendosja e pluskueseve me shenjë ose dritë në sanall;
- Veshja e kostumit prej mushamaje;
- Veshja e xhaketës së shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin e hedhjes së veglës së peshkimit;
- Lidhja e peshës me fundin e veglës së peshkimit;
- Hedhja e peshës dhe pluskueses së fundit në ujë;
- Hedhja e veglës së peshkimit në ujë;
- Lidhja e peshës dhe pluskueses me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i veglës së peshkimit;
- Vazhdimi i vozitjes;
- Vozitja për në skajin e parë, ku u hodh vegla e peshkimit;
- Goditja me mjete të forta e filit të sanallit;
- Marrja e pluskueses dhe peshës së hedhur në fillim në sanall;
- Marrja e veglës së peshkimit në sanall;
- Heqja e peshkut të rënë në veglën e peshkimit;
- Vendosja e peshkut të zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- Pastrimi i veglës së peshkimit nga papastërtitë;
- Stivimi i veglës së peshkimit në teneshirin e sanallit;
- Marrja në sanall e pluskueses dhe peshës së hedhur në fund;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Nxerrja në breg e sanallit;
- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve në vend ruajtje;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të vendosë mbrezhdën (ngjitësen) në sanall, larg pengesave në teneshirin e kçit;
- të vendosë mjetet vetjake të shpëtimit në sanall;
- të vendosë peshat në sanall;
- të vendosë si duhet pluskueset me shenjë ose dritë në

- sanall;
- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë, pa zhurmë, sanallin për në vendin e hedhjes së veglës së peshkimit;
- të lidhë si duhet peshën me fundin e veglës së peshkimit;
- të hedhë me kujdes peshën dhe pluskuesen e fundit në ujë;
- të hedhë pa ngatërruar veglën e peshkimit në ujë, ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
- të lidhë si duhet peshën dhe pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i veglës së peshkimit;
- të vazhdojë vozitjen si duhet, ndërkohë që hidhet vegla e peshkimit në ujë nga person tjetër;
- të vozisë me zhurma për të shkuar në skajin e parë ku u hodh vegla e peshkimit;
- të godasë filin e sanallit, me mjete të forta, për të krijuar zhurma;
- të marrë me kujdes pluskuesen dhe peshën e hedhur në fillim në sanall;
- të marrë, mbarë e pa ngatërruar, veglën e peshkimit në sanall;
- të heqë peshkun e rënë në veglën e peshkimit;
- të vendosë peshkun e zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë;
- të stivojë, pa ngatërruar, veglën e peshkimit në teneshirin e sanallit;
- të marrë në sanall pluskuesen dhe peshën e hedhur në fund;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të nxjerrë në breg sanallin, duke e tërhequr;
- të vendosë, pa i dëmtuar, mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 4 Nxënësi kryen sistemimin paraprak të peshkut të zënë në anije**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjedisit dhe mjeteve të punës;
- Veshja e uniformës së punës;
- Zbrazja e thesit të tratës fundore;
- Ndarja e papastërtive nga peshku;
- Larja e peshkut;
- Nxjerrja e ambalazhit nga vend ruajtja;
- Pastrimi i ambalazhit;
- Përgatitja e ambalazhit për sistemimin e peshkut të zënë;
- Përzgjedhja e peshkut të zënë;
- Sistemimi i peshkut nëpër ambalazhe (arka);



- Kryerja e shplarjes përfundimtare të peshkut;
- Vendosja e arkave të mbushura në çelën frigoriferike;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjedisin dhe mjetet e punës;
- të veshë uniformën e punës;
- të zbrazë thesin e tratës nga peshku i zënë, mbi teneshirin e kështjës së anijes, sipas udhëzimit të dhënë;
- të ndarjë papastërtitë, që ndodhen në thes, nga peshku pa e dëmtuar atë (leshërikë, sallatë deti, guaska, etj.);
- të lajë mirë peshkun me ujë deti, me kova;
- të nxjerrë pa dëmtuar ambalazhin nga vend ruajtja;
- të pastrojë ambalazhin sipas kushteve teknike;
- të përgatisë ambalazhin, për përdorim sipas llojeve, për sistemimin e peshkut të zënë;
- të përzgjedhë peshkun e zënë, sipas llojeve dhe madhësisë;
- të sistemojë peshkun e përzgjedhur nëpër ambalazhe, (arka) sipas peshës që mund të mbartë çdo arkë në përputhje me kushtet teknike;
- të kryejë shplarjen përfundimtare të peshkut, me ujë deti me kova;
- të vendosë arkat e mbushura në çelën frigoriferike, sipas kushteve teknike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul trajtohet në bregdet ose grykëderdhje lumenjsh.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të gjuetisë së peshkur me mjete të thjeshta, në bregdet.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe të gjuetisë me varg parangallash, me rrethim pasiv në bregdet, me kosha peshkues, si dhe për sistemimin e peshkur të kapur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në gjuetinë e peshkur me varg parangallash, rrethim pasiv në bregdet, me kosha peshkues, si dhe për sistemimin e peshkur të kapur.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- sanall peshkimi me pajimet përkatëse të gjuetisë në bregdet
  - veshjet vetjake të mbijetesës si: rreth shpëtimi, xhaketë shpëtimi dhe kostum mushamaje pune.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me varg parangallash në bregdet;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me rrethim pasiv me ngjitëse në bregdet;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me kosha peshkues në bregdet.
  - Mjetet e duhura për sistemimin e peshkur të kapur.
-

### 13. Moduli “Punime ndihmëse në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>PUNIME NDIHMËSE NË FERMAT E RRITJES SË PESHKUT NË UJRA TË ËMBLA</b>	<b>M-16-176-15</b>
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme ndihmëse në fermat e peshkimit të ujrave të ëmbla	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen pasurimin e tabanit të pellgut në ujra të ëmbla për peshkëzim</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;</li><li>- Veshja e uniformës së punës;</li><li>- Mbushja e karrocës me pleh organik të djegur;</li><li>- Shpërndarja e plehut organik në sipërfaqen e tabanit të pellgut;</li><li>- Mbushja e karrocës me pleh kimik superfosfat dhe nitrat;</li><li>- Shpërndarja e plehut kimik superfosfat dhe nitrat në sipërfaqen e tabanit të pellgut;</li><li>- Mbushja e karrocës me gëlqere pluhur të pashuar;</li><li>- Shpërndarja e gëlqeres në sipërfaqen e tabanit të pellgut;</li><li>- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;</li><li>- të veshë uniformën e punës;</li><li>- të mbushë karrocën me pleh organik të djegur;</li><li>- të shpërndarjë, në mënyrë uniforme, plehun organik në sipërfaqen e tabanit të pellgut;</li><li>- të mbushë karrocën me pleh kimik superfosfat dhe nitrat;</li><li>- të shpërndarjë, në mënyrë uniforme, plehun kimik superfosfat dhe nitrat në sipërfaqen e tabanit të pellgut;</li></ul>	

- 
- të mbushë si duhet karrocën me gëlqere pluhur të pashuar;
  - të shpërndarjë, në mënyrë uniforme, gëlqeren në sipërfaqen e tabanit të pellgut;
  - të kryejë të gjithë veprimet e mësipërme sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi furnizon pellgun me ujë ëmbël**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;
- Pastrimi i kanaleve të furnizimit të ujit;
- Riparime të dëmtimeve të mundshme të kanaleve të furnizimit të ujit;
- Mbyllja e shkarkuesave të ujit të çdo pellgu;
- Vendosja e sitave metalike;
- Hapja e portave të furnizimit të ujit;
- Mbyllja e portave të furnizimit të ujit;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme për rifreskimin e ujit të pellgut në kohë;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të pastrojë si duhet kanalet e furnizimit të ujit;
- të riparojë dëmtime të mundshme të kanaleve të furnizimit të ujit;
- të mbyllë shkarkuesat e ujit të çdo pellgu;
- të vendosë saktë sitat metalike, për pengimin e futjes së papastërtive dhe peshkut të egër;
- të hapë portat e furnizimit të ujit, sipas udhëzimit;
- të mbyllë portat e furnizimit të ujit, pasi uji arrin nivelin e caktuar të pellgut, sipas udhëzimit;
- të kryejë veprimet e mësipërme, për rifreskimin e ujit të pellgut në kohë, sipas udhëzimeve të specialistit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 3 Nxënësi kryen peshkëzimin e pellgut të ujit të ëmbël me rasate**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;

- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e rasateve;
- Hedhja e rasateve në kovën me ujë;
- Transportimi i kovave me rasate për tek pellgu i caktuar;
- Hedhja e rasatet në sipërfaqen e pellgut me ujë;
- Mbledhja e individëve të dëmtuar;
- Groposja e individëve të dëmtuar;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e rasateve si: kova, çupalla, trata mbledhjes së rasateve, fuçia plastike, etj.;
- të mbushë kovat me ujë;
- të hedhë me kujdes rasatet në kovën me ujë sipas udhëzimeve teknike;
- të transportojë kovat me rasate për tek pellgu i caktuar sipas udhëzimit;
- të hedhë rasatet me kujdes në sipërfaqen e pellgut me ujë, sipas udhëzimit;
- të mbledhë sipas udhëzimit, individët e dëmtuar nga transporti që mbeten në sipërfaqen e ujit;
- të groposë individët e dëmtuar në vendet e caktuara;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi hedh ushqimin e peshkut në pellgun e ujit të ëmbël**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit;
- Përgatitja e sanallit për shpërndarjen e ushqimit;
- Përzierja e ushqimeve për peshqit;
- Mbushja e kovave me ushqimin e përgatitur;
- Vendosja e kovave të mbushura në sanall;
- Vozitja e sanallit për në vendin e caktuar të pellgut;
- Ngritja e tavolinës së ushqimit;
- Pastrimi i tavolinës së ushqimit;
- Rivendosja e tavolinës në tabanin e pellgut;
- Hedhja e ushqimit të peshkut në tavolinat e ushqimit;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas udhëzimeve;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit si: kazane plastikë, kova, lopata, etj.;
- të përgatisë sanallin për shpërndarjen e ushqimit;
- të përziejë ushqimet për peshqit, për t'u shpërndarë sipas udhëzimeve teknike;
- të mbushë kovat me ushqimin e përgatitur;
- të vendosë si duhet kovat e mbushura në sanall;
- të vozisë sanallin për në vendin e caktuar të pellgut;
- të ngrejë mbi sipërfaqen e ujit tavolinën e ushqimit;
- të pastrojë tavolinën e ushqimit nga mbeturinat e ndryshme;
- të rivendosë tavolinën në tabanin e pellgut;
- të hedhë ushqimin e peshkut në tavolinat e ushqimit në kohën e caktuar;
- të kryejë veprimet e mësipërme sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 5 Nxënësi ruan peshkun nga dëmtuesit, në pellgun e ujit të ëmbël.****Përmbajtja:**

- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e punës;
- Largimi i shpendëve grabitqarë nga pellgu;
- Kontrolli i argjinaturave për prezencë të kafshëve grabitqare;
- Mbledhja e peshqve të dëmtuar apo ngordhur në pellgjet;
- Groposja e peshqve të dëmtuar në vendet e caktuara;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe pajisjet në vendin e punës;
- të largojë shpendët grabitqarë nga pellgu, si pulëbardha, karabullakë, huta, etj. me zhurma apo me armë gjuetie;
- të kontrollojë periodikisht argjinaturat për prezencën e kafshëve grabitqare, si: vidra, breshka uji, gjarpër uji, nuse lale, urithë, etj.;
- të mbledhë individët e dëmtuar apo ngordhur nga pellgjet;
- të groposë peshqit e dëmtuar në vendet e caktuara, sipas kushteve të caktuara;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 6 Nxënësi merr mostra uji në pellgun me ujë të ëmbël**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve për marjen e mostrave të ujit;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit; për në vendin e udhëzuar për marjen e mostrave të ujit;
- Hedhja e spirancës; me dorë rreth 5-6 metra larg nga sanalli;
- Lidhja e cimës së spirancës në sanall;
- Përgatitja e shisheve të marjes së mostrave;
- Futja e shisheve të marjes së mostrave në ujë;
- Marrja e mostrave të ujit;
- Etiketimi i shisheve me mostrat e marratë ujit;
- Vendosja e shisheve me mostrat e marra në termus;
- Marrja e spirancës në sanall;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Nxjerrja e sanallit në breg;
- Dërgimi i termusit, me shishet e mostrave të marra, në laborator;
- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve në vendin e ruajtjes;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të përgatisë mjetet dhe pajisjet për marjen e mostrave të ujit;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin pa shkaktuar turbullira, për në vendin e udhëzuar për marjen e mostrave të ujit;
- të hedhë spirancën me dorë, rreth 5-6 metra larg nga sanalli;
- të lidhë cimën e spirancës në sanall, për t'a fiksuar;
- të përgatisë shishet e marjes së mostrave, duke i nxjerrë nga termusi;
- të fusë ngadalë shishet në ujë, duke i mbajtur me sfillacë pa shkaktuar turbullira;
- të marrë mostrat e ujit, në thellësi të ndryshme të tij;
- të etiketojë shishet me mostrat e marra të ujit, sipas thellësisë dhe pozicionit të marrë në pellg;
- të vendosë shishet me mostrat e marra në termus;
- të marrë spirancën në sanall;

- të vozisë për të shkuar në breg;
- të nxjerë sanallin në breg;
- të dërgojë termusin me shishet e mostrave të marra në laborator, duke e mbajtur me kujdes pa shkaktuar goditje;
- të vendosë mjetet dhe pajimet si duhet, në vendin e ruajtjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 7 Nxënësi kryen sistemimin paraprak të peshkut të zënë në fermën e peshkimit**

***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjedisit ku do të punohet;
- Përgatitja e pajisjeve për transportin e remontit në pellgjet e zhvillimit;
- Veshja e uniformës së punës;
- Zbrazja e thesit të tratës së krahut me peshk, në sanall;
- Larja e peshkut me ujë liqeni;
- Përgatitja e tendës portative në sanall;
- Nxjerrja e ambalazhit nga vend ruajtja;
- Pastrimi i ambalazhit;
- Përgatitja e ambalazhit për sistemim;
- Përzgjedhja e peshkut për treg;
- Përzgjedhja e remontit;
- Hedhja në ujë e peshkut të parritur;
- Sistemimi i peshkut të përzgjedhur nëpër ambalazhe;
- Vendosja e remontit në pajisjet teknologjike;
- Shpëlarja e peshkut të sistemuar;
- Mbulimi i përkohshëm i peshkut në arka;
- Sistemimi i arkave në çelën frigoriferike;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjedisin ku do të punohet;
- të përgatisë pajisjet për transportin e remonit në pellgjet e zhvillimit;
- të veshë uniformën e punës;
- të zbrazë thesin e tratës së krahut me peshk, në sanall, sipas udhëzimit të dhënë;
- të lajë peshkun nga balta, me ujë liqeni, me kova;
- të përgatis tendën portative në sanall, për ruajtjen e freskisë së peshkut nga rrezet e diellit;
- të nxjerë pa dëmtuar ambalazhin nga vend ruajtja;
- të pastrojë ambalazhin, duke e larë;
- të përgatisë në kohë, ambalazhin për sistemimin e peshkut



- të zënë;
- të përzgjedhë peshkun për treg, sipas llojeve dhe madhësive;
- të përzgjedhë individët për remont sipas udhëzimeve, për riprodhimin e peshkut në vitet pasardhëse;
- të hedhë në ujë, sipas udhëzimeve, peshkun e parritur (jashtë standartit);
- të sistemojë nëpër ambalazhe (arka) peshkun e përzgjedhur për treg, sipas kushteve teknike;
- të vendosë remontin në pajisjet teknologjike, sipas udhëzimeve, për traferim;
- të shpëlajë peshkun e sistemuar, me ujë për largimin e insekteve;
- të mbulojë përkohësisht peshkun në arka nga rrezet e diellit;
- të sistemojë arkat e mbushura në çelën frigoriferike, sipas kushteve teknike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të punimeve ndihmëse në fermat e rrijës së peshkut në ujra të ëmbla.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut të ujrave të ëmbla.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut të ujrave të ëmbla.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- ambiente pune në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
  - mjete e punës sipas specifikës së procesit.
  - materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve të modulit.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për pasurimin e tabanit të pellgut të ujit të ëmbël;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për furnizimin me ujë të pellgut të ujit të ëmbël;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për peshkëzimin e pellgut të ujit të ëmbël;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për shpërndarjen e ushqimit të peshkut në pellgun me ujë të ëmbël.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për marjen e mostrave të ujit në pellgjet me ujë të ëmbël.
-

#### 14. Moduli “Punime ndihmëse në feramat e rritjes së peshkut në ujra të kripura”

Drejtimi: Detari  
Niveli: I  
Klasa: 11

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>PUNIME NDIHMËSE NË FERMAT E RRRITJES SË PESHKUT NË UJRA TË KRIPURA</b>	<b>M-16-177-15</b>
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme ndihmëse në feramat e peshkimit të ujrave të kripura.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.10 në drejtimin mësimor “Detari”, niv.I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen peshkëzimin e koshit në ujë të kripur me rasate</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;</li><li>- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e rasateve;</li><li>- Përgatitja e sanallit për vozitje;</li><li>- Vendoja e mjeteve dhe pajimeve në sanall;</li><li>- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;</li><li>- Hedhja e rasateve në kovën me ujë;</li><li>- Vozitja e sanallit për tek koshi notues;</li><li>- Fiksimi sanallit tek koshi notues; duke e lidhur;</li><li>- Hedhja e rasatet në sipërfaqen e koshit notues;</li><li>- Mbledhja e individëve të dëmtuar;</li><li>- Hedhja e individëve të dëmtuar jashtë rrethimit të koshit;</li><li>- Zgjidhja e nyjes së lidhjes së sanallit tek koshi notues;</li><li>- Vozitje për të shkuar në breg;</li><li>- Akostimi i sanallit në breg;</li><li>- Pastrimi i vendit të punës;</li><li>- Vendosja e mjeteve dhe pajisjet në vendin e ruajtjes;</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;</li><li>- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e rasateve si: kova, çupalla, fuçia plastike, etj.;</li><li>- të përgatisë sanallin për vozitje;</li><li>- të vendosë mjetet dhe pajisjet si duhet në sanall;</li></ul>	

- 
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
  - të mbushë kovat me ujë të kripur;
  - të hedhë me kujdes rasatet në kovën me ujë të kripur, sipas udhëzimeve teknike;
  - të vendosë kovat e mbushura në sanall;
  - të vozisë sanallin me kovat me rasate për tek koshi notues;
  - të fiksojë sanallin tek koshi notues, duke e lidhur si duhet;
  - të hedhë rasatet me kujdes në sipërfaqen e koshit notues, sipas udhëzimit;
  - të mbledhë me çupallë individët e dëmtuar;
  - të hedhë rasatet e dëmtuar jashtë koshit notues në det;
  - të heqë cimën e lidhjes, për të liruar sanallin për vozitje;
  - të vozisë sanallin për në breg;
  - të lidhë sanallin në breg;
  - të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendin e ruajtjes;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi hedh ushqimin e peshkut në koshin notues në ujë kripur**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;
- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e ushqimit;
- Përgatitja e sanallit për shpërndarjen e ushqimit;
- Përzierja e ushqimeve për peshqit;
- Mbushja e kovave me ushqimin e përgatitur;
- Vendosja e kovave të mbushura në sanall;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku është vendosur koshi notues;
- Hedhja e ushqimit të peshkut në sipërfaqen e koshit notues;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas udhëzimeve teknike;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Akostimi i sanallit në breg;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Vendosja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e ruajtjes;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit si: kazane plastikë, kova, lopata, etj.;

- të përgatisë sanallin për shpërndarjen e ushqimit;
- të përziejë ushqimet për peshqit, për t'u shpërndarë sipas udhëzimeve teknike;
- të mbushë kovat me ushqimin e përgatitur;
- të vendosë kovat e mbushura në sanall, duke ruajtur ekuilibrin e tij;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku është vendosur koshi notues;
- të hedhë ushqimin e peshkut në koshat notues, në kohën e caktuar;
- të kryejë veprimet e mësipërme sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të vozisë për të shkuar në breg;
- të lidhë sanallin në breg në mënyrë të sigurtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendet e ruajtjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 3 Nxënësi ruan peshkun në koshin notues në ujë kripur nga dëmtuesit**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e punës;
- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku janë vendosur koshat notues;
- Kontrolli i koshave notues për prezencë të kafshëve grabitqarë;
- Largimi i shpendëve grabitqarë nga koshat notues;
- Heqja jashtë koshit notues të individëve të dëmtuar;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas udhëzimeve teknike;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Akostimi i sanallit në breg;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Vendosja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e ruajtjes;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku janë vendosur koshat

- notues;
- të kontrollojë koshat notues për prezencë të kafshëve grabitqarë;
- të largojë shpendët grabitqarë nga koshat notues me efekte zanore;
- të heqë jashtë koshit notues individët e dëmtuar;
- të kryejë veprimet e mësipërme sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të vozisë për të shkuar në breg;
- të lidhë sanallin në breg në mënyrë të sigurtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendet e ruajtjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 4 Nxënësi merr mostra uji në koshat notues në ujë të kripur**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve për marjen e mostrave të ujit;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku janë vendosur koshat notues për marjen e mostrave të ujit;
- Lidhja e sanallit pranë koshit; për t'a fiksuar atë;
- Përgatitja e shisheve të marjes së mostrave;
- Futja e shisheve në ujë;
- Marrja e mostrave të ujit;
- Etiketimi i shisheve me mostrat e marra të ujit;
- Vendosja e shisheve me mostrat e marra në termus;
- Zgjidhja e cimës së lidhjes së sanallit;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Akostimi i sanallit në breg;
- Dërgimi i termusit me mostrat e marra në laborator;
- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve në vendin e ruajtjes;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të përgatisë mjetet dhe pajisjet për marjen e mostrave të ujit, duke i vendosur në sanall;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku janë vendosur koshat notues për marjen e mostrave të ujit;
- të lidhë sanallin me cimë tek koshi notues;

- të përgatisë shishet e marjes së mostrave, duke i nxjerrë nga termusi;
- të fusë ngadalë shishet në ujë, duke i mbajtur me sfillacë pa shkaktuar turbullira;
- të marrë mostrat e ujit, në thellësi të ndryshme;
- të etiketojë shishet, sipas thellësisë dhe pozicionit të koshit notues ku u morrën mostrat e ujit;
- të vendosë shishet me mostrat e marra në termus;
- të zgjidhë cimën e sanallit nga koshi, për t'u larguar;
- të vozisë për të shkuar në breg;
- të lidhë sanallin në breg, që të mos e marrë vala;
- të dërgojë termusin me mostrat e marra në laborator, duke e mbajtur me kujdes pa shkaktuar goditje;
- të vendosë me kujdes, mjetet dhe pajimet në vendin e ruajtjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi kryen sistemimin paraprak të peshkut të zënë në fermën e peshkimit**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e mjedisit ku do të punohet;
- Veshja e uniformës së punës;
- Larja e peshkut me ujë;
- Nxjerrja e ambalazhit nga vend ruajtja;
- Pastrimi i ambalazhit;
- Përgatitja e ambalazhit për sistemim;
- Përzgjedhja e peshkut për treg;
- Sistemimi i peshkut të përzgjedhur nëpër ambalazhe;
- Shpëlarja e peshkut të sistemuar;
- Mbulimi i përkohshëm i peshkut në arka;
- Sistemimi i arkave në çelën frigoriferike;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjedisin ku do të punohet;
- të veshë uniformën e punës;
- të lajë peshkun me ujë;
- të nxjerrë pa dëmtuar ambalazhin nga vend ruajtja;
- të pastrojë ambalazhin, duke e larë;
- të përgatisë në kohë, ambalazhin për sistemimin e peshkut të zënë;
- të përzgjedhë peshkun për treg, sipas llojeve dhe madhësive;
- të sistemojë nëpër ambalazhe (arka) peshkun e

- përzgjedhur për treg, sipas kushteve teknike;
- të shpëlajë peshkun e sistemuar, me ujë për largimin e insekteve;
- të mbulojë përkohësisht peshkun në arka nga rrezet e diellit;
- të sistemojë arkat e mbushura në çelën frigoriferike, sipas kushteve teknike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një fermë peshku të ujrave të kripura.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të punimeve ndihmëse në fermën e peshkut me ujë të kripur
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorëve në fermën e peshkut të ujit të kripur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut të ujit të kripur.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:
- mjedise pune në një fermë peshku të ujit të kripur në bregdet.
  - mjete e punës sipas specifikës së procesit.
  - materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve të modulit.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për peshkëzimin e koshave notues në ujë të kripur;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për shpërndarjen e ushqimit të peshkut në koshat notues në ujë të kripur.
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për marjen e mostrave të ujit në koshat notues në ujë të kripur.
-

## X. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të grupuar

Praktika profesionale e grupuar do të kryhet bazuar në programin e përgjithshëm, si më poshtë:

Klasa 10			
Kohëzgjatja: 2 javë/10 ditë/60 orë mësimore			
Nr	Vendi	Veprimtaritë që kryhen	Kompetencat që zhvillohen
1	Në bregdet/pishinë	Kryerja e notimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të notojë në stile dhe kushte të ndryshme në ujë</li> </ul>
2	Në bregdet	Kryerja e vozitjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të vozisë me mjete të lehta lundrimi me disa mënyra</li> </ul>
3	Në Klasë / Në anije në port	Realizimi i nyjeve detare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të realizojë nyje dhe lidhje të ndryshme detare</li> </ul>
4	Në anije metalike në port	Mbrojtja e anijes nga ndryshku	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të realizojë pastrimin e sipërfaqes së ndryshkur duke përdorur mjetet e duhura;</li> <li>Të realizojë lyerjen me bojë për mbrojtjen e anijes nga ndryshku.</li> </ul>
5	Në mjet lundrues prej druri në tokë dhe në port (kalatë)	Kallafatimi dhe stukimi i mjetit lundrues prej druri	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të bëjë kallafatimin dhe stukimin e majereve të skafit dhe kuvertës në një mjet lundrues prej druri</li> </ul>
6	Në anije në port	Operimi i mjeteve dhe i mekanizmave të kuvertës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të qepë cima dhe kavo duke përdorur teknikën dhe veglat e duhura;</li> </ul>

Klasa 11			
Kohëzgjatja: 2 javë/10 ditë/60 orë mësimore			
Nr	Vendi	Veprimtaritë që kryhen	Kompetencat që zhvillohen
1.	Në anije në port	Operimi i mjeteve dhe i mekanizmave të kuvertës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të kalojë si duhet cimat dhe kavot në elementë struktural në kuvertë për qëllime akostim dhe ç'akostimi</li> <li>Të përdorë mjetet e duhura për akostim, qëndim në kalatë dhe ç'akostim;</li> <li>Të raportojë gjendjen (gatishmërinë, distancën, etj.) në vendin e caktuar dhe në raport me objektet përreth</li> <li>Të asistojë në uljen dhe ngritjen e shkallës së imbarkimit;</li> <li>Të vendosë dhe heqë mjetet për pritjen/largimin e pilotit;</li> </ul>



<b>Klasa 11</b>			
<b>Kohëzgjatja: 2 javë/10 ditë/60 orë mësimore</b>			
<b>Nr</b>	<b>Vendi</b>	<b>Veprimtaritë që kryhen</b>	<b>Kompetencat që zhvillohen</b>
			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të asistojë në matjen e tankeve të lëngjeve në anije;</li> <li>• Të lexojë busullën magnetike, erëmatësin dhe instrumentat për matjen e lagështisë, temperaturës dhe trysnisë.</li> </ul>
2.	Në pishinë & bregdet dhe në anije në port	Veprimet personale për mbijetesën në anije	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kryejë veprimet për sigurinë personale për braktisjen nga anija;</li> <li>• Të kryejë për sigurinë veprimet kolektive për braktisjen nga anija;</li> <li>• Të përdorë mjetet e komunikimit të alarmit në një mjet mbijetese;</li> <li>• Të kryejë veprimet për dhënien e asistencës me elikopter;</li> </ul>
3.	Në mjediset e përgatitura enkas sipas skemës me 2 konteinerë ,ose në një repart PMNZSH dhe në anije në port	Masat për parandalimin dhe luftën kundër zjarrit në anije	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zbatojë masat e sigurisë për parandalimin dhe luftën kundër zjarrit</li> <li>• Të kryejë patrullim kundra zjarrit në grup në zona të ndryshme në anije;</li> <li>• Të japë alarmin në rast konstatimi të zjarrit në anije;</li> <li>• Të kalojë me aparat frymëmarje në një zonë të mbushur me tym;</li> <li>• Të përdorë mjetet dhe veshjet e duhura për luftën kundra zjarrit të klaseve të ndryshme;</li> </ul>
4.	Në klasë dhe në mjediset sipas skemës me 2 konteinerë	Dhënia e ndihmës së parë elementare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të pozicionojë si duhet një dëmtuar për dhënien e ndihmës së parë;</li> <li>• Të japë frymëmarjen e të dëmtuarit;</li> <li>• Të kryejë veprimet kur ka arrest kardiak;</li> <li>• Të kryejë veprimet kur ka gjakosje;</li> <li>• Të kryejë veprimet për rigjallërim për mbrotjen nga të ftohtit;</li> <li>• Të kryejë veprimet kur ka degje në trup dhe aksidente</li> </ul>

Klasa 11			
Kohëzgjatja: 2 javë/10 ditë/60 orë mësimore			
Nr	Vendi	Veprimtaritë që kryhen	Kompetencat që zhvillohen
			nga rryma elektrike, kimikate, etj.; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të realizojë transportin e të dëmtuarit me mënyra të ndryshme në anije;</li> <li>• Të kryejë veprimet për fashimin e një plaje/dëmtimi;</li> </ul>
5.	Në anije në port	Punime ndihmëse elektromekanike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të pastrojë filtrat e mekanizmave të ndryshëm në lokalin e makinerisë;</li> <li>• Të zëvendësojë ndriçues në anije;</li> <li>• Të takojë/stakojë me udhëzim çelësa energjie;</li> <li>• Të markojë linjat dhe sistemet me ngjyrën dhe emërtimin përkatës;</li> <li>• Të përgatisë guarnicione të thjeshta të ndryshme;</li> <li>• Të izolojë rrjedhje të vogla në tubacione.</li> </ul>
6.	Në anije në port & repart riparimi rrjetash	Veprimet për mirëmbajtjen e veglave të peshkimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të bëjë riparime të thjeshta të veglave të peshkimit;</li> <li>• Të sistemojë veglat e peshkimit për ruajtjen e jetëgjatësisë së tyre</li> </ul>
7.	Në bregdet me mjet të lehtë lundrimi & stabiliment mbledhje peshku	Veprimet për gjuetinë në bregdet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të hedhë dhe mbledhë vargun e parangalleve të gjuetisë;</li> <li>• Të hedhë dhe mbledhë mbrezhdën (vegla e gjuetisë) në bregdet;</li> <li>• Të sistemojë peshkun e zënë në ambalazh</li> </ul>
8.	Në fermë të rritjes së peshkut në ujra të ëmbla	Veprimet në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shpërndajë lëndët e ndryshme për pasurimin e tokës në tabanin e pellgut;</li> <li>• Të kryejë veprimet për mbushjen /zbrazjen me ujë të pellgut;</li> <li>• Të kryejë veprimet për hedhjen e rasateve për peshkëzim të pellgut;</li> <li>• Të kryejë veprimet për hedhjen e ushqimit të peshkut në pellg;</li> <li>• Të marrë mostra uji nga pellgu për analizë;</li> </ul>

**Klasa 11****Kohëzgjatja: 2 javë/10 ditë/60 orë mësimore**

Nr	Vendi	Veprimtaritë që kryhen	Kompetencat që zhvillohen
			<ul style="list-style-type: none"><li>• Të sistemojë peshkun e zënë në ambalazhe dhe frigorifer;</li></ul>
9.	Në fermë të rritjes së peshkut në ujra të kripura	Veprimet në fermat e rritjes së peshkut në ujra të kripura	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të kryejë veprimet për peshkëzim të koshit notues;</li><li>• Të kryejë veprimet për hedhjen e ushqimit të peshkut në koshin notues;</li><li>• Të marrë mostra uji nga koshi notues për analizë;</li><li>• Të sistemojë peshkun e zënë në ambalazhe dhe frigorifer;</li></ul>